بسم الله الرحمن الرحیم

Muhamed Xhevàd Mugnijeh

FIKHU I IMAM

XHA'FERR SADIKUT

(Pagja goftë mbi të!)

V

Titulli: **Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut** *(Paqja qoftë mbi të!)* **V**

Autori: **Muhamed Xhevàd Mugnijeh**

Përktheu: **H. Selim Stafa** *(Allahu e mëshiroftë!)*

Recensent: **H. Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Perkujdesja garfike: **Sabrie Feza**

Kapaku: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata FLLADI**

بسم الله الرحـــمن الرحيم

PARATHËNIE

Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve. Paqja e bekimi i Allahut qoftë për zotërinë e dy krijesave lëndore (njerëz e xhin), Muhamedin dhe për pjesëtarët e familjes së tij erëkëndshme e të pastër.

Në vijim:

Pjesa e parë dhe e dytë e librit "Fik'hu i Imam Xhafer Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*" përmbanin të gjitha adhurimet në tërësinë e tyre: pastrimin, namazin, agjërimin, zekatin, një të pestën, Haxhin, xhihadin, urdhërimin për punë të mirë dhe ndalimin e punës së keqe. Në këta kapituj kam depërtuar në të gjitha degët e çështjet që kanë lidhje me kapitujt e lartpërmendur. Të gjitha këto i kam paraqitur në mënyrë të përmbledhur e me qartësi, shoqëruar me argumentet përkatëse, jo vetëm me fjalët e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, por edhe me fjalët e përbashkëta të fukahave të medh'hebit.

Kjo pjesë (pjesa e tretë), në vija të përgjithshme, trajton kontratat, përse e ku lidhen ato, partnerët në kontratë dhe kushtet për partnerët. Gjithashtu, trajton rregullat e përgjithshme, të cilat,

në të vërtetë, janë baza të praktikimit të kontratave dhe të marrëdhënie të veçanta midis palëve.

Në mënyrë të veçantë, në këtë pjesë trajtohen marrëdhëniet e shitblerjes me të gjitha pjesët e degët, si dhe studime të tjera që kanë lidhje me shitblerjen, si: tepricat, shtesat, të drejtën e përzgjedhjes, kamatën dhe të tjera çështje.

Çdo çështje është referuar në burimin e saj prej thënieve të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe fjalës së përbashkët të fukahave të medh'hbit xhaferij. Gjithashtu, në këtë pjesë trajtohen edhe probleme të marra nga baza e nga parimet.

Më tej, qëllimi i këtij libri konsiston në faktin se pjesët e tij përmbajnë fik'hun e Imam Xhafer Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* nga a-ja deri te zh-ja, edhe pse është i llojit të ri nga ana e hartimit, të renditjes, të koordinimit, të qartësisë dhe të lehtësimit që paraqet për ata që kanë dëshirë të njihen me këtë fik'h.

Në parathënien e pjesës së parë kam thënë: "Ka të ngjarë që numri i pjesëve të shkojë katër ose pesë." Tani, në parathënien e pjesës së tretë, pohoj: "Mbase numri i pjesëve do të arrijë gjashtë ose shtatë.", megjithëse nuk e di. Mbase në parathënien e pjesës së katërt do të them që numri i pjesëve do të arrijë "shtatë ose tetë". Vetëm Allahu e di më mirë, kurse për aq sa di unë, mund të them vetëm kaq: Sa herë depërtoj në këtë det, aq herë para meje zbulohet se ky det është akoma më i thellë e akoma më i madh nga sa mund të matet me sipërfaqe. Prandaj nuk jam në gjendje të them se sa faqe e sa vëllime do të jenë, pasi vlerësimi im, për të gjitha këto, ka qenë thjesht vështrime e hulumtime, megjithëse kjo nuk është gjëja më e rëndësishme, sepse e gjithë shpresa ime është

përqendruar në kërkim të mbarësisë nga ana e Allahut të Gjithëpushtetshëm deri në fund.

Libri i fitimeve (Libri *El Mekàsib*)

Në këtë pjesë nuk kam gjetur burim më të pasur në dituri për gjithçka që kanë shkruar fukahatë e medh'hebit xhaferij, të mëparshmit e të mëvonshmit, nuk kam gjetur burim më të bollshëm se libri "El Metàxhir" – "Tregtoret", i njohur me emrin "El Mekàsib"–"Fitimet", të autorit shejkh Murteda El Ensarij (vdekur në vitin (1281H), të cilit potenciali i pakufizuar dhe koha e tij e vonë, në krahasim me ligjvënësit e mëdhenj, i mundësuan të njihet me mendimet e me pikëpamjet e tyre dhe t'i gjykojë e t'i masë ato me peshoren më të drejtë e më të hollësishme, duke shtuar edhe shumë pikëpamje të tjera, me të cilat ai ishte njohur më parë, të cilat ai i ka nxjerrë prej librit "Err Rresàilu fil Usùl".

Historia nuk njeh të ketë një të ngjashëm me librin "El Mekasib" në fushën e fik'hut dhe prej të cilit janë nxjerrë rregullat kryesore, të përforcuara me pikëpamjet e me mendimet e dijetarëve poliedrikë, krahas vërtetimit e disiplinimit të studimeve të hollësishme.

Pikërisht këtu qëndron edhe sekreti që i ka shtyrë profesorët e mëdhenj të universitetit të Nexhefi Eshrefit, të vendosin që ky libër të studiohet nëpër shkolla, që kur ai doli në qarkullim. Me këtë libër merr fund seria e librave të miratuar si tekste mësimore. Ata e morën këtë vendim, me qëllim që studenti të pajiset me aftësitë e mjaftueshme dhe të kuptojë mirë teoritë kryesore që gjenden në këtë libër, në lidhje me ndërtimin e

dispozitave e rregullave, të cilat janë materiali fillestar për hulumtim e për nxjerrjen e përfundimeve.

Nuk përbën ndonjë të re që dijetarët jo vetëm janë interesuar për librin "El-Mekàsib", por edhe kanë shkruar aq shumë komente e kanë dhënë aq shumë shpjegime. Madje ata kanë shkruar vëllime të tëra kushtuar këtij libri, ndër të cilat është edhe shkrimi në margjinatura (sipas traditës së dijetarëve të mëparshëm, teksti i librit, i rrethuar në kornizë, shoqërohej me shkrimin e një shpjeguesi të veçantë). Në fakt, ishte një libër i dytë dhe quhej "Hàshijeh", me autor Sejjid Kàdhim El Khuràsànij, i cili është autor i librit "Kifàjetul Usùli", për të cilin, gjithashtu, është vendosur të jetë tekst mësimor.

Libri "El Mekasib" është shoqëruar edhe me "Hàshijen" e autorit Mirzà Husejn En' Nàijnij. Kjo "Hàshijeh", është bërë e njohur me memorandumet e El Khauànisàrij, nxënës i autorit. Është pena e këtij nxënësi që ka shkruar këtë "Hashije". Gjithashtu, libri është shoqëruar me një koment, me autor Sejjid Muhsinul Hakijm, autor i librit "El Mustemsek", si dhe me një "Hàshijeh", me autor shejkhun Muham'med Husejn El Asfehanij.

Është vendi të theksohet se të gjithë këta kolosë janë pikë referimi të kohës së tyre. Studimi i këtyre shpjegimeve e i këtyre komenteve, më ndihmuan të kuptoj kërkesat e shejkhut El Ensarij, për të cilin njëri prej kolosëve të dijes ka thënë: "Detyra jonë është që të derdhim sa më shumë mund, derisa të arrijmë të kuptojmë thëniet e këtij të madhi."

Edhe unë i kam bërë të gjitha përpjekjet që të arrij të kuptoj qëllimin e thënieve të shejkhut të nderuar, pastaj kam

seleksionuar shumë prej atyre thënieve, të cilat i kam përpunuar e i kam përzgjedhur, me qëllim që të kuptohen sa më lehtë dhe të artikulohen sa më lirshëm në gjuhët e njerëzve. Puna ime gjatë kohës së studimeve, është përqendruar në kujdesin tim të vazhdueshëm për t'ju referuar burimeve, dorëshkrimeve e botimeve gjatë dhjetëra vitesh. Falë këtyre studimeve, para meje u shtrua rruga që unë të njihem me qëllimet e shejkhut. Vetëm atëherë dritat e shumta zbuluan sekretet e librit të tij "El Mekàsib". Sikur të mos ishte ky mund i derdhur, referimi im në këtë libër do të ishte si veprimi i njeriut që endet nëpër shkretëtirë, pa ditur se ku gjendet bregu i shpëtimit.

Pavarësisht nga puna ime e mëparshme dhe në vazhdim, unë kurrë nuk mund të pretendoj se i kam njohur mendimet e pikëpamjet e shejkhut të nderuar në të vërtetën e tyre. Në të vërtetë, ajo që unë kam paraqitur, duke iu referuar këtij libri, është vetëm një kopje e dijeve dhe e përfytyrimit që kam në lidhje me pikëpamjet e me mendimet e shejkhut të nderuar, por jo se i njoh ato mendime e pikëpamje ashtu siç janë realisht në të vërtetën e tyre.

Shtëpia e shëndoshë *(Bejtul "El Kasijd")*

Libri "El Mekasib" i shejkhut El Ensarij është prej burimeve të librit "Bejtul Kasijd", përveç kapitullit: "Disiplinimi i shprehjes prej qëllimit", "Fitimi i ndërsjellë dhe derivatet e tij", "Paqja", "Shpenzimi", "Kamata", "Shitja e frutave dhe atakimet". Këto çështje, shejkhu nuk i ka paraqitur, prandaj edhe unë, për këto çështje, jam bazuar te librat "El Xheuàhir", "El Hadàik", "El

Mesàlik", "Miftahul Kerameh", si dhe në libra të tjerë. Veçanërisht jam bazuar në librin e parë, domethënë në librin "El Xheuàhir", për shkak të pozitës së madhe që ka ky libër dhe për shkak të besimit të thellë që kanë fukahatë te autori i këtij libri. Kushdo që më ndjek mua në faqet e këtij libri, do të gjejë se unë kam mbështetur pjesën më të madhe të çështjeve nga burimet përkatëse.

Hadithi dhe rivajeti

Termi "hadijth", në praktikën e burrave të ligjit të fesë, është i veçantë për fjalët e të Dërguarit më të madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe për këtë shkak unë nuk jam shprehur me këtë term për thëniet e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe për thëniet e imamëve të tjerë të pastër të Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!)*, por për thëniet e këtyre unë kam përdorur termin *"rivàjet"* – "transmetim", sepse në doktrinën tonë (shiia) ata janë përcjellës të fjalëve të gjyshit të tyre, Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, prandaj ata nuk janë autorë të mendimit, por janë vetëm transmetues të fjalëve të tij.

Për të njëjtën arsye, fukahatë, në shumicën e rasteve, kanë përdorur termin "njoftim" - *"khaber"* për thëniet e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*. Patjetër që dallimi te ne mes imamëve të Ehli Bejtit, kur ata përcjellin prej gjyshit të tyre dhe mes të tjerëve, qëndron në faktin se gënjeshtra dhe gabimi mbetet te të dytët dhe

jo te të parët. Pikërisht ky është edhe koncepti i pagabueshmërisë së Imamit te shiiat imàmij.[1]

Ka mbetur edhe diçka

Shpesh unë them: "Autori i librit "El Xheuàhir", ose autori i ndonjë libri tjetër ka thënë.", pa treguar numrin e faqes, datën e botimit të librit, si dhe sekretin përse libri që unë citoj nuk ka numër faqesh e as datë botimi, megjithëse ai libër është ribotuar disa herë, madje disa libra tepër voluminozë nuk përmbajnë as titullin e librit e as emrin e autorit. Prej këtyre librave është libri "El Mustened" i autorit En Neràkij, në disa nga botimet e tij, ose libri "Sherhul Irshàd", i autorit El Erdebijlij, në disa nga botimet e tij.

Sipas asaj që unë mendoj, shkaku i mosvënies së emrit, datës së botimit, apo titullit të librit, qëndron në faktin se autori, kur ka shkruar librin, nuk e ka përmendur as emrin e vet e as titullin nga fillimi deri në fundin e librit, pasi ai nuk kishte llogaritur të botonte librin që shkroi, as nuk kishte menduar se libri i tij do të përhapej. Por më vonë, pas tij ishte ai që kopjoi origjinalin dhe pronari i shtypshkronjës, i cili e botoi librin sipas tekstit që kishte sjellë kopjuesi, pa i kushtuar vëmendje

[1] Në librin "Shiiat dhe Shiizmi" kam shpjeguar kuptimin e pagabueshmërisë dhe e diturive të Imamit, si dhe çdo gjë që ka lidhje me doktrinën e shi'ave, duke vënë në dukje edhe shtetet e vendet e tyre, si dhe numrin e tyre gjatë historisë deri në ditët e sotme. Gjithashtu, kam shpjeguar dallimin midis shi'ave dhe të gjithë grupeve të tjera islame.

shkujdesjes që ishte treguar në lidhje me emrin e autorit, datës kur është shkruar libri, madje as datës kur ai e botoi.

Sido që të jetë, fukahatë e njohin renditjen e kapitujve të fik'hut, pasi çështjet e çdo kapitulli janë të renditura në libër dhe, kur lexuesi i specializuar ka qëllim të referohet te libri prej të cilit janë nxjerrë citatet, ai nuk e shejkh të nevojshme të qëndrojë në neglizhimin e mosvënies së numrave të faqeve, por interesohet të shikojë me durim e vendosmëri vetëm çështjen për të cilën dëshiron të thellohet.

Vetëm Allahu i Gjithëpushtetshëm është përgjegjës dhe vetëm Ai bën që kjo punë të jetë mjet për të fituar kënaqësinë e Tij. Mua më mjafton vetëm Allahu, i Cili është mbështetësi më i mirë. Paqja e bekimi i Allahut qoftë për Muhamedin e për familjen e tij të pastër.

* * *

SHITBLERJA (në kontratë)

Pjesët e fik'hut

Fik'hu ndahet në katër pjesë: Adhurimet *(ibàdàt)*, Kontratat *(ukùd)*, Detyrimet *(mùxhibàt)* dhe Dispozitat *(ahkàm)*, që quhen politika. Adhurimi (ibàdet) është kryerja e obligimit taksativ ose veprimi i vullnetshëm, me qëllim afrimin te Allahu i Lartësuar, sepse adhurimi është bindje e nënshtrim i posaçëm vetëm ndaj Allahut.

Adhurimi nuk konsiderohet adhurim pa nijetin e afrimit te Allahu dhe kërkimin e shpërblimit vetëm prej Allahut e për të fituar kënaqësinë e Allahut me anë të këtij adhurimi. Çdo punë që kushtëzon vlefshmërinë e këtij nijeti, në vetvete, është adhurim, siç është namazi, agjërimi e Haxhi, kurse të gjitha punët që janë të vlefshme pa nijet, nuk kanë asgjë të përbashkët me adhurimin *(idàdetin)*. Bazuar mbi këtë çështje, dalin jashtë kuadrit të adhurimit studimet mbi ujërat dhe tokën, të cilat fukahatë i kanë renditur në kapitullin e pastrimit, ose ezani dhe kiameti, që ata i kanë përmendur te veprimet paraprake të namazit, ose studimet mbi kapitullin e luftës në rrugën e Allahut dhe urdhërimin për punë të mirë e ndalimin e punës së keqe. Këto çështje fukahatë i

kanë aneksuar te adhurimet. Të gjitha këto studime janë jashtë adhurimeve, sepse nijeti nuk është kusht që ato të jenë të vlefshme, por nijeti në këto veprime është kusht për të merituar shpërblimin për ato punë, pra, është plotësisht si heqja dorë prej punëve haram. Vetëkuptohet që vlefshmëria e punës është një gjë dhe shpërblimi për atë punë është një gjë tjetër.

Për sa i përket kontratave, ato kanë nevojë për dy palë, palën propozuese, domethënë palën që ofron dhe palën pranuese, siç janë: shitblerja, qiradhënia e qiramarrja, martesa, ose angazhime ndërtimi. Por kontratat mund të jenë edhe detyrime të njëanshme, siç janë divorci e lirimi i robit.

Dispozitat përfshijnë gjuetinë, therjen e bagëtive, pijet, dënimin kur komshiu merr pronën e tjetrit me forcë, lufta në rrugën e Allahut, urdhërimi për punë të mirë, dënimet e përcaktuara në ligjin e fesë, ekzekutimet, zhdëmtimet për vrasjen, trashëgimia, rrëmbimi, gjykimi, dëshmia, pohimi, etj.

Marrëveshja, premtimi dhe kontrata

Fjala "marrëveshje" *(el ahdu)*, nga ana gjuhësore, ka disa kuptime, ndër të cilat "urdhër" dhe "porosi". Allahu i Lartësuar thotë në Librin e Tij Famëlartë:

"أَلَمْ أَعْهَدْ إِلَيْكُمْ يَا بَنِي آدَمَ أَن لاَّ تَعْبُدُوا الشَّيْطَانَ"

"O bij të Ademit, a nuk dërgova unë porosi për ju që të mos e dëgjoni djallin..." *(Sure "Jasin", ajeti 60)*

Në këtë ajet, Allahu na urdhëron e na porosit. Gjithashtu, prej kuptimeve të kësaj fjale është: "aleancë" dhe "premtim", të cilin njeriu e jep kundër interesit të vet, ashtu siç është fjala e nderuar e Allahut:

"أَوْفُوا بِالْعَهْدِ ۖ إِنَّ الْعَهْدَ كَانَ مَسْؤُولاً"

"...mbajeni premtimin, sepse premtimi ka përgjegjësi." *(Sure "El Isra", ajeti 34)*

Gjithashtu, prej kuptimeve të kësaj fjalë është: "njohje", si për shembull, kur i thua dikujt: "Të njoha për burrë të drejtë.", si dhe kuptime të tjera.

Fjala "marrëveshje", në terminologjinë e fukahave do të thotë angazhim në punë jo të ndaluara, ose në punë të urryera, ose në lënien e një pune që nuk është farz apo të një pune që nuk është mustehab. Marrëveshja lidhet vetëm me formulën e shoqëruar me emrin e Madhështorit, si për shembull, kur ti thua: "I kam dhënë besën Allahut", ose "Mbi mua është besa e Allahut", për pasojë qëndrimi në marrëveshjen e bërë është detyrim, kurse ai që e kundërshton ose e shkel këtë marrëveshje, ka mëkatuar dhe është i detyruar të bëjë shlyerjen për mëkatin e bërë. Kjo çështje, me lejen e Allahut, do të trajtohet më poshtë.

Për sa i përket premtimit, kuptimi i kësaj fjale është i dukshëm dhe është i njëjtë si në ligjin e fesë, ashtu edhe nga ana gjuhësore. Sipas ligjit të fesë, është mustehab që të mbahet premtimi, kurse nga ana morale, është detyrë që premtimi të kryhet.

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ne të Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!), e shikojmë premtimin si borxh që rëndon mbi ne, ashtu siç vepronte edhe i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)."*

Natyrisht, kur puna e premtuar është farz, patjetër që është farz edhe mbajtja e këtij premtimi, për vetë punën dhe jo për shkak të premtimit. Premtuesi duhet të mbajë parasysh fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Për tri gjëra nuk ka justifikim për asnjë njeri: dorëzimi i gjësë së lënë në mirëbesim (amanet) punëmirit e mëkatarit, mbajtja e besës së dhënë dhe mirësjellja ndaj dy prindërve, qofshin ata punëmirë ose mëkatarë."*

Për këtë çështje është edhe fjala tjetër e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Kur besimtari premton, ai e mban premtimin. Kur flet, ai thotë të drejtën dhe, kur i lihet një gjë në mirëbesim, ai nuk tradhton."*

Autori i librit "El Xheuahir ka thënë: "Nga sa shihet, fukahatë nuk janë shprehur se mbajtja e premtimit është detyrim."

Fjala *"akd"*–"kontratë", nga ana gjuhësore, do të thotë "lidhje", e kundërta e zgjidhjes, kurse te shumica e fukahave do të thotë "tërësi, propozim-pranim" dhe lidhja e këtyre faktorëve në atë mënyrë që me formimin e këtyre dy faktorëve realizohet një kuptim që ka ndikimet e tij të jashtme, si marrja e mallit në zotërim me anë të shitjes, ose pa shitje, siç është dhurata, ose marrja në zotërim e dobisë së objektit kundrejt qirasë, ose pa kompensim, siç është dhënia e sendeve pa kërkuar pagesë.

Bazuar mbi këto shpjegime, fjala *"akd"*–"kontratë" është emër që tregon ndërtimin e një lidhjeje që shpreh qëllimin e

propozuesit dhe të pranuesit, por jo i njëjti kuptim që kanë qëllim ata të dy, ose shkaktari për ndërtimin e këtyre dy faktorëve.

Me fjalë të tjera, kontrata është emër, sepse ajo ndërton dhënien në zotërim dhe jo për shkaktarin, për atë që ata të dy ndërtuan.

Me fjalë të tjera, fjala "kontratë" është emër për shkakun që mundëson dhënien në pronësi dhe marrjen në pronësi.

Fjala dhe puna

Kontrata lidhet me fjalë, me marrëveshje. Por a plotësohet apo nuk plotësohet ajo me punë?

Për këtë çështje, dijetarët e fik'hut xhaferij kanë dy thënie: *e para*: Kontrata nuk mund të jetë pa shqiptuar fjalët. Kjo është thënia më e përhapur. Autori i librit "El Xheuahir", duke përkufizuar kontratën, në fillim të kapitullit të dytë të librit "El Metàxhir", thotë: "Për realizimin e kontratës nuk mjafton vetëm shkëmbimi i ndërsjellë, ose i punëve të tjera pa fjalën."

Shejkhu El Ensarij, në librin e tij "El Mekasib", duke trajtuar fjalët e kontratës së shitjes, thotë: "Në të gjitha kontratat, fjala merret në konsideratë. Kjo thënie ka një përhapje shumë të madhe."

Thënia e dytë: Çdo gjë që tregon marrëveshje, ligjërisht e me traditë, është kontratë dhe është e barabartë, qoftë kur ajo është fjalë ose punë. Këtë e tregon fjala e Allahut të Lartësuar:

"إِلاَّ أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً عَنْ تَرَاضٍ"

"...përveçse kur është tregti për të cilën jeni në pajtueshmëri..."
(Sure "En Nisa", ajeti 29)

Në librin "Bulgatul Fekijh" kjo thënie i atribuohet Mufijdit, El Erdebijlij'jit, El Kashànij'jit dhe Es Sebzeuàrij'jit. Madje El Erdebijlij'ji, duke u bazuar mbi këtë thënie, në librin e tij "Sherhul Irshàd", ka nxjerrë katërmbëdhjetë argumente.

Autori i librit "El Urvetul Uthkà", në anësoret (hàshijeh) kushtuar librit "El Mekàsib", në faqen 83, botim i vitit 1324H, ka thënë: "Praktikisht, titujt e kontratave vërtetojnë origjinën, ashtu siç vërtetohet origjina me fjalën."

Ne jemi me këta të fundit. Argumenti ynë, së pari, është: Për ligjvënësin, në lidhje me kontratën, nuk ka të vërtetë e terminologji të veçantë, sepse kontrata ka ekzistuar para daljes së ligjit e para ligjvënësit, i cili nuk ka shtuar ndonjë gjë, por ai vetëm e ka pohuar dhe e ka miratuar atë, pasi ka ndarë dhe ka shpjeguar veprimet që përputhen me parimin e drejtësisë, për shembull, ka ndaluar shitjen e mallit që nuk dihet dhe përbën rrezik, ose ka ndaluar shitjen, kur në atë shitje ka forma të kamatës, sepse kamata është prej mëkateve të rënda, përfshirë të gjitha ndalesat e tjera të vërtetuara, që janë punë të ndaluara. Kurse për veprimet për të cilat ligjvënësi ka heshtur, ai veprim është i lejuar, në bazë të traditës dhe të legjislacionit, pasi nuk është në dinjitetin e ligjvënësit, as të neglizhojë e as të shpjegojë gjëra që ai nuk ka qëllim dhe për të cilat nuk është i kënaqur.

Me një fjalë, çështjet për të cilat ka një të vërtetë ligjore, siç janë adhurimet, patjetër kërkohet që ato të jenë të mbështetura

mbi një tekst ligjor, i cili shpreh punët me pajtueshmëri, domethënë në pajtueshmëri me tekstin e ligjvënësit, kurse punët për të cilat nuk ka të vërtetë prej ligjvënësit, si kontratat, atëherë ligjërisht është e mjaftueshme që ato të mos ndalohen dhe është e barabartë, qoftë kur kjo çështje ishte ose jo e pranishme në kohën e ligjvënësit.

Fjala e fukahave: "Kjo kontratë është ligjore, kurse kjo tjetra nuk është ligjore.", tregon se ligjvënësi ka shpikur të parën dhe nuk ka shpikur të dytën. Qëllimi i tyre është që kontrata e parë i plotëson të gjitha kushtet dhe në këtë kontratë të gjitha dispozitat ligjore janë të renditura, kurse në të dytën nuk janë.

E dyta: Shkaku justifikues për të bërë një fjalë kontratë, në të vërtetë, është argumenti i qartë për të ndërtuar e për të formuar një lidhje të përforcuar mes dy vetëve, duke ditur se është pajtueshmëria e dyanshme ajo që e miraton këtë veprim. Për këtë çështje kemi fjalën e Allahut të Lartësuar: **"...përveçse kur është tregti për të cilën jeni në pajtueshmëri..."** *(Sure "En Nisa", ajeti 29)*

Kur këto argumente ekzistojnë në njërën prej punëve, ne sistemojmë efektet e kontratës, derisa nuk kemi ndalim prej ligjvënësit.

Bazuar mbi këtë, ne mjaftohemi të shkruajmë edhe vetëm me shenjën e memecit dhe të jo memecit, me kusht që të jemi të vetëdijshëm për vërtetësinë e emrit të kontratës. Por, nëse nuk e dimë të vërtetën e asaj kontrate, atëherë i gjithë veprimi është vetëm fjalë boshe. E njëjta gjë është edhe kur dimë të vërtetën e emrit, kur ligjërisht ajo punë është e ndaluar.

Fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Në të vërtetë, fjala e bën haram dhe fjala e bën hallall."*, tregon se nuk mjafton vetëm nijeti, derisa nuk ka një argument të dukshëm me fjalë, që të tregojë për atë fjalë.[1]

Kur është argumenti faktik, atëherë është i mjaftueshëm, madje argumenti faktik mund të jetë shumë më i fuqishëm se argumenti fjalë, si për shembull, burri kryen marrëdhënie intime me gruan gjatë kohës së pritjes *(id'detun)*, në rastin e divorcit të kthyeshëm. Në këtë rast, veprimi i burrit tregon se divorci është anuluar, ose si shitja e sendit prej testamentlënësit, çka tregon se ai ka hequr dorë prej testamentit të lënë prej tij.

Me një fjalë, fjala është mjet dhe nuk është qëllim. Pra, fjala, në vetvete, nuk është qëllim, me përjashtim të martesës dhe të divorcit, për të cilat do të flitet me hollësi në kapitullin "Dhëniet e ndërsjella".

Kontrata e re

Në radhë të parë, duhet të bëjmë dallimin mes dy çështjeve.

E para: Fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse kontratat e porositura njiheshin në kuptimin e në karakterin e tyre në kohën e ligjvënësit, siç është shitja e qiradhënia dhe a duhet që ato të ndërtohen me një formulim specifik dhe me të njëjtat fjalë që ishin të njohura në atë kohë, ndryshe, në mënyrë absolute, nuk

[1] Për këtë çështje bën tregon edhe fjala e Imam Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Fjala mbetet në premtimin tënd, derisa ti nuk e ke thënë atë, por, kur e thua, atëherë fjala mbetet në të vërtetën e saj."*

mund të justifikohet ndërtimi i këtyre kontratave që ne e bëjmë fakt shitjen me formulën "e shita" dhe qiradhënien e bëjmë fakt me fjalën: "e lëshova me qira". Ndërtimi i këtyre kontratave lejohet edhe me çdo formulim që tregon këtë kuptim, madje edhe kur nuk është as në traditë e as e njohur si veprim. Çdo grup fukahash kanë mendime të ndryshme për këtë çështje. Më poshtë do të vijë edhe sqarimi i hollësishëm.

E dyta: Kontratat e reja, të panjohura më parë, që ndryshojnë prej kontratave të njohura, në kuptimin e në karakterin e tyre, madje për këto kontrata nuk përputhet asnjë emër prej emrave të kontratave, siç mund të jetë marrëveshja e autorit me botuesin për shtypjen e librit të tij, ose për përqindjen prej çmimit të përcaktuar, ose prej fitimeve.

Shtrohet pyetja: Këto kontrata, a janë apo nuk janë reale, plotësisht si kontratat e njohura? Pikërisht këto lloj kontratash janë objekti i këtij paragrafi.

Gjithashtu, duhet të tërheqim vëmendjen për rastin kur të dy palët e zbatojnë kontratën dhe me marrëveshje të plotë secila prej palëve angazhohet të plotësojë kontratën me vullnetin e me përzgjedhjen e vet, për pasojë asnjëri nuk ka të drejtë të ketë objeksion për kontratën, derisa ajo nuk bën hallall haramin dhe nuk bën haram hallallin. Por bëhet fjalë, kur njëri prej tyre e prish ose heq dorë prej kontratës dhe nuk e zbaton atë. Në këtë rast, a ka të drejtë apo jo pala tjetër t'i përmbahet kontratës?

Bazat dhe rregullat e fik'hut xhaferij nënkuptojnë se një kontratë e tillë, është reale, prandaj ajo duhet të zbatohet, kur plotësohen të gjitha kushtet e vëna në konsideratë, edhe kur ato

nuk janë në kundërshtim me ndonjërin prej parimeve të ligjit të shenjtë të fesë, ashtu siç shprehet ajeti 29 i sures "En Nisa":

"يَا أَيُّهَا الَّذِيْنَ آمَنُوا لاَ تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ إِلاَّ أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً عَنْ تَرَاضٍ مِّنْكُمْ ..."

"O ju që kini besuar, mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përveç tregtisë që bëni në pajtueshmëri me njëri-tjetrin...", si dhe ajeti 1 i sures "El Maide" : «أَوْفُوا بِالْعُقُودِ» **"...mbani besën për kontratat..."**

Mirza En Nàijnij, në librin "Pohimet e El Khauànsàrij", në faqen 104, botim i vitit 1358H, ka thënë: "Fjala e ajetit: **"...mbani besën për kontratat."**, nuk është specifike vetëm për kontratat e zakonshme dhe për marrëdhëniet e ndërsjella, por përfshin çdo kontratë, sepse vetë përmendja e fjalës "kontratat" në formën e shquar, tregon përgjithësim e gjithëpërfshirje dhe nuk tregon se është vetëm për kontratat ordinere prej kontratave të zakonshme.

Siç shihet, që të jenë të vlefshme marrëdhëniet e ndërsjella, nuk kanë nevojë që detyrimisht të jenë të mbështetura në tekst, por mjafton vetëm që të vërtetohet se te ato nuk ka ndalim. Me një fjalë, marrëdhëniet e ndërsjella, të cilat i kërkon jeta shoqërore, as nuk numërohen e as nuk janë të kufizuara, pasi fusha e veprimit me këto kontrata zgjerohet dhe shtohet me përparimin e me zhvillimin e jetës, prandaj çdo marrëdhënie e ndërsjellë, e vjetër ose e re qoftë, është detyrim ajo të zbatohet sipas qëllimit të vënë prej dy kontraktuesve, derisa ajo nuk mohon e nuk bie në kundërshtim në asgjë me parimet e ligjit të ndritur të fesë.

Teoria e përgjithshme

Në jurisprudencën islame (fik'h) ka rregulla të përgjithshme, që janë vepruese në të gjithë kapitujt e saj, domethënë, këto rregulla janë të veçanta për një kapitull të fik'hut, ndërsa për një kapitull tjetër të këtij fik'hut nuk janë, siç është rregulli i shoqërimit, baza e vlefshmërisë në punën e tjetrit, ose rregulli i mosmarrjes për argument argumentin inekzistent të një studiuesi (muxhtehid), pasi të gjitha këto përfshihen në mosqenien të detyrueshme dhe nuk janë veprime haram, prandaj hyjnë në kapitullin e punëve të përgjithshme dhe me liri veprimi, kur për ato veprime është vërtetuar se s'ka vend për dyshim, si dhe shumë rregulla të tjera të kësaj kategorie, ku përfshihen adhurimet, marrëdhëniet e ndërsjella, detyrimet dhe dispozitat.

Gjithashtu, në fik'h ka rregulla të veçanta, siç është rregulli: "Fëmija është i shtratit.", rregull që ka të bëjë me specifikimin e atësisë, ose rregulli i mundësisë për menstruacionet, që do të thotë se çdo gjak që ka mundësi të jetë menstruacion, është menstruacion; ose rregulli i dënimeve fizike, kur ato sprapsen për shkak të dyshimeve, si dhe rregulla të tjera.

Shtrohet pyetja: A ka rregull të fik'hut që është i veçantë për kontratën, prej nga është nxjerrë ky rregull, që nuk përfshin asgjë tjetër përveç kontratës, pra, është rregull i veçantë, pasi ai rregull ka të bëjë vetëm me kontratën dhe, në përgjithësi, ai rregull përfshin të gjitha kontratat pa asnjë përjashtim?

Përgjigje:

Patjetër që fukahatë e *fik'hut xhaferij* ndajnë një fjalë të vetme, se baza në kontratë është vërtetimi dhe vijueshmëria, që do të thotë se kontrata bëhet vepruese me miratimin e dy palëve dhe secila palë mbetet e angazhuar me kontratën, prandaj si bazë, kontrata nuk ka nevojë të ketë mbështetje në tekst. Gjithashtu, është e njëjta gjë kur të dyja palët e prishin kontratën me marrëveshje mes tyre. Por kur kontratën e prish vetëm njëra palë, ose njëra palë heq dorë prej kontratës dhe pala tjetër nuk heq dorë prej saj, atëherë pala që mbetet e angazhuar në plotësimin e kontratës, ka të drejtë të kërkojë prej palës tjetër zbatimin e kontratës. Në këtë rast, gjykatësi, në rast se te ai është ngritur padi, e detyron palën që prishi kontratën në mënyrë të njëanshme të zbatojë kontratën.

Argument për këtë detyrim është ajeti i parë i sures "El Maide":

"يَا أَيُّهَا الَّذِيْنَ آمَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ..."

"O ju që besuat, mbani besën për kontratat..."

Bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave, ky ajet ka ardhur në përputhje me traditën dhe shërben si bazë për lidhjen e kontratës. Shejkhu El Ensarij, në fillimin e librit "El Khijàràt", ka përmendur për këtë bazë katër kuptime, prej të cilave rezulton që kontrata është e zbatueshme para se atë ta prishë njëra prej dy palëve dhe pas prishjes së saj ose pas heqjes dorë prej saj, ne dyshojmë, nëse mbetet apo jo kontrata vepruese. Atëherë vëmë në veprim rregullin e shoqërimit dhe qëndrojmë në atë që është, pasi absolutja e mirënjohur nuk prishet me dyshim.

Vlen të theksohet se fjala e ajetit: **"...mbani besën për kontratat ..."** nuk është urdhër obligues, por është vetëm detyrë, në atë mënyrë që kundërshtuesi i këtij urdhri bëhet mëkatar dhe, për pasojë, meriton dënimin, ashtu siç është në rastin kur kontrata lidhet në kohën që thërret ezani për faljen e namazit të xhumasë, pasi në këtë rast, lidhësi i kontratës jo vetëm që ka kundërshtuar urdhrin, por ka kryer edhe mëkate. Megjithëkëtë, kontrata është e vlefshme, prandaj themi se qëllimi i fjalës së ajetit të mësipërm nuk është obligues, por është thjesht detyrë për të mbajtur premtimin e dhënë dhe angazhim për të plotësuar të gjitha çështjet që dy kontraktuesit kanë vënë në kontratë, si dhe puna me të gjitha rrjedhojat që vijnë prej veprimeve të shënuara në kontratë. Me një fjalë, ajeti i nderuar tregon një dispozitë obliguese, por që është në pozitën e dispozitës pozitive. Shpjegim më të qartë për këtë çështje do të jepet në fillimin e kapitullit "Kuvendi më i mirë", paragrafi "Angazhimi në shitblerje", prandaj referohu në këtë paragraf.

Kategoritë e kontratës

Kontrata ndahet në disa kategori, në përputhje me veçantitë dhe konsideratat. Nga pikëpamja e angazhimit ose e mosangazhimit për të përmbushur kontratën, ndahet në kontratë të detyrueshme, siç është: shitblerja, qiradhënia, qiramarrja e martesa dhe në kontratë jo të detyrueshme, siç është: dhurimi, depozitimi dhe prokurimi.

Të gjitha këto kontrata quhen kontrata të lejuara, sepse vihen në rrugën e drejtë vetëm me leje, kur ato janë ekzistuese ose

jo. Përveç kësaj, kontrata konsiderohet e lejuar, kur ajo lejohet prej të dyja palëve, siç është kontrata e kreditimit, në të cilën lejohet për krediituesin e për të krediituarin të heqin dorë e të rrezojnë kontratën kur të duan.

Gjithashtu, ka kontratë të lejuar vetëm për njërën palë, kurse për palën tjetër ajo është e detyrueshme, siç është penglënia, e cila është e lejueshme për pranuesin e pengut dhe e detyrueshme për penglënësin.

Kontrata, gjithashtu, kategorizohet në kontratë të qartë dhe në kontratë jo të qartë, siç janë qiraja dhe penglënia; kontratë e nënkuptueshme, siç është lënia e sendit në ruajtje në mirëbesim *(amanet)*. Në dy kontratat e lartpërmendura, paraja e sendi janë peng në dorën e penglënësit e të atij që pranon pengun dhe çdo gjë e pengut është e siguruar, përveç kur te pengu ka vënie dorë e abuzim.

Kontrata, gjithashtu, kategorizohet në kontratë, sipas kërkesave të varësisë së saj prej karakterit të kontratës e prej gjendjes së saj, siç është kontrata e garës dhe e qitjes, që do të thotë që dy vetë bien në marrëveshje se ai që qëllon objektin, do të ketë kaq ose këtë gjë, ose ai që arrin i pari në garë, do të ketë kaq. Kjo lloj kontrate nuk realizohet pa ndërvarësi dhe pa rrjedhojat e kësaj ndërvarësie, siç është kontrata e martesës, e shitblerjes, etj.

Gjithashtu, kontrata kategorizohet në kontratë operative, kur ajo del prej bazës ose prej të prokuruarit. Kontrata kategorizohet në kontratë të varur në vlefshmërinë e saj, kur ajo del prej atij që nuk disponon asgjë. Këto ishin disa prej kategorive

të kontratës. Por ka edhe konsiderata të tjera, në bazë të të cilave kontrata mund të ndahet edhe në kategori të tjera.

Gjithsesi, të gjitha kontratat pranojnë prishjen për ndonjë shkak ligjor, madje edhe martesa. Kontratat pranojnë edhe shkëmbimin e ndërsjellë, përveç kontratës së martesës.

Kategorizimi i kontratës në kontratë të vlefshme dhe në kontratë të prishur[1], do të thotë se kontrata është subjekt për të qenë reale ose e prishur. Nëse kontrata do të ishte vetëm e vlefshme, atëherë vetvetiu nuk do të ishte i drejtë kategorizimi i saj, sepse, si e tillë, ajo nuk mund të jetë në disa kategori, ose vetë sendi të jetë kategori e një sendi tjetër.

Në të vërtetë, kontrata, si subjekt, përfshin kontratën e vlefshme dhe kontratën e prishur me argumentin e vlefshmërisë së kategorizimit të saj në kontratë të vlefshme dhe në kontratë të prishur, pasi kuptimi i vlefshmërisë së kontratës sistemon efektin mbi kontratën, kurse kuptimi i prishjes së kontratës konsiston në mossistemimin e efektit të kontratës.

Siç shihet, ndarësi i përbashkët i këtyre dy kategori kontratash, njëkohësisht edhe bashkuesi i tyre, në përgjithësi, është pozitivizmi dhe pranimi nga ana e të mirëve për të sistemuar efektin mbi këto dy kategori kontratash, prandaj është e

[1] Hanefitë bëjnë dallimin mes kontratës së prishur dhe kontratës së gabuar. Kjo e fundit te hanefitë nuk mund të lidhet në mënyrë absolute, siç është kontrata e të çmendurit, kurse kontrata e prishur lidhet. Ajo e bën detyrim që të anulohet, siç është kontrata për një send të panjohur, në një kohë që fukahatë e Medh'hebit Xhaferij nuk bëjnë asnjë dallim mes kontratës së gabuar dhe kontratës së prishur, sepse në të dyja rastet, si bazë, kontrata nuk lidhet. Me këtë thënie të Medh'hebit Xhaferij bashkohet edhe shumica e medh'hebeve të tjera islame.

barabartë, qoftë kur sistemimi është faktik, kur ne mbledhim në kontratë kushtet e vlefshmërisë, qoftë kur nuk arrijmë sistemimin për shkak të humbjes së disa kushteve.

Duhet të tërhiqet vëmendja se përfshirja e kontratës, në vetvete, në kontratë të vlefshme dhe në kontratë të prishur, nuk është në kundërshtim me mbartjen e kontratës në shkrimet legjislative, në lidhje me veçantinë e kontratës së vlefshme.

Po përmendim fjalën e Allahut të Lartësuar: "... أَوْفُوا بِالْعُقُودِ..." - **"...mbani besën për kontratat"**, si dhe ajete të tjera të Kur'ànit Famëlartë, sepse argumenti në këtë ajet ka ardhur në kontekstin e vijimit të fjalisë. Gjithashtu, kur burri betohet se nuk do të lidhë kontratë të veçantë, në të vërtetë, ai ka parasysh kontratën e vlefshme dhe jo që vetë kontrata të jetë subjekt për të veçantën, sepse mendja, në rastin e autorit të librit dhe të botuesit, orientohet kah pohimi që botuesi, në të vërtetë, ka pasur qëllim kontratën e vlefshme dhe jo kontratën e prishur.

E njëjta gjë ndodh edhe me kontratën e qirasë, pasi në përgjithësi, në këtë rast lidhet kontratë e vlefshme, kurse kontrata e prishur, në këtë lloj kontrate, është gjë tjetër. Gjithashtu, është gjë tjetër edhe përdorimi i kontratës për individin e shëndetshëm (mendërisht).

Autori i librit "Miftahul Kerameh", në kapitullin "El Metàxhir" ka thënë: "Në të vërtetë, shitblerja, nga ana gjuhësore dhe nga ana e traditës, përmbledh të vlefshmen dhe të prishurën. E njëjta gjë është edhe nga ana e ligjit të fesë, për shkak të mospasjes bazë në tekst. Vërtetësia e kategorizimit mes dy llojeve të kontratës, në ligjin e fesë, me fjalën e përbashkët të fukahave,

dëshmon unifikimin e kuptimit të shitblerjes dhe të mosekzistencës së argumenteve ligjore në të."

Me fjalën "unifikimin e kuptimit të shitblerjes", autori i lartpërmendur, tregon se kuptimi i shitblerjes, në ligjin e fesë e në traditë, është i njëjtë, edhe pse në ligjin e fesë është subjekt vetëm për kontratën e vlefshme, ndërsa sipas traditës, kuptimi i shitblerjes është më përgjithësues, pasi përfshin kontratën e vlefshme dhe kontratën e prishur. Patjetër që për ligjvënësin do të kishte një të vërtetë të veçantë, në lidhje me kuptimin e fjalës shitblerje, por supozohet e kundërta e kësaj.

Kuptimi i shitblerjes

Qëllimi ynë këtu, i përdorimit të fjalës "shitblerje", është ai kuptim për të cilin tregon vetë fjala dhe jo forma e fjalës, domethënë qëllimi është shkaktari dhe jo shkaku, pasi në ligjin e fesë, nuk ka tekst që të përcaktojë kuptimin e shitblerjes, për pasojë edhe fukahatë nuk mund të kenë ndonjë traditë të veçantë për këtë çështje, pasi ligjvënësi ka pohuar atë çka ishte në traditë. Atëherë edhe specifikimi i fukahave për shitblerjen është specifikim i kuptimit tradicional. Janë të shumta fjalët e fukahave në lidhje me kuptimin e fjalës "shitblerje", por fjala e tyre më e përhapur është: shkëmbim i mallit me mall.

Çështja në përkufizim është e lehtë dhe e thjeshtë, sidomos në fushën e fik'hut dhe të gjuhësisë, sepse nuk është përkufizim për substancën e llojit dhe të ndarjes, nuk është as përkufizim i substanciales me llojin e me ndarjet, nuk është as përkufizim i balancuar për të identifikuarin nga të gjitha anët, por është vetëm

përkufizim fjale. Me këtë dua të them se ky përkufizim tregon për kuptimin dhe afrimin e këtij kuptimi drejt mendjes.

Sido që të jetë, shitblerja, në tekstet ligjore, është në pozitën e kuptimeve të traditës dhe, kur emri "shitblerje" përputhet me tradicionalen, për shembull, në transportimin, në marrjen në zotërim dhe në tjetërsimin, atëherë është e detyrueshme që mbi këtë koncept të rendisim të gjitha ndikimet ligjore, derisa të vërtetohet e kundërta, kur ne dyshojmë, nëse ligjvënësi (juristi i ligjit të fesë - fekijhu) ka vënë apo jo në konsideratë një punë të shtuar mbi atë që është e njohur, pasi në origjinë nuk është, derisa për këtë punë të gjendet argumenti ligjor.

Sikur ligjvënësi të kishte qëllim të kundërtën e asaj që është traditë, patjetër që do të kishte dhënë shpjegime, madje do të ishte orientuar drejt asaj pune, por, meqenëse ai nuk ka dhënë shpjegime, është e kuptueshme që nuk ka as kundërshtim.

Kategoritë e shitblerjes

Shitblerja ndahet në disa kategori:

- shitblerje optimale *(bej'ul fudùlij)*, që do të thotë se propozimin ose pranimin nuk e ka në dorë as origjinali e as i prokuruari;
- shitblerje e vonuar *(bej'u nesij'eh)*, që do të thotë se malli jepet në dorë dhe çmimi vonohet;
- shitblerje me parapagim *(bej'u selem)*, që do të thotë se jepet çmimi dhe vonohet dhënia e mallit;
- kambizmi *(bej'u sarf)* që është i veçantë për shkëmbimin e floririt e të argjendit;

- shitblerje me çmim të caktuar *(bej'ul muràbehah)*;
- shitblerje me humbje të caktuar *(bej'ul muvàda'ah)* dhe shitblerje me kapital *(bej'u teulijeh)*.

Për të gjitha këto kategori të shitblerjes do të flitet me hollësi.

* * *

DHËNIA E DYANSHME

Thëniet

Fukahatë e fik'hut xhaferij ndajnë një mendim të përbashkët: Jo vetëm shitblerja, por asnjë kontratë nuk mund të bëhet vetëm me konsensus të pashprehur me fjalë ose me punë, domethënë, shkaku detyrues për sistemimin e efekteve është ekzistenca e konsensusit dhe shprehja e konsensusit me fjalë dhe jo vetë konsensusi, prej ngado që ai të jetë.[1]

Autori i librit "El Urvetul Uthkà", në margjinaturat *(hàshijeh)* e librit "El Mekàsib", në faqen 64, botim i vitit 1324H, thotë: "Shitblerja konsiderohet e vërtetë, kur ka një pohim të jashtëm me fjalë, ose me shenjë, ose me shkrim, ose me dhënie të dyanshme, ose me dhënie të njëanshme. Sikur marrja në pronësi të jetë në zemrën e tij dhe blerësi të pranojë, në të vërtetë, kjo nuk

[1] Ndodh që vetëm konsensusi të jetë shkak për lejimin, siç është veprimi i njeriut në disa prej pasurive të të afërmit e të shokut të tij, ashtu siç veprohet zakonisht. Këtë konsensus fukahatë e kanë shprehur me termin "veshi i përmbajtjes". Prej të madhit, shejkhut Et Tùsij, citohet se e taksura *(nedhr)* dhe marrëveshja, lidhet vetëm me nijetin. Me lejen e Allahut, shpjegimet e hollësishme, në lidhje me këtë çështje do të jepen në vendin e vet.

është shitblerje. Kështu qëndron puna nga ana e jashtme, për të gjitha kontratat e detyrimet."

Bazuar mbi këtë që u tha, duhet të mbartet edhe fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Në të vërtetë, fjala bën hallall, fjala bën haram."*

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se formulimi verbal që nxjerr në dukje konsensusin, është ai që e plotëson shitblerjen dhe të gjitha marrëdhëniet e tjera të ndërsjella, madje formulimi verbal është rruga më e pëlqyer dhe më e plotë për të vënë në dukje dhe për të shprehur qëllimin.

Fukahatë kanë mendime të kundërta në lidhje me faktin se a realizohet shitblerja, kur shprehet me një punë të hapur dhe jo sipas fjalës së autorit, ofertë e pranim. Shembull për këtë shitblerje shërben të arrihet malli i ekspozuar mes dy vetëve dhe pas marrëveshjes për çmimin, blerësi i paguan shumën pronarit të mallit dhe ai i jep blerësit mallin pa thënë as e shes e as e pranoj, sepse marrja e mallit është fakt pranimi e miratimi, ndërsa dhënia e mallit u bë pa shqiptuar fjalët e dhashë e pranova. Këtë lloj shitblerje fukahatë e kanë emërtuar "dhënie e dyanshme" *(muàtàt)*, sepse kemi të bëjmë me shkëmbim marrje-dhënie mes dy palëve, me qëllim dhënie në dorë e marrje në zotërim, krahas ekzistencës së të gjitha kushteve të shitjes, në këtë shkëmbim të ndërsjellë, përveç shqiptimit të fjalëve e "dhashë", e "pranova".

Kjo shitblerje vërtetohet, kur secila prej dy palëve e dha dhe e mori mallin në të njëjtën kohë. Për sa i përket marrjes e dhënies vetëm prej njërës palë, siç është marrja e çmimit, por jo e mallit, ose e kundërta, do të flitet më poshtë.

Përveç kësaj, shitblerja me dhënie të dyanshme është prej çështjeve më të vogla, për të cilat ne folëm më lart, në nëntitullin "Kontrata dhe puna", ku pamë se fjala ishte pikënisja për lidhjen e kontratës në të gjitha veprimet e ndërsjella, qoftë shitblerje, qoftë veprime të tjera. Këtu do të flitet vetëm për shitblerjen. Në çdo rast, dijetarët e fik'hut xhaferij kanë pasur kundërshtime mes tyre për çështjen e dhënies së dyanshme, për të cilën ata kanë disa thënie. Këtë lloj marrëdhëniesh, shejkhu El Ensarij, në librin "El Mekàsib", e ka përcaktuar deri në gjashtë thënie.

Mirzà En Nàijbij, në librin "Takrijràtul Khauànsàrij", i ka mbështetur në katër thënie:

Thënia e parë, njofton për pronësi të domosdoshme. Në këtë thënie ka arritur Mufijdi, shejkhu i grupit dhe një grup dijetarësh të tjerë të fushës së fik'hut xhaferij.

Thënia e dytë, njofton për një pronësi të lejuar. Në këtë thënie kanë arritur shejkhu Ali El Kerkij, i njohur me emrin "El Muhakkiku Eth Thanij", si dhe shumë fukaha të mëvonshëm, të cilët kanë arritur në grada të larta të diturisë dhe janë dijetarët më në zë. Disa prej këtij grupi, janë: Sej'jid Ebul Hasen El Isfehànij, Mijrzà Husejn En Nàijnij, Sej'jid Muham'med, i quajtur "Bahrul Ulum". Ata kanë pohuar se kjo është thënia më e përhapur te fukahatë e mëvonshëm.

Sej'jid El Isfehànij, në librin "Uesijletu Nexhàtil kubrà", thotë: "Thënia më e fuqishme është se dhënia e dyanshme tregon pronë dhe kjo pronë është e lejuar prej të dyja palëve, por nuk është e detyrueshme, kur prishet një prej mallrave të shkëmbyeshëm, ose kur veprohet me mall të tjetërsuar, ose me

ndërrimin e transferuesit të mallit, ose me vdekjen e njërit prej dy kontraktuesve."

Sej'jid Bahrul Ulùm, në librin "El Bulgatu", thotë: "Thënia që njofton dhënien e dyanshme të pasurisë së lëkundshme dhe jo vetëm lejim të thjeshtë, është thënia më e fuqishme."

En Nàijnij, në librin "Takrijràtul Khauànesàrij", në faqen 49, thotë: "Më e fuqishme është të thuhet: 'Dhënia e dyanshme me qëllim pronësie tregon për pronësi të lejuar, sepse kjo është ajo që shprehin rregullat e ligjit të fesë si dhe argumentet e ardhura me varg të pashkëputur transmetuesish."

Thënia e tretë: Dhënia e dyanshme tregon lejimin absolut e gjithëpërfshirës të të gjitha veprimeve, madje edhe veprimin e pasurisë së kushtëzuar, si shitblerja, lirimi i skllavit, ose përdorimi i skllaves për marrëdhënie intime, sepse nuk ka as shitblerje, as lirim e as përdorim për marrëdhënie intime, veçse me pasurinë. Këto thënie i atribuohen fukahave më në zë të mëparshëm.

Thënia e katërt: Dhënia e dyanshme tregon një lloj të veçantë veprimi, që nuk varet nga pronësimi i pasurisë dhe, kur ai ble një skllav ose një skllave me dhënie të dyanshme, lejohet përdorimi i skllavit dhe i skllaves, por për atë nuk lejohet as ta shesë skllavin e as të kryejë marrëdhënie intime me skllaven.

Mbështetësit e thënies së pasurisë së lejuar dhe legjitime janë shprehur se, kur prishet çmimi dhe malli, dhënia e dyanshme është e detyrueshme plotësisht, siç është shitblerja e kryer sipas formulës së shprehur me fjalë.

Autori i librit "Miftahul Kerameh", në librin "El Metàxhir", në faqen 157, thotë: "Midis tyre, domethënë midis fukahave, nuk ka asnjë kundërshtim kur malli përkatës i njërës palë prishet, shitblerja bëhet e detyrueshme. Pra, bëhet fjalë për prishjen e njërit mall."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa dyshim e pa asnjë kundërshtim, në mesin e fukahave, dhëniet e dyanshme përfundojnë në marrëdhënie të detyrueshme dhe prishja konkrete ose ligjore e dy mallrave njëherësh, është motiv tregues që shitja është vërtetuar."

Këto katër thënie janë përmendur në lidhje me dhënien e dyanshme, të sqaruara së bashku me argumentet përkatëse në pjesën më të madhe të librave të fik'hut xhaferij, si në librat: "El Hadàik", "El Xheuàhir", "Bulgatul Fekijh", "El Mekàsib", "Takrijràtul Khvànsàrij", "Miftahul Kerameh", etj.

Pavarësisht nga të gjitha këto, dijetari poliedrik Es'senhùrij, i atashon Medh'hebit Xhaferij thënien për moslejimin e dhënieve të dyanshme. Për këtë ai ka cituar thënie të marra prej faqeve 151, 154 dhe 164, të vëllimit 4 të librit "Miftahul Kerameh". Thëniet që ne cituam, gjenden pikërisht në këto faqe, si dhe në faqe të tjera të këtij libri, thënie të cilat autori i librit "El Xheuahir" i ka përmendur me qartësi, së bashku me argumentet përkatëse.

Gjithashtu, shejkhu Es Senhùrij, së bashku me autorin e librit "El Xheuahir", kanë përmendur se mbështetësit e lejimit, ashtu siç theksuam më sipër, kanë thënë se, me prishjen e dy mallrave, dhënia e dyanshme përfundon në detyrim të imponuar.

Bazuar mbi thëniet që u shtuan, bëhet e qartë se fjala e dijetarit Es Senhùrij: "Medh'hebi Xhaferij nuk lejon dhënien e dyanshme.", është tepër larg shprehjes shkencore të besueshme, për të cilën është detyrë të bëhet kujdes i hollësishëm, njëkohësisht tregon se kërkohet një ruajtje e veçantë për çdo thënie të këtij medh'hebi, veçanërisht për thëniet që janë në pozitën e citimeve. Doktori, kur ka parë që shumica e fukahave të mëparshëm të Medh'hebit Xhaferij, kanë thënë se dhënia e dyanshme tregon lejimin, shprehet për moslejimin.

Siç shihet, ky orientim nuk përputhet me metodën e dijetarëve të vërtetimit të transmetimeve, sidomos të dijetarëve më të mëdhenj të kësaj fushe, siç është Es Senhùrij… Megjithëkëtë, vetëm Allahu është i pagabueshëm.

Thënia më e saktë

Thënia më e saktë, ndër katër thëniet është: Dhëniet e dyanshme tregojnë pasurinë e detyrueshme. Ndër fukahatë e mëparshëm, në këtë thënie ka arritur Mufijdi, shejkhu i grupit (vdekur në vitin 413H), kurse prej të mëvonshmëve, dijetari Sej'jid, autori i librit "El Urvetul Uthkà", (vdekur në vitin 1337H), në margjinaturën e librit "El Mekasib" ka nxjerrë katër argumente, të cilat më poshtë do t'i citojmë me pak ndryshim në formulim e në formë, gjithnjë duke ruajtur brendinë:

1- Dihet prej jetëshkrimit të dijetarëve të fesë dhe dijetarëve që merren me punët e kësaj bote se njerëzit e brezit të parë të myslimanëve (selefi), që prej kohës së të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe deri

në kohën tonë, sendin e marrë me dhënie të dyanshme e trajtojnë si send të marrë sipas formulës së shprehur me fjalë, pa asnjë ndryshim. Vetë Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe sahabët e tij, Imamët e dijetarët dhe të gjithë njerëzit kanë vepruar me dhuratat e me dhëniet e dyanshme, siç veprojnë pronarët me pasurinë e tyre, pa e shoqëruar dhënien me formulim me fjalë, duke e ditur se nuk ka asnjë dallim mes dhënies së dyanshme dhe shitblerjes.

2- Fukahatë e Medh'hebit Xhaferij ndajnë një fjalë të përbashkët, që sendi i marrë me dhënie të dyanshme, lejon që me këtë gjë të kryhen të gjitha veprimet, prandaj nuk ka asnjë dyshim se thënia për lejimin e të gjitha veprimeve me sendin e marrë me dhënie të dyanshme, nuk ka asgjë të përbashkët me thënien për mosmarrjen e atij sendi në zotërim, përveçse në disa orientime të gabuara, të cilat nuk duhet të dalin prej një juristi të fesë *(fakijh)*.

3- Çështja e dhënieve të dyanshme referohet në faktin që në lidhjen e kontratës është apo nuk është kusht formulimi me fjalë. Për këtë kusht nuk ka argument, por mospasja e argumentit për çështje të tilla është tregues për jo, sepse, sikur të ishte kusht, patjetër që ligjvënësi do të kishte dhënë shpjegime, duke ditur se të tilla shpjegime te ne nuk kanë arritur as prej Ehli Sunetit e as prej shi'ave, megjithëse ka shumë pretendime e motive që janë kundër citimit, sidomos për këtë çështje dhe për çështje të tjera të kësaj kategorie.

4- Sendi i marrë me dhënie të dyanshme, tradicionalisht dhe nga ana gjuhësore, vërtetohet të quhet me emrin shitblerje, pasi saktësia e këtij veprimi përfshihet te argumentet e Kur'anit dhe te transmetimet.

Po përmendim disa ajete prej Allahut të Lartësuar: **"Allahu ka lejuar shitblerjen.", "Vetëm nëse është tregti me miratim mes jush." "... mbani besën për kontratat..."**

Edhe disa hadithe prej të Dërguarit më të madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Besimtarët janë në kushtet e tyre." "Njerëzit zotërojnë pasuritë e tyre."**

Këto dhe shumë argumente të tjera tregojnë saktësinë e vlefshmërisë së shitblerjes, madje tregojnë edhe detyrimin për shitblerjen e bërë.

Si përmbledhje të këtij argumenti të katërt, të cilin Sej'jidi e ka cilësuar bazë e kolonë të këtij kapitulli, ne e dimë mirë që ligjvënësi e ka finalizuar shitblerjen tradicionale, gjithashtu, e dimë mirë se për realizimin e shitblerjes tradicionale, duhen dy persona: shitblerje e shqiptuar me fjalë dhe një tjetër për dhënien e dyanshme.

Dimë se personi i parë, në mënyrë absolute, është ai për të cilin ka qëllim ligjvënësi, sepse ai bën marrëveshjen, kurse për personin e dytë ne dyshojmë: Vallë është apo jo qëllimi për atë? Kjo është fushë në të cilën fukahatë kanë kundërshtime, por fjala e ligjvënësit: **"Allahu ka lejuar shitblerjen",** bën të qartë se me fjalën e dy personave, në mënyrë të barabartë, vërtetohet që shitblerja me dhënie të dyanshme është pikërisht qëllimi dhe është plotësisht si shitblerja e realizuar sipas formulës së shqiptuar me fjalë.

Sikur të ishte qëllim për shitblerje vetëm sipas formulës së shqiptuar me fjalë, ashtu siç bëhet e qartë prej dy personave së bashku, në këtë rast, ai ka pasur qëllim një gjë të veçantë dhe ka

folur për atë që është më gjithëpërfshirëse se vetë gjëja. Por ky është mashtrim me injorancë, për të cilin dijetarët janë krejtësisht të pastër.

Përveç kësaj, dhënia e dyanshme në atë kohë ishte shumë e përhapur dhe përfshinte pjesën më të madhe të marrëdhënieve të jetës. Me këtë mënyrë, njerëzit blinin e blejnë sendet e nevojës së parë, si ushqim, veshmbathje e orendi, pa bërë asnjë dallim mes të urryerit e të rrezikshmit. Me këtë mënyrë, ata zënë vend në hotele, abonohen për furnizim me ujë, energji elektrike e telefon, udhëtojnë me avionë e me makina dhe kryejnë të gjitha praktikat e nevojshme, deri edhe moslejimin e kthimit, madje edhe para konsumimit dhe transportimit. Të gjitha këto shkëmbime të ndërtuara sipas traditës, janë reale e të zbatueshme, sidomos kur në to përfshihet ndonjë verifikim, me përjashtim të rastit, kur për këtë veprim ka ndalim të veçantë, ose kur veprimi bën hallall haramin, ose bën haram hallallin. Por nuk ka as ajet të Kur'anit e as ndonjë transmetim që të njoftojë as nga larg e as nga afër për ndalimin e dhënies së dyanshme, ose për daljen e një marrëdhënie të ndërsjellë të re. Në të kundërt, dhënia e dyanshme përputhet katërçipërisht me parimet lehtësuese dhe toleruese të ligjit të fesë.

Derisa argumentet tregojnë se me dhënien e dyanshme përfitohet pasuria e detyrueshme, përfundimisht renditen edhe të gjitha efektet e pasurisë mbi sendin e marrë me dhënie të dyanshme, siç janë: shitblerja, dhurimi, lirimi i robit dhe kalimi i pasurisë te trashëgimtarët.

Bazuar mbi këto që u thanë, nuk mbetet më vend për degët që kanë ndarë fukahatë në lidhje me dallimin mes fjalës që njofton

lejimin e dhënies së dyanshme dhe mes fjalës që njofton për pasurinë.

Fukahatë kanë thënë shumë fjalë në lidhje me dhënien e dyanshme, patjetër që kanë sjellë edhe argumentet për fjalët e thëna, si dhe ato çka është thënë në lidhje me këto argumente, ose ato që mund të thuhen rreth tyre.

Veç kësaj, degëzimet që dalin prej bazës së këtyre argumenteve zbulojnë sa i ashpër është debati e diskutimi mes fukahave dhe sa të përpunuara janë mendimet e tyre, aq sa duket se diskutimet e debatet mes tyre janë bërë për ata një natyrë e dytë. Megjithëkëtë, pas të gjitha këtyre që ne përmendëm, fukahatë kanë bërë disa paralajmërime, në të cilat ka dobi që lidhen me subjektin. Këto paralajmërime ne po i sjellim të përmbledhura si më poshtë vijon:

Dhënia e njëanshme

Padyshim që dhënia e dyanshme vërtetohet në kuptimin më të qartë me dhënien e me marrjen prej dy palëve, në atë mënyrë që secila palë është marrës e dhënës në të njëjtën kohë. Por a vërtetohet dhënia e dyanshme, kur dhënia është vetëm prej njërës anë, si për shembull, kur çmimi jepet në çast dhe kur çmimi jepet më vonë, ose e kundërta?

Le të supozojmë se për këtë lloj dhënie nuk mund të vërtetohet emri dhënie e dyanshme, sepse, në fakt, është dhënie e njëanshme, por gjithsesi ajo është marrëdhënie e dyanshme, atëherë a i jepet kësaj dhënie gjykimi se ajo është dhënie e

dyanshme e vërtetë, mbi të cilën ne mund të sistemojmë të gjitha dispozitat në lidhje më dhënien e dyanshme, në atë mënyrë që nga jashtë të jetë subjekt dhe nga brenda saj dispozitë?

Përgjigje

Në të vërtetë, kjo lloj marrëdhënie nuk hyn si subjekt në dhënien e dyanshme, pasi, realisht, për atë nuk mund të vërtetohet as emri e as titulli i saj si dhënie e dyanshme, sepse dhënia e dyanshme është veprim reciprok që kryhet prej të dyja palëve dhe nuk është veprim që kryhet vetëm prej njërës palë. Por fjala "dhënie e dyanshme" dhe përkufizimi i saj nuk përbën asnjë interes për fukahatë, të cilët interesohen vetëm për fjalët që kanë ardhur me gjuhën e ligjvënësit. Në një kohë që presupozohet që për dhënien e dyanshme nuk ka ardhur argument as në ajet e as në transmetime. Është fakt se, ajo që ka ardhur në argumentet e ligjit të fesë, është fjala shitblerje *(bej'un)* dhe janë fukahatë ata që kanë folur për dhënie të dyanshme, sepse për dhënien e dyanshme vërtetohet që ajo quhet shitblerje. Kjo është arsyeja që disa fukaha, nisur nga tërësia e argumenteve, i kanë dhënë dhënies së dyanshme emrin shitblerje dhe e kanë futur atë në dispozitën e shitblerjes. Disa fukaha të tjerë, dhënies së dyanshme i kanë dhënë emrin shitblerje, por nuk e kanë futur atë në dispozitën e shitblerjes, me pretendimin e specifikimit të argumentit, prandaj te të gjithë fukahatë ajo duhet vënë në konsideratë me argument dhe jo nga emri "dhënie e dyanshme".

Përveç kësaj që u tha, argumenti i ligjit të fesë nuk bën dallim në dispozitë mes dhënies vetëm prej njërës palë, ose

dhënies prej dy palëve, kur prej të dyja palëve është vërtetuar emri shitblerje. Në këtë kontekst, dispozita për dhënien e njëanshme, është edhe dispozita për dhënien e dyanshme, edhe pse nuk vërtetohet për dhënien e njëanshme emri i dhënies së vërtetë si dhënie e dyanshme, ose nëse dëshiron, thuaj: Dhënia e njëanshme si subjekt është jashtë dhënies së dyanshme, por është brenda dispozitës së saj.

Me këtë shpjegim gjejmë edhe komentin e fjalës së shejkhut El Ensarij, në librin "El Mekàsib": "Nuk ka dyshim që për dhënien vetëm prej njërës palë nuk mund të vërtetohet kuptimi i termit dhënie e dyanshme, megjithëse kjo nuk është pengesë që mbi dhënien vetëm prej njërës palë të zbatohet dispozita e dhënies së dyanshme, gjithnjë bazuar në faktin se dispozita përfshin çdo shitblerje faktike, pasi edhe në këtë rast, në rastin e dhënies së njëanshme, kemi marrje në pronësi të njërës prej dy palëve, ose kemi lejim për kompensim, ndërkaq pala tjetër merr në zotërim ose lejon."

Sej'jid El Jezdij, në margjinaturën e tij *(hàshijeh)*, në faqen 47, ka komentuar atë që ka shprehur shejkhu El Ensarij rreth kësaj çështjeje: "Kjo zgjatje nuk është e nevojshme, edhe nëse komenti hyn në tërësinë e këtij argumenti ligjor, por nuk ka vërtetim për titullin "Dhënie e dyanshme", sepse dihet se, në tërësinë e argumentit, nuk ka dallim për atë që ndodh mes dy palëve ose edhe vetëm prej njërës palë."

Autori i librit "El Xheuahir ka thënë: "Për ty nuk është e panjohur se fjala dhënie e dyanshme nuk ka ardhur në tekst që edhe dispozita të ndjekë këtë dhënie, kur për atë nuk ka kusht dhe sendi shtihet në dorë vetëm prej njërës palë, madje është e

mjaftueshme që sendin ta shtjerë në dorë njëra prej dy palëve, ashtu siç ka shkruar Shehijd El Kerkij."

Këto thënie të fukahave, si dhe thënie të tjera të tyre, tregojnë qartë se dispozita për dhënien vetëm prej njërës palë është si dispozita për dhënien prej të dyja palëve, pavarësisht nga kundërshtimi që kanë fukahatë mes tyre, që termi "dhënie e dyanshme" tregon pasuri ose lejim.

Kushtet

Në dhënien e dyanshme, a duhet të plotësohen të gjitha kushtet e marra në konsideratë në kontratë, përveç dy fjalëve ofertë dhe pranim, në atë mënyrë që dhënia e dyanshme të jetë e kushtëzuar prej të njëjtave rregullave që kushtëzojnë kontratën e dhënies së dyanshme, siç kushtëzojnë në kontratën e qirasë, sepse çdo marrëdhënie, në këtë drejtim, kushtëzohet në dhënie të dyanshme, pasi, kur mungon njëri kusht, dhënia e dyanshme prishet dhe është e pavlefshme, ose nuk është e detyrueshme të mblidhen të gjitha kushtet, por mjafton vetëm mirëkuptimi i ndërsjellë. Kemi edhe rastin, kur fryti i marrëveshjes del në shesh vetëm pas dhënies së dyanshme, kur njëra prej gjërave që shkëmbehet, nuk dihet, për shembull, kur blerësi i thotë furrtarit: "Më jep një bukë me këtë lirë.", në një kohë që blerësi nuk e di sa është çmimi i bukës, ose kur i thotë: "Më jep aq bukë sa para kam në xhep.", ose kur ble, duke e ditur çmimin, por që do të paguajë pa kohë të caktuar, domethënë, ai do të paguajë, kur të ketë. Kur ne themi se, në dhënien e dyanshme duhet të plotësohen patjetër të gjitha kushtet, ndryshe ajo është e prishur, kemi parasysh që

fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët dhe janë shprehur se dituria është kusht në shitblerjen, në dhënie-marrjen e mallit, ndërsa, kur ne themi që dituria nuk është kusht, kemi parasysh faktin që dhënia e dyanshme, është një bashkëveprim i pavarur nga shitblerja, madje mund të thuhet se kjo marrëdhënie e dyanshme është reale dhe e pavarur nga të gjitha kontratat.

Autori i librit "Miftahul Kerameh" ka thënë: "Për këtë çështje ka dy thënie." Pastaj ka pëlqyer të thotë se dhënia e dyanshme nuk kushtëzohet me të njëjtat kushte me të cilat kushtëzohet shitblerja. Për këtë ai ka sjellë dëshmitë e një grupi juristësh të ligjit të fesë *(fukaha)*.

Nga ana jonë, pasi kemi përzgjedhur, themi: Dhënia e dyanshme është e veçantë nga shitblerja, por dhënies së dyanshme i kemi dhënë të gjitha dispozitat e shitblerjes dhe përfundojmë t'i japim asaj edhe të gjitha kushtet e shitblerjes. Kështu qëndron çështja edhe me të gjitha kontratat e tjera, pa asnjë dallim, nëse dihet ose jo njëri prej sendeve që shkëmbehen, apo ai është ndonjë send tjetër, sepse argumenti që tregon për marrjen në konsideratë të kushtit, nuk ka bërë dallim mes ndodhjes së marrëdhënies së ndërsjellë të shqiptuar me fjalë sipas formulës dhe mes asaj marrëdhënie të realizuar me punën. Bazuar mbi këtë që u tha, dhënia e dyanshme është pa vlerë, kur nuk plotësohen të gjitha kushtet që duhet të plotësohen në një kontratë.

Shkëmbimi

Ai që ble një mall me para, pronari i mallit është shitësi dhe paguesi i parave është blerësi. Është e njëjta gjë, kur ai ble një mall me një çmim të caktuar, por prej shitësit, në vend të mallit të kërkuar, merr një mall tjetër me të njëjtin çmim. Kur ai shkëmben një mall me një mall tjetër, jo me qëllim çmimin dhe vlerën e mallit, por me qëllim shkëmbimi të ndërsjellë, shtrohet pyetja: Është apo nuk është e vlefshme kjo marrëdhënie? Nëse supozojmë se ajo është e vlefshme, a ka ndodhur shitblerja, ose pajtim, ose marrëdhënie e pavarur? Nëse supozojmë se ajo është shitblerje e vlefshme, atëherë cili prej atyre të dyve është shitësi dhe cili është blerësi? Apo çdo njëri prej atyre të dyve është shitës nga njëra anë dhe blerës nga ana tjetër?

Në lidhje me këtë çështje, ka shumë mundësi potenciale dhe fjalë. Shejkhu El Ensarij anon ka thënia se kjo marrëdhënie e ndërsjellë është e vlefshme si shitblerje dhe shitësi është ai që jep i pari mallin, sepse me këtë dhënie ai është propozues dhe marrësi i mallit është blerësi, i cili, me marrjen, bëhet pranues.

Sej'jid El Jezdij në margjinaturën e tij, në librin "El Mekàsib", ka thënë: "Kjo ndodh në pajtim, sepse këtu qëndron kuptimi i pajtimit të dyanshëm."

Shejhu En'nàijnij ka thënë: "Në themel, kjo marrëdhënie është e gabuar, sepse të dy shkëmbyesit kanë pasur qëllim shitblerjen dhe jo gjë tjetër, për pasojë ne nuk kemi mundësi në këtë gjendje të cilësojmë këtë marrëdhënie të ndërsjellë shitblerjeje, për shkak të mosnjohjes së shitësit dhe dallimit të tij prej blerësit, ashtu siç nuk është e mundur që secili prej dy palëve

të jetë shitës nga njëra anë dhe blerës nga ana tjetër, sepse, kur një herë arrihet oferta dhe pranimi, për ata të dy nuk ka më vend për herë të dytë, pasi këtu kemi të bëjmë me realizim në favor të rezultatit; kurse moscilësimi si jo shitblerje në marrëdhëniet e ndërsjella, nuk është i mundur, sepse në marrëdhënie të tilla, në mënyrë absolute, nuk mund të ketë qëllim tjetër përveç shitblerjes, prandaj thënia se kjo marrëdhënie e ndërsjellë ka ndodhur, edhe kur mungon qëllimi, do të thotë se gjëja për të cilën nuk ka qëllim, kurrë nuk ndodh, prandaj për atë që ndodh pa qëllim, për atë nuk ka as detyrim.

Kjo ishin një përmbledhje e shkurtër e thënieve të fukahave në lidhje me këtë çështje. Në të vërtetë, kjo marrëdhënie e ndërsjellë është reale dhe e detyrueshme, kur është realizuar prej atyre që kanë aftësi dhe dy mallrat pranojnë marrjen në pronësi dhe marrjen me forcë, dhe janë të njohura prej të dyja palëve. Për sa i përket emërtimit se ato janë mjet dhe jo qëllim, atëherë, kush të dëshirojë, le ta emërtojë këtë veprim shitblerje, ose pajtim, ose shkëmbim, apo me ndonjë fjalë të ngjashme si këto, derisa në këtë veprim të ndërsjellë nuk bëhet hallall harami dhe nuk bëhet haram hallalli.

Dhënia e dyanshme jo në shitblerje

Kemi detyrë të mos harrojmë se shkaku detyrues për vlefshmërinë e dhënies së dyanshme në shitblerje, nuk është vetë dhënia e dyanshme dhe me ato që ajo përmban, por është vërtetimi i emrit e i titullit "shitblerje" në dhënien e dyanshme, tërësia e argumenteve që vërtetojnë atë, puna e njerëzve të mençur

me dhënien e dyanshme, si dhe vijimësia me këtë lloj marrëdhënie të ndërsjellë. Atëherë mund të thuhet se çdo dhënie e dyanshme, për të cilën vërtetohet emri i një kontrate prej kontratave, si lejimi e dhurimi, ose vërtetohet emri i një detyrimi prej detyrimeve, të gjitha këto janë të vlefshme dhe janë elemente në kontratë ose në detyrim, për të cilat vërtetohet emri kontratë dhe detyrim, kur te ato përfshihen argumentet përkatëse, derisa nuk është vërtetuar e kundërta. Pra, është plotësisht ashtu siç është edhe për shitblerjen. Nëse nuk vërtetohet emri kontratë ose detyrim, atëherë dhënia e dyanshme është e gabuar, sepse ne dyshojmë për realitetin e për vlefshmërinë e saj, si dhe për faktin që, në këtë rast, si bazë është mosrenditja e efekteve. Ky është rregulli i parimit të përgjithshëm me të cilin fukahatë veprojnë, ose shumica e fukahave në lidhje me vlefshmërinë e dhënies së dyanshme, por jo në shitblerje. Ne kemi edhe një rrugë tjetër për të cilin do të flitet më poshtë.

Mbi bazën e këtij rregulli, fukahatë kanë thënë se dhënia e dyanshme bëhet për qiranë, për dhuratën, për kredinë e konsumueshme, për depozitat, për marrëveshjen për shfrytëzimin e tokës dhe për marrëveshjen për drufrutorët. Të gjitha këto për shkak të vërtetimit të emrit qira për "dhënien e dyanshme" "qiradhënie-qiramarrje", për kredinë e marrëdhënieve të dyanshme, ose për dhurimin, si dhënie të dyanshme për vetë dhuratën, etj.

Të gjitha këto i përfshijnë argumentet e këtyre titujve, ashtu siç kanë vepruar vazhdimisht njerëzit me aftësi mendore që në kohët e hershme. Për sa i përket martesës, nuk mund të kemi dhënie të dyanshme, pasi në bazë, për dhënien e dyanshme, nuk vërtetohet emri martesë, ose për shkak se nuk ka asnjë efekt të këtij vërtetimi në pohimin e ekzistencës së martesës. Të gjitha këto

janë vërtetuar me fjalën e përbashkët të fukahave të mbështetur në Librin e Allahut të Lartësuar dhe në Sunetin e Profetit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), madje ky rregull është prej domosdoshmërive të fesë. E ngjashme me këtë çështje është edhe testamenti, marrja në pronësi e pasurisë pas vdekjes së trashëgimlënësit, divorci *(talàk)*, kur burri i thotë gruas: "Të kam si nënë *(dhihàr)*", vetëmallkimi, kur burri akuzon gruan pa dëshmitarë *(liàn)*, betimi, lirimi i robit, garancia dhe kujdestaria. Të gjitha këto veprime sistemohen me fjalë dhe me formulë të shqiptuar, sepse pa shqiptimin me fjalë, këto veprime nuk mund të realizohen dhe është plotësisht ashtu si martesa, që patjetër duhet të pohohet me fjalë të shqiptuara sipas formulës.

Për sa i përket pronës vakëf, lejohet dhënia e dyanshme e vakëfit, kur është për interesin e përgjithshëm, si për shembull, për ndërtim xhamie, varreza dhe spitale. Por është e pavlefshme, kur është për interesa private, si për shembull, të lihen vakëf pasardhësit e të tjera veprime të ngjashme. Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me penglënien. Disa fukaha e kanë vënë kusht shqiptimin e formulës, disa të tjerë janë mjaftuar vetëm me cilësimin e penglënies si dhënie e dyanshme.

Me lejen e Allahut, në kapitullin "Sendet e lëna peng", do të flasim edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me sendet e lëna peng.

Siç shihet, ky shpjegim i hollësishëm është mbështetur vetëm mbi parimin e kontratave që mund të emërtohen kontrata, kurse, bazuar në parimin tonë, ne mbështesim parimin se të gjitha marrëdhëniet e ndërsjella që kanë ndodhur e që do të ndodhin, janë të lejueshme, derisa ato nuk bëjnë hallall haramin dhe nuk

bëjnë haram hallallin. Bazuar mbi këtë parim, dhënia e dyanshme është e lejuar në të gjitha gjërat, edhe nëse për ato nuk vërtetohet emri kontratë ose detyrim sipas besës së dhënë dhe sipas praktikës së zakonshme, me kusht që të realizohet mirëkuptimi e konsensusi për këtë dhënie të dyanshme, që të dyja palët të kenë aftësi për të vepruar dhe të dy mallrat të jenë konkretë.

Gjithashtu, kjo marrëdhënie e ndërsjellë nuk është në kundërshtim me asnjë nga parimet e ligjit të nderuar të fesë.

* * *

KUSHTET E KONTRATËS

Më sipër kemi thënë se shitblerja është "shkëmbim malli me mall". Ky shkëmbim patjetër duhet të shprehet me fjalë ose me një veprim, që të tregojë për këtë shkëmbim. Kjo shprehje është kontrata, e cila lidhet mes dy palëve dhe është vepruese në mënyrë të ndërsjellë. Dy palët që lidhin kontratën, janë kontraktuesit në vendin ku ndodh shkëmbimi i ndërsjellë. Gjithashtu, të dyja palët, ndaj njëra-tjetrës, janë kompensuese në kontratën e lidhur. Ne do të flasim për njërën nga këto tre tituj në një kapitull të veçantë, ashtu siç ka vepruar edhe shejkhu El Ensarij në librin "El Mekàsib", si dhe fukahatë e tjerë.

Dy kolonat e kontratës

Kontrata ka dy elemente bazë, që janë oferta dhe pranimi. Të dy këto elemente bazë kanë disa forma që duhet të përmbushen:

1- Secili nga të dy elementet bazë të jetë veprim.

2- Secili nga të dy elementet bazë të jetë fjalë.

3- Njëri prej elementeve bazë të jetë fjalë dhe elementi tjetër bazë të jetë veprim, për shembull: Zejdi i thotë Amrit: "Këtë ta shita për dhjetë." Amri paguan dhjetë, ndërkaq shitësi merr shumën pa shqiptuar asnjë fjalë. Padyshim që ky veprim është në pozitën e fjalës që duhet të tregonte: "Pranova." Madje marrja e shumës tregon më mirë e më e qartë se sa fjala që do të vërtetonte shitblerjen e kryer.

4- Dy elementet bazë të kontratës mund të jenë të shkruar, ose shfaqen me shenjë që tregon veprimin.

Për formën e parë, është folur në kapitullin e mësipërm me titull "Dhënia e dyanshme". Për sa i përket rastit kur dy kontaktuesit duan të ndërtojnë marrëdhënien e tyre, duke e shprehur me fjalë, pra, ofertën dhe pranimin dhe jo me dhënie-marrje, a është e detyrueshme për ata të dy që të ndërtojnë këtë marrëdhënie të ndërsjellë me fjalë të veçanta, apo për të dy lejohet ta ndërtojnë kontratën me çdo fjalë e frazë që shpreh mirëkuptimin mes tyre dhe me të cilat njerëzit e kanë bërë zakon të ndërtojnë kontratat mes tyre?

E para i atribuohet thënies më të përhapur mbi të cilën fukahatë kanë bërë studime të shumta, që zënë faqe të panumërta me vërtetime e me hollësi, të cilat, si përfundim janë: Nëse kontrata plotësohet apo nuk plotësohet, kur lidhja e saj shqiptohet me alegori e me epitete. Gjithashtu, a lidhet kontrata e shqiptuar vetëm me një fjali foljore, ose vetëm me një fjali emërore? Gjithnjë, bazuar mbi thënien e parë, rezulton: Është detyrë që folja e shqiptuar të jetë në kohën e shkuar? Gjithashtu, a është detyrë që propozim-oferta të thuhet para pranimit, ose të ketë mbështetje të ndërsjellë mes ofertës dhe pranimit, si dhe hollësi të tjera? Këtu

nuk ka përse të zgjatemi më shumë me të tilla hollësi. Për këtë çështje është shprehur edhe Sej'jid Kàdhim El Jezdij. Sido që të jetë, në lidhje me këtë çështje, ne do të paraqesim këtu fjalët më të përzgjedhura të fukahave, duke mënjanuar me aq sa është e mundur fjalët e tepërta dhe shtesat e bëra mbi këto çështje.

E vërteta dhe metafora

Shejkhu El Ensarij thënien për lidhjen e kontratës me metafora dhe epitete, e adreson në fjalët e shumë dijetarëve të fesë. Prej fjalëve të tyre ai ka citur ato thënie që tregojnë për lejimin e shitblerjes me fjalën "E zotërova.", "E kompensova.", "E dorëzova te ti.", "E kalova në pronësinë tënde." dhe të tjera fjalë të ngjashme. Pastaj ai thotë fjalën e vet: "Me gjithë këto fjalë, si mund të lejohet t'i atashohet dijetarëve të fesë, ose shumicës së tyre, detyrimi i ndodhjes së kontratës me një fjalë të vënë për lidhjen e kontratës dhe nuk lejohet që ajo fjalë të jetë metaforë?"

Në komentim të kësaj çështjeje, Sej'jid El Jezdij ka thënë: "A është detyrë që fjala e përmendur në formulën e lidhjes së kontratës të jetë thënë e atillë që tregon kuptimin e vërtetë dhe të mos jetë thënë me metaforë? Vërtetimi rezulton se është e mjaftueshme që formula e lidhjes së kontratës të shprehet me çdo fjalë që është e zakonshme dhe me të cilën vërtetohet kontrata e marrëveshja, për çështje të përgjithshme e për çështje të veçanta."

Me fjalën "të përgjithshme" ai ka qëllim fjalët e Allahut të Lartësuar: "**...mbani besën për kontratat...", "...kryejeni marrëveshjen, sepse marrëveshja ka përgjegjësi."**

Me çështje "të veçanta" ai ka qëllim fjalën e Allahut të Lartësuar: **"Allahu ka bërë hallall** (ka lejuar) **shitblerjen…"**, si dhe hadithin: "Shitblerja është me preferencë."

Është pyetur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për një burrë që ble një send dhe më pas i del që duhet ta kthejë. A i lejohet atij ky veprim?

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: *"Jo, veç kur pronari i mallit do që t'i bëjë mirë atij."*

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka lënë mënjanë hollësitë në lidhje me rrugët e shitblerjes e të fjalëve që thuhen për shitblerjen, në këto tekste dhe në tekste të tjera që tregojnë përgjithësim e gjithëpërfshirje në fjalë e në përdorim, qoftë kur fjala është në kuptimin e saj real, qoftë kur ajo është metaforë. Në mënyrë të përmbledhur, ai shprehet se fjala mban kuptimin e jashtëm, të dukshëm, pavarësisht nga shkaku i daljes së saj në shesh.

Gjuha arabe

A lidhet kontrata e shqiptuar vetëm në gjuhën arabe, apo ajo lidhet e shqiptuar në gjuhën arabe dhe në gjuhë të tjera?

Shejkhu El Ensarij, në librin "El Mekàsib", thotë: "Fjala më e fuqishme është vlefshmëria e kontratës, e shqiptuar edhe në gjuhët të tjera, përveç arabishtes."

Sej'jid El Jezdij dhe shejkhu En'nàijnij kanë thënë: "Çdo fjalë që tregon titullin kontratë, kontrata është e vlefshme të

ndërtohet me atë fjalë. Kjo është e barabartë, qoftë kur fjala shqiptohet në gjuhën arabe, qoftë në gjuhë të popujve jo arabë, qoftë kur është shprehur në prozë, qoftë kur shprehet me vargje. Sikur kontratat të lidheshin vetëm në gjuhën arabe, patjetër që do të dilnin pengesa e vështirësi dhe do të mbyllej porta e sigurimit të mjeteve të jetesës, pra, do të ishte sikur t'i kërkohej myslimanit joarab të mësonte formulat e kontratave në gjuhën arabe, ashtu siç i kërkohet atij të mësojë suren "Fatiha" dhe sure të tjera të Kur'anit, të domosdoshme për faljen e namazit. Dihet se një kërkesë e tillë nuk ka ardhur në asnjë hadith apo njoftim.

Shprehja në kohën e shkuar

Shumica e fukahave kanë thënë se është detyrë që fjalët e lidhjes së kontratës të shprehen në kohën e shkuar, si për shembull: "E shita" dhe "E pranova". Nuk është e mjaftueshme të thuhet: "E shes dhe e pranoj", sepse folja e kohës së tashme përmban kohën e tashme dhe kohën e ardhme. Veç kësaj, në kohën e tashme puna është e ngjashme me kërkesën për bisedime e me pazarin, megjithëse dihet që të gjitha këto janë në kundërshtim me vendosmërinë, e cila, në lidhjen e kontratës, është kërkesë e domosdoshme, në një kohë që formula për lidhjen e kontratës, e shprehur me folje në kohën e shkuar, është e veçantë vetëm për kohën e tashme. Prandaj koha e shkuar është më e qartë për të vërtetuar aktin dhe për këtë arsye specifikimi i formulës në kohën e shkuar është i detyrueshëm.

Fukaha të tjerë kanë thënë se formula është mjet për të shprehur vullnetin dhe miratimin dhe nuk është qëllim në

vetvete, prandaj gjithçka që tregon ndërtimin e vetë kontratës, ose kur ajo bëhet me ndihmën e një shprehjeje të përafërt, me të cilën plotësohet kontrata, ajo kontratë është e lidhur. Kjo është e barabartë, qoftë kur formula shqiptohet me fjali emërore, qoftë kur ajo shqiptohet me fjali foljore në kohën e shkuar ose në kohën e tashme.

Shejkhu El Ensarij, duke komentuar këtë thënie, është shprehur: "Nuk është pa fuqi, edhe sikur fjala të jetë thënë qartë në kohën e tashme gjatë ndërtimit të kontratës në atë mënyrë që nuk ka nevojë për një fjalë të ngjashme që të zërë vendin e saj."[1]

Në vijim, shejkhu i nderuar thotë: "Dije se për vlefshmërinë e paraqitjes së pranimit me fjalë urdhërore, si për shembull: "Më shit mua", ka kundërshtime të shumta në mesin e fukahave."

Në të vërtetë, edhe kjo formë paraqitje është e vlefshme, kur me atë fjalë është qëllim ndërtimi i kontratës, përveç kërkesës e pretendimit. Transmetohet prej Sehl Sàidij se një grua erdhi te i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe i tha: "*Veten time e bëj dhuratë për ty.*" Ajo qëndroi gjatë në këmbë. Ngrihet një burrë dhe thotë: "*O i Dërguari*

[1] Fjala e përafërt ndahet në shprehje foljore, siç është fjala jote: "Pashë hënën e plotë të ecë." Kuptohet që kjo fjalë tregon se ti ke pasur qëllim një femër të bukur. Gjithashtu, ndahet edhe në fjalë të përafërt, që shpreh gjendjen, siç është fjala e më të ulëtit për më të lartin: "Më jep mua." Gjendja e më të ulëtit tregon se ai ka pasur qëllim që me urdhrin "Më jep!", të thotë: "Më jep mua shpresë, por jo detyrim."
Edhe shejkhu El Ensarij, me këtë fjalë të tij, ka pasur qëllim që shprehja e mirëkuptimit të ndërsjellë është e detyrueshme të shprehet me fjalë, por jo që të shprehë gjendjen.

i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ty e mbi familjen e tënde!), nëse nuk ke nevojë për këtë grua, më marto mua me të."

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* foli: *"A ke ndonjë send që mund t'ia japësh asaj, si shumë kurore nga ana jote?"*

Burri tha: *"Nuk kam asgjë tjetër përveç rrobës së poshtme që kam në trup."*

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha atij burrit: *"Nëse do t'i japësh rrobën e poshtme të trupit, do të mbetesh pa atë rrobë, por shiko se mos ke ndonjë unazë prej hekuri."*

Burri foli: *"Nuk kam asnjë send."*

Përsëri i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"A di ndonjë pjesë prej Kur'anit?"*

Buri tha: *"Po."*

Atëherë i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Të martova me këtë grua me atë pjesë Kur'ani, që ti di më mirë, me kusht që t'ia mësosh edhe kësaj."*

Meqenëse edhe kontrata e martesës u plotësua me mënyrën urdhërore, siç qe fjala e atij burrit: "Më marto mua me këtë!", atëherë kontratat e tjera kanë përparësi të lidhen me kontekstin e fjalës së shprehur në mënyrën urdhërore.

Më parë propozim-oferta

Fukahatë më në zë janë shprehur se propozim-oferta, në mënyrë absolute, është detyrë të shprehet para pranimit. Disa të tjerë kanë thënë se lejohet edhe vonimi i shprehjes së propozim-ofertës, por më parë le të bëhet pranimi, sepse, në të vërtetë, ai është ndërtimi i marrëveshjes së ndërsjellë me anë të propozimit. Nëse kjo vërtetohet, atëherë kontrata është e vlefshme, qoftë kur propozim-oferta bëhet më parë ose më vonë.

Shejkhu El Ensarij bën një ndarje mes pavlefshmërisë së kontratës, kur pranimi ndodh me fjalën "Pranova" dhe "Jam i kënaqur", ose me fjalë të ngjashme me këto, si dhe mes vlefshmërisë, kur pranimi ndodh me fjalën: "E bleva dhe e shita", ose me fjalë të tjera të ngjashme, sepse, në këtë rast, fjala tregon ndërtimin e shkëmbimit, si dhe marrëveshjen për të marrë në zotërim çmimin kundrejt mallit.

Atëherë çështja më e rëndësishme është vendi i marrëveshjes, sepse shkaku i parë është dalja e fjalës dhe jo thjesht thënia më e parë e propozim-ofertës. Për sa u përket kundërshtimeve që kanë fukahatë mes tyre, ato janë për çështje të vogla, që do të thotë se ato kanë të bëjnë me zbatimin e dijes dhe miratimin e individit. Bazuar mbi këtë, çdo veprim për të cilin vërtetohet fjala kontratë, është e vlefshme. Gjithashtu, lejimi, që më parë të shprehet propozim-oferta, tregohet qartë në transmetimin e mësipërm, i përcjellë prej Sehlit, në lidhje me martesën e gruas, duke ditur se kujdesi në shprehjet në kontratën e martesës ka përparësi ndaj të gjitha kontratave.

Ti mund të thuash: Në të vërtetë, fukahatë e kanë lejuar që në martesë, më parë të shprehet pranimi, sipas një hadithi të veçantë, prandaj është detyrë që në martesë, fjalët të jenë sa më të përmbledhura, kurse aneksimi i kontratave të shitblerjes dhe të tjera kontrata me martesën, bëhet për analogji.

Përgjigje

Ne e dimë mirë se vënia më parë e vlefshmërisë në kontratën e martesës nuk është se ka ndonjë karakteristikë të veçantë, sepse vetë pranimi, kur vihet para propozimit, shpreh miratim dhe është plotësisht sikur të ishte thënë edhe më vonë, sepse kryesorja qëndron në shprehje e në qartësi dhe jo në thënien e propozimit më parë ose më pas. Me një mënyrë të dytë, themi se martesa është element dhe burim, sipas rregullit të përgjithshëm, të cilin ne e kemi nxjerrë me anë të traditës, duke shtuar këtu se shumë nga rregullat e përgjithshme nxirren prej disa burimeve dhe prej disa elementeve të tyre. Prandaj ne këtu vetëm do të përsërisim atë që kanë thënë fukahatë: "Bazë në këtë rregull është ky burim.", derisa në mesin e fukahave të jetë mjaft i përhapur se veçantia e burimit nuk e bën detyrim specifikimin e të ardhurës.

Shembulli më i qartë për këtë është fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Laje rrobën tënde për shkak të urinës që ka rënë në të prej kafshëve që nuk u hahet mishi."* Prej këtij transmetimi, fukahatë kanë përgjithësuar larjen, kur urina ka prekur rrobat, enët, trupin, etj. Gjithashtu, rregull është edhe thënia: *"Kush prish (shkatërron) pasurinë e tjetrit, prishësi (shkatërruesi) për atë pasuri është garantues."*

Ky rregull është nxjerrë prej fjalës së Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ai që i sjell dëm rrugës së myslimanëve, për atë dëm ai është garantues."*

Veprimet njëri pas tjetrit

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët, me dëshminë e Sej'jid El Jezdij se në kontratat e lejuara, si kontratat e shkëmbimit, të depozitimit dhe të prokurimit, nuk është kusht thënia e propozim-ofertës sipas radhës dhe se ndarësi kohor i gjatë mes këtyre dy shprehjeve nuk është pengesë që kontrata të jetë e vlefshme. Por fukahatë kanë mendime të ndryshme në lidhje me kontratat detyruese, siç janë kontratat e shitblerjes dhe të efekteve që lidhen me këto kontrata. Disa fukaha janë shprehur se kryerja e veprimeve të kontratës njëra pas tjetrës është kusht, kurse disa të tjerë kanë thënë se kjo nuk është kusht, por patjetër në kohën e pranimit duhet të vazhdojë të jetë propozimi, sepse vijimësia e propozim-pranimit, do të thotë që propozuesi nuk kthen para pranimit. Për sa i përket ekzistencës ose mosekzistencës së ndarësit kohor mes propozimit dhe pranimit, kjo është e barabartë.

Sej'jid El Hakijm, në librin "Nehxhul Fukàheh", në faqen 105, botim i vitit 1371H, ka thënë: "Është e qartë se mjafton vërtetimi shpirtëror i marrëveshjes në shpirtin e propozuesit, domethënë, konsensusi dhe vullneti i tij janë deri në kohën e pranimit. Madje kjo është e mjaftueshme edhe sipas traditës, qoftë edhe me një ndarës kohor të gjatë, për shembull: Propozuesi thotë: "Të shita kalin për një dirhem." Blerësi nuk pranon. Pastaj shitësi

e këshillon blerësin, duke i bërë të qartë dobitë dhe këmbëngul në këtë shpjegim, derisa blerësi pranon, edhe kur ndarësi kohor është thënë me një fjalë jo arabe.

Gjithashtu, edhe kur blerësi nuk ka shprehur pranimin, derisa propozuesi heq dorë prej propozimit dhe, nëse pas heqjes dorë propozuesi pranon, kontrata nuk mund të realizohet. Pikërisht këtu qëndron edhe sekreti i mosvërtetimit të kontratës, kur ndarësi kohor është i tejzgjatur, si për shembull, një vit, ose edhe më shumë."

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se qëndrueshmëria e kuvendit ose shpërndarja e tij, në fik'hun xhaferij nuk ka as efektin më të vogël, në raport me propozim-ofertën dhe pranimin. Në të vërtetë, efekti i kontratës bëhet në analogji me përzgjedhjen e dy kontraktuesve, pasi plotësohet propozim-oferta dhe pranimi dhe pasi lidhet kontrata. Thënë ndryshe, merret në konsideratë bashkimi i dy gjysmave të kontratës, në atë mënyrë që nuk mund të ekzistojë njëra prej dy gjysmave pa ekzistencën e gjysmës tjetër.

Gjithsesi, kjo nuk ka lidhje me bashkimin e kuvendit, kur ai mundëson mirëkuptimin e bashkëbisedimin dhe mosvonesën mes propozimit e pranimit, krahas disa kuvendeve. Gjithashtu, kontrata mundësohet edhe me bashkimin e kuvendeve.

Varësia

Padyshim që ndërtimi i kontratës realizohet me kryerjen e veprimeve dhe me varësi, pasi çdo njeri mund të shqiptojë fjalët e kontratës, me kushtëzim ose pa kushtëzim, për shembull, ai të

thotë: "Këtë mall ta shes ty, ose ta shes, nëse Zejdi jep miratimin." Në këto dy shprehje nuk ka asnjë kundërsens, por fukahatë kanë mendime të ndryshme për faktin e lidhjes së kontratës me të njëjtin kuptim: A është e vlefshme që ajo të jetë e varur nga ekzistenca e një tjetri, në atë mënyrë që realizimi i asaj të jetë i mundshëm dhe kur nuk është i qartë në të gjitha gjendjet, por është e bazuar mbi një vlerësim dhe nuk është e bazuar mbi një vlerësim tjetër?

Thënë ndryshe, kontrata ka një ekzistencë ndjesore, që është shprehja e saj nga ana e folësit, por ka edhe një ekzistencë nominale e morale, që konsiston në faktin se ligjvënësi ka marrë në konsideratë renditjen e efekteve që vijnë prej saj. Me fjalën e përbashkët të fukahave, kontrata bëhet ekzistuese me të dyja kuptimet dhe ajo është e varur vetëm në njërin kuptim, kurse varësia e kontratës prej kuptimit të dytë, le vend për mosmarrëveshje e për mendime të kundërta.

Fukahatë më në zë janë shprehur se varësia e kontratës është veprim i gabuar, pasi të dy kontraktuesit janë të kushtëzuar, që kur ata, me ndërgjegje, rendisin efektin e kontratës në varësinë, pasi varësia, në fakt, mohon vendosmërinë dhe veprimin e ndërgjegjshëm.

Një grup fakahash janë shprehur se edhe kontrata e varur, në mënyrë absolute, është e saktë dhe është e barabartë, qoftë kur kushti i varësisë është i njohur që ndodh në kontratë, si për shembull, kur unë them: "Këtë ta shita ty.", nëse ai është malli im; qoftë edhe kur kushti është i njohur se do të ndodhë në të ardhmen, si për shembull, kur unë them: "Këtë do të ta shes ty në fillim të muajit të ardhshëm.";

ose edhe kur është dyshim që kushti të ndodhë, si për shembull, kur unë them: "Këtë ta shes ty, kur të kthehet Zejdi prej udhëtimit."

Në këtë përfundim kanë arritur Sej'jid El Jezdij, shejkhu En Nàijnij dhe Sej'jid El Hakijm.

I pari, në margjinaturën e librit "El Mekasib" të El Ensarij, ka thënë: "Vendosmëria nuk është vendimtare në renditjen e efekteve të bazuara mbi kontratën, kur ajo ndërtohet, ndryshe shitblerja me varësi prishet, kur shitësi ose blerësi nuk janë në dijeni për plotësimin e të gjitha kushteve ligjore."

Më poshtë ai thotë: "Bazuar mbi supozimin e ekzistencës së fjalës së përbashkët të fukahave për mosvlefshmërinë e varësisë, ky supozim nuk përbën argument për këtë çështje, domethënë fjala e përbashkët e fukahave të bazohet mbi vendosmërinë dhe merret në konsideratë, kur ne dimë se ky është edhe mendimi i Imamit të ruajtur prej gabimeve, pasi pa këtë dije, nuk ka më as argument e as që mund të merret në konsideratë; krahas faktit që ne dimë se, së paku, të dy grupimet kanë pasur vizionin që ekzistenca e vendosmërisë është detyrim, por ky vizion, ashtu siç e shpjeguam, nuk ka mbështetje në asnjë bazë.

Shejkhu En Nàijnij në librin "Et Takrijràtul Khauànesàrij", ka thënë: "Vlefshmëria e varësisë në ndërtimin e kontratës nuk është e panjohur për asnjë njeri, madje ndodhja e varësisë, në dispozitat ligjore, as që mund të numërohet, pasi shumica e dispozitave ligjore, madje të gjitha këto dispozita, me përjashtim të dispozitave që devijojnë problemet e vërteta,[1] si dhe dispozitat e kushtëzuara në vlerësimin e ekzistencës së subjekteve që ato

trajtojnë. Gjithashtu, varësia ndodh në tërësi te kontratat e te detyrimet, siç janë: testamenti, sistemim-menaxhimi, e taksura, marrëveshja dhe betimi, në të cilat nuk ka as probleme e as ekuivoke."

Sej'jid El Hakijm, në librin "Nehxhul Fukàheh", ka thënë: "S'ka argument që të merret në konsideratë vendosmëria, në asnjë kuptim të obligimit, sepse konsensusi për një gjë, nuk qëndron në mundësinë e arritjes së asaj gjëje, nëse do të ndodhë vendosmëria apo jo, prandaj, ashtu siç është i varur ndërtimi i kontratës me konsensus, ashtu është edhe ndërtimi i saj me varësi."

Kjo çështje, në mënyrë apriori, nuk pranon debat, pasi të gjithë ne duam që të ndodhin gjërat që nuk janë, megjithëse e dimë mirë që ato nuk mund të ndodhin. Kur në lidhjen e kontratës mungon vendosmëria, atëherë efektet sistemohen si kusht për lidhjen e kontratës dhe kjo kontratë është e lejuar, kur ajo lidhet e varur, duke supozuar mundësinë e renditjes së efekteve të saj në të ardhmen.

Harmonizimi mes propozimit e pranimit

Kontrata nuk lidhet nëse propozim-oferta dhe pranimi nuk vijnë njëri pas tjetrit për të njëjtin send, sepse kundërshtia e pranimit dhe ndryshueshmëria e tij prej propozimit, konsiderohet refuzim nga ana e detyrimit. Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Nëse propozimi e pranimi janë në kontradiktë me përmbajtjen, domethënë, kur shitësi e ofron mallin në një formë dhe blerësi e pranon atë në një formë tjetër, kontrata nuk lidhet, sepse konsensusi është i detyrueshëm të jetë me të njëjtin detyrim.

Shembull për mungesë harmonizimi kemi rastin kur shitësi thotë: "Këtë mall ta shita ty për njëqind." dhe blerësi thotë: "E bleva për dhjetë.", ose blerësi thotë: "E bleva gjysmën e mallit me pesëdhjetë.", ose me të tjera fraza si këto."

Humbja e kompetencës para plotësimit të kontratës

Ashtu siç merret në konsideratë propozimi në kohën e pranimit dhe harmonizimi mes propozimit e pranimit për një send të vetëm, gjithashtu, është kusht që secili prej dy kontraktuesve të vazhdojë të ketë aftësinë dhe kompetencën, derisa të plotësohet lidhja e kontratës. Kur njëri prej dy kontraktuesve e humb kompetencën e aftësinë para propozimit, ajo kontratë nuk lidhet.

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Prej tërësisë së kushteve në kontratë është që propozimi për kontratën dhe pranimi i saj të ndodhë në të njëjtën gjendje, në të cilën çdo njërit prej dy kontaktuesve i lejohet të ndërtojnë kontratën. Sikur blerësi, në kohën e propozimit prej shitësit, të mos ketë aftësi e kompetencë për të pranuar, ose shitësi, në kohën e pranimit, ka dalë prej kompetencës e aftësisë për të propozuar, kontrata nuk lidhet."

Sej'jid Kadhim El Jezdij bën një ndarje mes humbjes së aftësisë nga ana e pranuesit në kohën e lidhjes së kontratës, sipas formës së parë dhe lidhjes së saj, sipas formës së dytë dhe shprehet: "Kur Zejdi i thotë Amrit: 'Këtë ta shita ty."; kur Amri, në kohën e propozim-ofertës, është në gjumë, por, kur pas zgjimit atij ia bëjnë të ditur propozimin, ai thotë: "Pranova.", kjo kontratë nuk është e vlefshme."

E kundërta ndodh kur Zejdi fle, pasi e ka bërë ofertën për shitjen dhe Amri e ka pranuar. Pra, Zejdi fle pas pranimit, kontrata lidhet dhe është e vlefshme.

Dobitë

Në brendësinë e fjalëve të shejkhut El Ensarij kanë ardhur disa dobi, kur ai flet për vazhdimësinë e aftësisë dhe të kompetencës për të lidhur kontratë prej secilit, prej propozuesit e pranuesit, derisa të lidhet kontrata.

Prej këtyre dobive, kemi: Kur dikush i le testament një personi tjetër dhe testamentlënësi vdes, para se të pranojë i porosituri, testamenti është plotësuar, sepse testamenti nuk është prej kontratave, në të cilat pranimi është kusht i domosdoshëm, por është vetëm kusht për ekzekutimin e testamentit dhe jo për vlefshmërinë e tij.

Shejkhu Muham'med Husejn El Esfehànij, në margjinaturat *(hàshijeh)* e librit "El Mekasib", ka thënë: "Testamenti nuk është as kontratë e as detyrim, por është një ndarës mes kontratës e testamentit."

Prej dobive është: Kur propozimi del prej propozuesit, pala e dytë që është personi të cilit i lihet obligimi, ka të drejtë të pranojë, ose të refuzojë propozimin. Kur kontrata plotësohet, asnjëri nuk ka të drejtë ta prishë këtë kontratë, ose të heqë dorë prej kontratës, përveçse me konsensusin e tjetrit.

Gjithashtu, prej dobive, kemi: Kur një person e ndërton propozimin me imponim dhe tjetri pranon, në mënyrë apriori, kjo kontratë nuk lidhet.

Kur propozuesi i imponuar, pranon me kënaqësi pas imponimit, me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo kontratë është e vlefshme.

Me lejen e Allahut, hollësitë në lidhje me këtë çështje, do të jepen kur të flitet për kushtet e dy kontaktuesve.

Bërja me shenjë dhe e shkruara

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se forma e kontratës nuk lejohet të ndërtohet me shenjë ose me të shkruar, me përjashtim të rastit kur shqiptimi me fjalë është i pamundur. Këtë çështje e ka kundërshtuar shejkhu En'neràkij, i cili, në librin "El-Mustened", ka thënë: "Është e mjaftueshme bërja me shenjë kuptimdhënëse. Gjithashtu, edhe shkresa është e mjaftueshme dhe është e barabartë, edhe kur shqiptimi me fjalë është i mundur, ose i pamundur."

Siç shihet, kjo thënie është në kundërshtim me shprehjen e fukahave më në zë.

Por ajo për të cilën nuk ka asnjë dyshim, është fakti se tradita e pranon lidhjen e kontratës me shenjë dhe me shkrim. Ne kemi parë njerëzit, ndër të cilët edhe fukaha, që të sistemojnë pa asnjë dallim ndikimet e kontratës së lidhur me shenjë ose me shkrim, ashtu siç i sistemojnë ato për kontratën e lidhur me formulën e shprehur me fjalë.

Në këndvështrimin e traditës, kur kontrata lidhet me shenjë ose me shkrim, kjo kontratë përfshihet në fjalën e Allahut të Lartësuar: " أَوْفُوا بِالْعُقُودِ" **- "...mbani besën për kontratat..."** *(Sure "El Maide", ajeti 1)*, si dhe detyrimet e tjera të përgjithshme që përfshihen në këtë ajet.

Përmbledhje

Si përmbledhje rezulton se ligjvënësi ka sjellë tekst për dispozitat e shitblerjes, të konfirmimeve, të dhuratave, etj, por nuk ka sjellë tekst për caktimin e kuptimeve të tyre. Prandaj, që të njihemi me kuptimet e këtyre shprehjeve në kontratë, bëhet e detyrueshme t'i referohemi traditës së përgjithshme, pasi për çdo kontratë për të cilën vërtetohet një emër prej këtyre emrave për të cilat ligjvënësi ka sjellë tekst për dispozitat e tyre, është e detyrueshme që mbi këtë tekst të sistemohen edhe efektet, derisa të vërtetohet e kundërta, pa asnjë dallim, nëse kontrata është lidhur me punë, ose me fjalë, ose me shenjë, ose me shkrim.

Nuk ka asnjë dallim mes shprehjes së formulës së kontratës në gjuhën arabe ose në një gjuhë tjetër, ose kur formula shprehet me fjali emërore ose me fjali foljore, as kur pranimi është i vonuar, ose i përshpejtuar. Gjithashtu, nuk ka dallim as mes vijueshmërisë së thënies së formulës së kontratës e as kur ajo nuk thuhet në vijueshmëri, por patjetër kërkohet që propozimi e pranimi të jenë për të njëjtin send.

Gjithashtu, është e detyrueshme që pranuesi të ketë aftësi të plotë për të vepruar, kur propozuesi parashtron propozimin, por nuk është e detyrueshme e kundërta, domethënë vijueshmëria e

aftësisë për të vepruar deri në kohën e pranimit, pasi mjafton që aftësia për të vepruar të ekzistojë vetëm në kohën e propozimit.

Është prej punëve të mira që këtë kapitull ta mbyllim me atë që është shkruar në librin "El Hadaik", në vëllimin 5, në faqen 66 dhe në faqen 194, botim i vitit 1317H: "Ka fukaha që e kanë bërë detyrim se fjala e propozimit dhe e pranimit të jetë në kohën e shkuar. Të tjerë kanë bërë detyrim qëllimin e ndërtimit të kontratës. Gjithashtu, ka fukaha që kanë bërë të detyrueshme, që më parë të thuhet propozimi dhe pastaj pranimi. Të tjerë kanë bërë të detyrueshme shprehjen e menjëhershme të propozimit e të pranimit, me kusht që shprehja e menjëhershme nuk sjell dëm në frymëmarrje e as nuk shkakton kollë.

Fukaha të tjerë e kanë bërë detyrim që formula e kontratës të shprehet në gjuhën arabe, edhe pse ka vështirësi në shqiptim. Shto këtu edhe të tjera thënie të kësaj kategorie, për të cilat nuk ka argument për asgjë, përveç pretendimeve të tyre që thonë se ligjvënësi ka përcaktuar një mënyrë shprehje specifike.

Ajo që kuptohet prej thënies të Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!) është se çdo fjalë që tregon konsensus, është e mjaftueshme për vlefshmërinë e kontratës.

Mbi këtë përfundim janë bazuar edhe të gjithë vërtetuesit e mëvonshëm, madje edhe të mëvonshmit e fundit. Me këtë përfundim ka vendosur edhe vërtetuesi El Erdebilij, vërtetuesi El Kashanij, El Fadl El Kharasanij, shejkhu Abdull'llàh bin Salih El Bahranij dhe dijetari poliedrik, shejkhu Sulejman.

Për mua, kjo çështje është fare e qartë, sipas njoftimeve të ardhura prej pjesëtarëve të pastër të Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i*

Allahut qoftë mbi ta!). Thënia më në zë, në mesin e fukahave, është se për paragrafin në fjalë, nuk ka argument ligjor, ashtu siç nuk ka edhe për paragrafë të tjerë."

* * *

MARRJA E SENDIT ME KONTRATË TË PRISHUR

Si normë, fukahatë e medh'hebeve, dispozitën e sendit të marrë me kontratë të prishur e kanë trajtuar, pasi kanë shpjeguar formulën e kontratës. Në të vërtetë, është më e pëlqyer që kjo çështje të renditet pas kushteve të dy kontraktuesve dhe objektit të kontratës, sepse prishja e kontratës mund të jetë prej vetë formulës, mund të jetë për shkak të humbjes së aftësisë e të kompetencës së dy kontraktuesve, (njërit prej tyre ose edhe të dyve), ose për shkak të objektit. Ne kemi pëlqyer t'i rendisim kapitujt e këtij libri e studimet që ai përmban, jo vetëm sipas rrugës që kanë ndjekur fukahatë e në veçanti sipas renditjes që këto çështje kanë në librin "El Mekasib" të shejkhut El Ensarij, por edhe për shkak të interesimit të madh të fukahave për të studiuar, për të komentuar dhe për të shpjeguar këtë libër.

Sido që të jetë, në lidhje me dispozitën e sendit të marrë me anë të kontratës së prishur, fukahatë, në një kapitull të veçantë, kanë vënë aksiomën rregull: "Çka merret me kontratë të vlefshme, merret edhe me kontratë të prishur."

Ky kapitull është përpjekur të shpjegojë kuptimin e kësaj aksiome rregull, anën e kundërt të rregullit, argumentin për rregullin dhe dispozitat më të rëndësishme që përfshihen në këtë rregull.

Kuptimi i rregullit

Kontrata është e vlefshme, kur në të janë bashkuar të gjitha kushtet që merren në konsideratë në kontratë, siç janë ardhja njëra pas tjetrës e propozim-pranimit për të njëjtin kuptim, mosha madhore e kontraktuesit, shëndeti i tij mendor dhe aftësia e tij logjike, mundësia e dy sendeve që shkëmbehem për t'u pasur në zotërim dhe për t'u dhënë në zotërim. Kur këto kushte janë të plota, me të gjitha llojet e tyre, atëherë kontrata plotësohet dhe mbi këtë kontratë renditen dispozitat e rezultatet që ka vendosur ligjvënësi për lidhjen e kontratës. Kur dy vetë zotohen me një kontratë të vlefshme dhe shkëmbejnë mes tyre mallin e shitur dhe shumën e dhënë (ose mall me mall), secili prej këtyre të dyve ka të drejtë të veprojë me sendin e marrë në zotërim sipas dëshirës së tij, ashtu siç vepron me të gjitha sendet e veta, pa asnjë përjashtim. Kur sendi i marrë prishet në dorën e tij, dëmi ose pakësimi i sendit rëndon vetëm mbi personin që e mori atë në dorëzim, sepse sendi, si pasuri, ka kaluar në pronësi të tij, ashtu si të gjitha pasuritë e tjera të tij.

Kur ne u njohëm me kontratën e vlefshme, u njohëm edhe me kontratën e prishur, domethënë, kur në atë kontratë nuk mblidhen të gjitha kushtet e kërkuara për kontratën, për pasojë, në

këtë kontratë nuk mund të sistemohet asnjë prej ndikimeve ligjore.[1]

Kur dy kontraktuesit lidhin kontratë, marrin e japin në mënyrë të ndërsjellë me kontratë të prishur, malli i marrë me këtë kontratë mbetet në dorën e pronarit të tij të parë dhe asnjë prej veprimeve të personit të dytë, në mënyrë absolute, nuk mund të zbatohet mbi sendin e marrë, pra, është sikur të mos kishte fare kontratë për sendin në fjalë.

Me fjalë të tjera, kur blerësi e merr në dorëzim mallin e blerë me kontratë të vlefshme dhe më pas ai send prishet në dorën e blerësit, për shkaqe atmosferike, ose për shkaqe të tjera, blerësi është garantues për atë send, domethënë, ai send humbi për llogari të pasurisë së tij dhe ai s'ka asnjë të drejtë ta kthejë kontratën në dëm të shitësit, sepse sendi i blerë që ishte në pronësi të shitësit, me lidhjen e kontratës kaloi në pronësi të blerësit.

E njëjta gjë është edhe për sendin e blerë me kontratë të prishur, kur ai send prishet, sepse edhe në këtë rast, garantues për sendin është përsëri blerësi dhe humbja është mbi pasurinë e blerësit e jo mbi pasurinë e shitësit.

Kjo është e barabartë, qoftë kur sendi i blerë prishet për shkak të blerësit, qoftë kur prishet jo për shkak të tij. Kjo çështje do të shpjegohet me argumentet përkatëse në paragrafin "Argumenti", ku do të shikojmë se malli është në garanci të

[1] Vërtetimi i shumës së kurorës, i përkatësisë fisnore dhe koha e pritjes për gruan, pas divorcit me martesë të prishur, nuk janë prej ndikimeve të kontratës së kësaj martese, por janë prej ndikimeve të realitetit fizik, domethënë janë prej marrëdhënieve intime me dyshim, sepse kurora ligjore përfshin martesën e dyshimtë dhe martesën e vërtetë.

blerësit, pasi në të vërtetë është e pamundur që vetë malli të kthehet për shkak të prishjes, prandaj bëhet e detyrueshme që ai mall të kthehet me një mall të njëjtë, ose me një mall të ngjashëm, të kompensueshëm, ose me çmim, në mënyrë që të mos ketë më vend as për atakim e as për abuzim, plotësisht ashtu siç është për mallin e marrë me detyrim, me përjashtim të rastit kur prishja e sendit vjen për shkak se ai send përbën mëkat, ose për shkak të dënimit. Në këto raste, shitësi është i detyruar t'i kthejë blerësit çmimin nominal, kur malli ekziston, ose i jep një mall tjetër, nëse malli është prishur. Pikërisht ky është kuptimi i frazës "Çka merret me kontratë të vlefshme, merret edhe me kontratë të prishur.".

Ti thua: "Çfarë do të bësh me lejimin e krahasuar për kontratën e prishur?" Ajo nënkupton mosgarantimin nga ana e marrësit, veçse kur mbi sendin është vënë dorë, ose për atë send nuk është treguar kujdes për ta ruajtur.

Në kemi të drejtë të përgjigjemi se në këtë çështje lejimi dhe konsensusi, nga çdo vlerësim, nuk janë arritur, por marrëveshja është ndërtuar vetëm mbi vlefshmërinë e kontratës. Kur baza prishet, atëherë ajo është degë e ngjashme me vetë kontratën.

Shejkhu El Ensarij nuk ka bërë ndonjë dallim për garantimin e detyrueshëm, kur ai që ka mallin në dorën e tij dhe paguesi kanë dijeni për prishjen e kontratës, ose të dy nuk dinë asgjë rreth prishjes së kontratës, ose njëri ka dijeni dhe tjetri nuk ka dijeni për prishjen e kontratës, për faktin se teksti dhe sentencat *(fetvatë)* janë gjithëpërfshirëse. Qëllimi i shejkhut, me fjalën "tekst", është respektimi i pasurisë së myslimanit, ashtu siç do

shikojmë më poshtë, kurse me fjalën "sentencë"– *"fetva"*, ka qëllim fjalën e fukahave për garantimin pa asnjë shkoqitje e kushtëzim.

E kundërta e rregullit

Prej rregullit që ne përmendëm, në lidhje me kuptimin e frazës "Çka merret me kontratë të vlefshme, merret edhe me kontratë të prishur.", bëhet e qartë edhe kuptimi i kundërt, domethënë se "Çka nuk merret me kontratë të vlefshme, nuk merret as me kontratë të prishur.".

Në lidhje me këtë çështje, Sej'jid El Jezdij ka thënë: "Në të vërtetë, prej kuptimit të bazës u mësua edhe kuptimi i kundërt, prandaj nuk është nevoja për përsëritje."

Si përmbledhje, shkurtimisht ne themi se, në të vërtetë, çdo kontratë e vlefshme nuk e bën të detyrueshëm garantimin e sendit të dhuruar nga ana e dhuruesit në asnjë send. Gjithashtu, dhuruesi nuk garanton asgjë për personin të cilit i është bërë dhurata, kur ai e ka marrë atë dhuratë të prishur, sepse, me dhënien e dhuratës, dhuruesi e bëri personin që i bëhet dhurata pronar në pasurinë e tij falas, prandaj në këtë gjendje, ai nuk mban asnjë përgjegjësi për vlerësimin e vlefshmërisë, për rrjedhojë, ai gjithashtu, nuk mban përgjegjësi për vlerësimin e prishjes.

Patjetër që dhurata plotësohet, kur dhuruesi ka aftësi e kompetencë për të vepruar dhe është pronar i sendit që dhurohet, sepse studimi është ndërtuar mbi bashkëpunimin e ndërsjellë mes dy elementeve: njëri prej të dyve është i vlefshëm, kurse tjetri është i prishur. Për sa i përket asaj kontrate, në të cilën ka vetëm

një element të prishur, siç është dhurata e bërë prej atij që s'ka mbushur moshën madhore, ose dhurata e bërë prej atij që nuk e ka në zotërim sendin që dhuron, këto lloje kontratash janë jashtë objektit të studimit, madje është i huaj studimi për garantimin në këto lloje marrëdhëniesh, pasi me fjalën e përbashkët te dijetarëve të fesë, ato janë të garantuara.

Argumenti

Prej rregullit: "Çka merret me kontratë të vlefshme, merret edhe me kontratë të prishur.", fukahatë kanë nxjerrë disa argumente:

Argumenti i parë: Çdo send i shkëmbyeshëm qëndron nën zotërimin e pronarit të parë, pasi supozohet se shkaku i dhënies në pronësi dhe, pronësimi është kontrata, e cila, në këtë rast, është e prishur. I njëjtë me këtë është edhe shkaktari.

Argumenti i dytë: Fjala e përbashkët e dijetarëve të fesë, bazuar mbi dëshminë e autorëve të librave: "Miftahul Kerameh", "El Xheuahir", "Bulgatul Fakijh", etj. I pari ka thënë se me këtë kanë dalë në shesh shprehjet e fukahave. I dyti ka thënë se unë këtë e gjej pa asnjë kontradiktë. Madje fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët në të dyja pjesët e kësaj.

I treti ka thënë se fjala e përbashkët, e bazuar mbi rregullin, është e detajuar.

Argumenti i tretë: Hadithi profetik mjaft i përhapur: "Mbi dorën rëndon gjithçka që ajo merr, derisa ajo ta kryejë." Ky rregull është i përgjithshëm për çdo dorë, për të vërtetuar se ajo, me të

vërtetë, ka marrë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ajo ka marrë sendin konkret, qoftë kur ka marrë dobi prej atij sendi.

Argumenti i katërt: Fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Respektimi i pasurisë së myslimanit është si respektimi i jetës së tij."*; *"Nuk është hallall pasuria e një njeriu, pa qenë ai vetë dakord shpirtërisht."*; *"Nuk shkon kot e drejta e asnjë njeriu."*

Argumenti i pestë: Rregulli: "Kush prish pasurinë e tjetrit, prishësi është garantues për atë çka prishi." Këtë rregull fukahatë e kanë nxjerrë prej fjalës së Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Ai që dëmton rrugën e myslimanëve, vetëm ai është garantues për të."*

Dobitë

Kur për sendin e marrë me kontratë të prishur paska dobi për marrësin e atij sendi, atëherë, sipas fjalës së fukahave më të dëgjuar, marrësi është i detyruar ta garantojë atë send, plotësisht sikur ta merrte vetë sendin, sepse dobia ndjek sendin dhe dobinë e përfshijnë të gjitha argumentet që u thanë më sipër, në lidhje me garantimin e sendit.

Ti mund të thuash se garantimi i dobisë nuk mund të jetë bashkë me garantimin e vetë sendit, ashtu siç thotë hadithi: "Taksa (në tekst haraçi) është me garantim", domethënë se e drejta e taksës, që është dobia, qëndron kundrejt përballimit të humbjes.

Përgjigje

E para: Në të vërtetë, hadithi është i gradës *"Daijf"*
- "Jo i fuqishëm", sepse nuk dihet gjendja e përcjellësit.

E dyta: Hadithi është specifik, kur garantimi vjen për ndonjë shkak ligjor. Këtë e tregon vetë burimi i hadithit: Një person bleu një skllav prej një tjetri dhe, pasi ai e përdori atë, gjeti te skllavi një të metë të vjetër, kështu që blerësi ngriti padi te Profeti *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe ai gjykoi që skllavi t'i kthehej shitësit, i cili tha: *"O i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ty e mbi familjen e tënde!), skllavi im është vënë në punë."*

Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* tha: *"Taksa është me garantim"*, që do të thotë, sikur skllavi të vdiste në dorën e blerësit, dëmi do të ishte i blerësit, pasi marrja në pronësi, sipas përgjithësimit të hadithit, nënkupton që dobitë e sendit të marrë, janë për marrësin dhe ai është garantues për sendin e marrë në pronësi, për pasojë, edhe taksën për këtë pronësi e paguan ai. Për këtë çështje nuk ka asnjë fjalë tjetër.

I ngjashmi dhe i vlerësuari

Shejkhu El Ensarij ka folur gjatë në lidhje me termat "i ngjashmi" e "i vlerësuari", duke ditur se këto dy terma nuk kanë ardhur as në ndonjë ajet të Kur'anit e as në ndonjë transmetim.

Ti pyet: Juristi i çështjeve të fesë *(fakijh)* interesohet vetëm për dispozitat ligjore e për objektet e atyre dispozitave. Kur për fjalën nuk ka as të ngjashëm e as vlerësim të sendit dhe as ndonjë gjurmë prej fjalës së ligjvënësit, përse atëherë interesohen kaq shumë fukahatë për shpjegimin e këtyre dy termave?

Përgjigje

Patjetër që në fjalën e ligjvënësit kanë ardhur termat: "sigurim", "kryerje" dhe "besëmbajtje". Kuptimi i sigurimit të sendit e mbajtja e besës për atë send, është dalja prej përgjegjësisë, duke e kthyer vetë sendin, nëse sendi është, ose duke kthyer zëvendësuesin e sendit, kur sendi nuk është më. Në këndvështrimin e traditës, zëvendësuesi është ose një send i ngjashëm, ose vlera e tij. Pavarësisht se termat "i ngjashëm" e "i vlerësuar" nuk kanë ardhur me fjalën e ligjvënësit, ato lidhen ngushtësisht me ato që kanë ardhur në fjalën e ligjvënësit.

I ngjashmi ka kuptim që elementet e tij të jenë të barabartë në cilësi, në efekte dhe në vlerë, në atë mënyrë që, kur të përzihen dy elemente prej tij, të mos ketë mundësi që ato të dallohen prej njëri-tjetrit, ose, kur përzihen më shumë elemente të tij, përsëri nuk është e mundur që ato të dallohen nga njëri-tjetri, si për shembull, kokrrat e grurit, monedha të të njëjtit lloj, kopjet e një libri të të njëjtit botim, lapsat, ose tekstilet e punuara prej të njëjtit material e prej të njëjtës fabrikë. Për sa i përket të vlerësuarit, ai është i kundërti e të ngjashmit, pasi elementet e të vlerësuarit nuk janë të barabarta as në cilësi, as në efekte dhe, në shumicën e herëve, as në çmim, si për shembull, kafshët, shtëpitë e pemët.

Sej'jid El Jezdij, në margjinaturën e librit "El Mekàsib", ka shkruar një koment me vlera të mëdha mbi të ngjashmin dhe mbi të vlerësuarin, në të cilin tërheq vëmendjen se i ngjashmi mund të bëhet i vlerësuar dhe i vlerësuari mund të bëhet i ngjashëm.

Për shkak të qartësisë, do të citojmë tekstin e tij: "I ngjashëm është sendi për të cilin ka një send tjetër të ngjashëm me të, në cilësi e në veçanti, kurse i vlerësuari nuk është i tillë. Që të dy ndryshojnë sipas kohës, vendeve dhe përshtatjeve. Rroba, edhe pse është e kufizuar ndër sendet e vlerësuara, por në një kohë si kjo e jona, ajo gjendet me shumicë e me lloje të shumta që vijnë prej vendeve perëndimore dhe kështu ajo bëhet send i ngjashëm. Kështu ndodh edhe me librin e botuar, të cilin dijetarët e fesë nuk e kanë numëruar ndër sendet e ngjashme ose ndër sendet e vlerësuara. Patjetër që ky vlerësim ka qenë në raport me librat që gjendeshin në vendet e tyre, në kohën kur ata jetuan. Nga kjo qasje bëhet e qartë se ata, të gjithë, nuk vinin në konsideratë faktin që sendi është i ngjashëm ose i vlerësuar, sepse në fjalën e tyre ata nuk mbështeteshin në ndonjë argument të ligjit të fesë. Prandaj, nëse sendi gjendet në kohën tonë, në kundërshtim me ato që kanë përmendur ata, patjetër që ndjekja e tyre nuk është detyrë."

Me këtë rast vlen të theksohet se thënia: "Dispozitat ndërrojnë me ndërrimin e kohëve" vlen si metodë krahasuese për ato çështje që ligjvënësi i ka lënë varur në dispozitat e tij. Prandaj edhe çështjen e përkufizimit të atyre dispozitave e ka adresuar te tradita, siç është rasti me termin "i ngjashëm" dhe "i vlerësuar", ku dispozitat e ligjit të fesë e parimet e tij themelore nuk preken as nga larg e as nga afër. Për këtë temë ne kemi shkruar një kapitull të veçantë në librin tonë "Bazat e vërtetimit në fik'hun xhaferij".

* * *

KUSHTET E DY KONTRAKTUESVE

Aftësia (kapaciteti)

Fukahatë e medh'hebeve kanë folur gjatë në lidhje me aftësinë, madje aq gjatë, sa fjalët e tyre, në lidhje me aftësinë, zënë një vend mjaft të gjerë në librat e fik'hut. Por ata, me keqardhje, nuk kanë shkruar një kapitull të veçantë për aftësinë, ku të shpjegonin të gjitha çështjet e dispozitat që kanë lidhje me aftësinë, ashtu siç veprojnë sot juristët e rinj. Fukahatë kanë folur për aftësinë sipas rasteve në kapitullin e adhurimeve, të marrëdhënieve të ndërsjella, të dispozitave dhe të penaliteteve.

Në kapitullin e adhurimeve, ata kanë trajtuar gjerë e gjatë vlefshmërinë e agjërimit të fëmijës, namazin e Haxhin e tij. Gjithashtu, kanë trajtuar detyrimin që fëmija ka për dhënien e zekatit prej pasurisë së tij, ashtu siç kanë trajtuar në kapitullin e marrëdhënieve të ndërsjella zëvendësimin e fëmijës në veprimet e tij, me të gjitha derivatet që rrjedhin prej atyre veprimeve.

Në kapitullin e dispozitave kanë folur për pastrimin e fëmijës nga papastërtitë, me dëshminë e me sendin e gjetur prej tij, kanë folur gjatë edhe për kontrollin e tij për gjërat e lejuara, për

kujdestarinë mbi fëmijën e për kujdestarinë mbi pasurinë e tij. Kanë folur për testamentin e lënë për fëmijën, për vakëfin e lënë prej fëmijës, ashtu siç kanë folur edhe për detyrimet që ka fëmija për të shpenzuar për të afërmit e vet.

Në kapitullin e penaliteteve kanë folur për edukimin e fëmijës, për garantimin e gjërave që ai prish dhe për gjëra të tjera, për të cilat nuk është e nevojshme as të numërohet e as të derdhet mund e kohë për të tilla çështje.

Juristët i rinj dhe disa prej fukahave të vjetër e kanë ndarë aftësinë në aftësi të detyrueshme dhe në aftësi kryerje. Me të parën, kanë pasur qëllim kompetencën e njeriut për të pasur të drejtat dhe përgjegjësitë që ligjvënësi ka bërë për njeriun dhe për të cilat ai ka të drejtën e përdorimit dhe të veprimit në kuadrin e këtyre të drejtave, kurse me të dytën, kanë pasur qëllim kompetencën e njeriut për të përdorur gjërat për të cilat ai ka të drejtë të ekzekutojë veprimin e tij në kuadrin e asaj të drejte.

Shkurtimisht do të flasim rreth aftësisë (kapacitetit), ashtu siç kanë pasur qëllim edhe fukahatë në fjalët e tyre të shumta e të shpërndara në shumë kapituj të fik'hut. Ne kemi parë se termi "aftësi" te fukahatë ndryshon me ndryshimin e etapave dhe mjediseve nëpër të cilat kalon njeriu gjatë jetës së tij, që nga koha kur është embrion në barkun e nënës së tij, pastaj ndarja e tij prej nënës i gjallë, derisa arrin moshën kur dallon dhe më pas kur fiton logjikën, e cila arrihet në moshën e pjekurisë.

Aftësia e mençurisë te të rriturit ndryshon sipas ndryshimit të gjendjeve të tij: racional, naiv, i shëndetshëm, i sëmurë, i ditur, i

drejtë dhe të tjera gjendje. Më poshtë do të shikojmë të gjitha këto gjendje nëpër të cilat kalon njeriu, ose ato më të rëndësishmet.

1- Fetusi, ka aftësi për testamentin që lihet për të, ose në emër të tij, të lihet vakëf. Gjithashtu, është e detyrueshme që për fetusin të mbahet e paprekur pjesa më e madhe e trashëgimisë së babait të tij, me kusht që prej kësaj lënie të mos preket asgjë, derisa ai të lindë i gjallë, sepse kjo e drejtë është e vërtetuar për njeriun, kur ai është gjallë, qoftë edhe kur është fetus në barkun e nënës së tij.

2- Që me ndarjen i gjallë të fetusit prej nënës dhe para se të arrijë moshën e pjekurisë, por jo kur është në moshën kur ai dallon. Në këtë fazë të rritjes, njeriu fiton aftësinë të mbajë detyrimin për borxhin, madje edhe për borxhet e trashëguara, sipas sentencës së kalimit të borxheve nga përgjegjësia e të vdekurit te përgjegjësia e trashëgimtarëve, por jo për sendet konkrete të trashëgimisë.

Fëmija e i çmenduri garantojnë (dëmshpërblejnë) kur prishin ose shkaktojnë të meta në pasurinë e tjetrit. Kujdestari është i detyruar të shlyejë dëmin e bërë prej pasurisë së fëmijës dhe të të çmendurit, natyrisht në qoftë se ata kanë pasuri, ndryshe ai që ka të drejtën e marrjes së dëmshpërblimit, do të presë në besëdhënie, derisa minoreni të aftësohet, ose derisa i çmenduri të shërohet.

Fëmija, gjithashtu, ka sendet që blihen për të, si dhe sendet që i dhurohen atij, gjithashtu, është e vlefshme edhe ortakëria me fëmijën. Në emër të fëmijës bëhet pajtim dhe lidhen kontrata shitje e kontrata blerje; për fëmijën shkruhet akti i martesës së tij, përfshirë edhe të gjitha kontratat e tjera që kujdestari lidh për llogari të fëmijës, në bazë të principeve të ligjit të fesë. Kjo e drejtë është e saktësuar për njeriun e gjallë jo të huaj.

Për sa u përket fjalëve dhe punëve të atij që akoma s'ka arritur të dallojë, ato janë si tymi dhe, në mënyrë absolute, nuk kanë asnjë efekt ligjor, madje edhe sikur ato të jenë në dobi të tij.[1]

3- Kur njeriu hyn në periudhën që arrin të dallojë, sipas fjalës së fukahave më të dëgjuar, ai bëhet i aftë për të dhënë sadaka. Gjithashtu, është i vlefshëm testamenti i tij i lënë për bamirësi, për të kontrolluar gjërat e lejuara, meriton të jetë në vendet publike kur ndodhet aty, të marrë në pronësi sendin e gjetur, kur është më pak se një dirhem. Gjithashtu, fëmija, në këtë moshë, i nënshtrohet edhe ndëshkimit për vjedhje, për homoseksualitet, etj.

4- Kur njeriu arrin moshën e pjekurisë mendore dhe dallon udhën e drejtë, ai bëhet i pavarur në të gjitha veprimet e tij financiare dhe jo financiare. Nëse është me mangësi mendore, ai ndalohet të kryejë veprime financiare pa lejen e kujdestarit të tij.

5- Ai që gëzon shëndet të plotë dhe nuk është frikë se vdes prej sëmundjes nga e cila lëngon, ka të drejtë të veprojë në të gjitha pasuritë e tij, por ai ndalohet të veprojë me pasuritë e tij, kur veprimet e tij arrijnë një të tretën e gjithë pasurisë.

---

[1]) Në librin "Uesijletu Nexhàt", i autorit Sejjid Ebul Hasan El Isfehànij thuhet: "Kur i çmenduri e fëmija gjejnë në rrugë më pak se një dirhem, ata e marrin atë në pronësi të tyre. Kjo është e barabartë, qoftë kur ata kanë qëllim ta marrin vetë si pasuri, qoftë kur këtë qëllim e ka kujdestari i tyre. Unë, thotë shejkhu në vijim, nuk kam parë fekijh që të rendisë ndonjë efekt ligjor mbi qëllimin e të çmendurit dhe të fëmijës që akoma nuk ka arritur moshën kur fëmija dallon në lidhje me sendin e gjetur dhe as për ndonjë veprim tjetër të tyre."
Madje, autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Nuk ka dispozitë ligjore për fëmijën, kur ai gjen një send të hedhur, edhe nëse ka arritur moshën kur dallon dhe është adoleshent."

6- Kur njeriu arrin maturinë, fiton të drejtën për të dhënë dëshmi që vërteton të drejtën, të prijë Imam në faljen e namazit për grupin e tij dhe të marrë në dorë punë administrative.

7- Hulumtuesi është i aftë të nxjerrë sentenca dhe të gjykojë, të marrë nën kujdestari jetimët, të çendurit dhe ata që nuk janë të pranishëm. Babai është ai që merr nën kujdestari fëmijët e tij të vegjël.

Nga kjo që u tha më sipër, rezulton se aftësia e çdo sendi është sipas vetë sendit. Unë nuk jam udhëzuar për një njohje të veçantë të aftësisë përveç kësaj prirjeje që shpreh kjo fjalë, sepse është e pamundur që aftësia të kuptohet e zhveshur prej burimeve të saj. Për sa i përket ndarjes së saj në aftësi të detyrueshme dhe në aftësi kryerjeje, duhet thënë se kjo është një ndarje jo e plotë, pasi nuk përfshin të gjitha burimet, me përjashtim të një shembulli që flet për obligim e brutalitet, sepse aftësia e njeriut për të dëshmuar, për shembull, nuk vërteton asgjë kundër ose në favor të vetë njeriut që kjo aftësi e tij të hyjë në kategorinë aftësi obliguese.

Gjithashtu, edhe njoftimi për dëshminë nuk është prej efekteve të drejtësisë në asnjë send, ose që aftësia e tij për të dëshmuar të hyjë në kategorinë aftësi kryerje, por është vetëm njëri prej efekteve të diturisë për të drejtën. Kjo është edhe arsyeja që i lejohet çdo njeriu të drejtë ose jo të drejtë të dëshmojë për atë çka di.

Në tërësi, këto ishin fjalët në lidhje me aftësinë, ashtu siç janë renditur prej fukahave dhe ne i pohuam më sipër, kur folëm për kushtet që duhet të kenë dy kontraktuesit.

* * *

MOSHA MADHORE *(bulùg)*

Për shitblerjen ka tri kërkesa: kontrata, dy kontraktuesit dhe malli për të cilin lidhet kontrata. Më lart kemi folur për kontratën e për kushtet e kontratës. Kërkesat për dy kontraktuesit janë: mendja, mosha madhore, qëllimi, përzgjedhja e vullnetshme, kompetenca për zotërimin e mallit të kontraktuar, mosngurtësimi i kontratës për shkaqe mendore, për shkak falimentimi, për shkak sëmundjeje vdekjeprurëse.

Pas kësaj përmbledhjeje do të kalojmë në sqarimin e këtyre gjërave që u thanë në këtë paragraf.

I çmenduri

Për kushtin e mendjes tregon vetë mendja, teksti dhe fjala e përbashkët e dijetarëve të fesë se shitja dhe blerja e të çmendurit nuk është e vlefshme, edhe nëse ka lejen e kujdestarit, sepse ai nuk mund të ketë ndjenjën e veprimit që të marrë në konsideratë blerjen e shitjen që bën.

Gjithashtu, i çenduri nuk ka as ndjenjën e qëllimit për veprimin që kryen, pavarësisht se ka arritur moshën madhore. Të çmendurit, në këtë pikëpamje, i atashohet i dehuri, ai që ka humbur vetëdijen, i zemëruari kur zemërimi dominon mbi arsyen. Të gjithë këta njerëz janë të barabartë në mospasjen e ndjenjës dhe të qëllimit.

Autori i librit "El Mustened" ka thënë: "Nuk është e vlefshme shitja, kur zemërimi është dominues mbi arsyen."

Nuk ka asnjë dallim mes të çmendurit të përhershëm dhe mes atij që i vjen çmenduria me faza, kur çmenduria qëllon në kohën e lidhjes së kontratës. Nëse lidhja e kontratës bëhet, kur atij i kthehet vetëdija, me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo kontratë është e vlefshme.

I vogli

Allahu i Lartësuar thotë:

"وَابْتَلُوا الْيَتَامَى حَتَّى إِذَا بَلَغُوا النِّكَاحَ فَإِنْ آنَسْتُم مِّنْهُمْ رُشْداً فَادْفَعُوا إِلَيْهِمْ أَمْوَالَهُمْ"

"Provoni jetimët, derisa të bëhen për martesë dhe, nëse vëreni te ata pjekurinë, atëherë dorëzoni atyre pasurinë e vet…" *(Sure "En Nisa", ajeti 6)*

I Dërguari më i madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Lapsi është ngritur (nuk shkruan mëkate) për tre: për të voglin, derisa arrin moshën e pjekurisë, për të çmendurin, derisa të ndërgjegjësohet dhe për atë që është në gjumë, derisa të zgjohet."*

Edhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Fëmijës i jepet ajo që është e tij, kur arrin moshën e pjekurisë, kur te ai konstatohet logjika dhe nuk është as i metë nga mendja e as i sëmurë."*

Është pyetur babai i Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Në ç'moshë dënohet fizikisht fëmija, me të gjitha dënimet që parashikon ligji i fesë?"*

Ai është përgjigjur: *"Kur arrin moshën e pjekurisë seksuale, ose kur mbush pesëmbëdhjetë vjeç, ose kur i dalin qimet në faqe. Pikërisht në këtë moshë, mbi të zbatohen dënimet fizike që parashikon ligji i fesë dhe ai dënohet e ndëshkohet."*

Dikush pyeti: *"Po mbi vajzën, kur zbatohen dënimet fizike të ligjit të fesë?"*

Ai është përgjigjur: *"Vajza nuk është e njëjtë me djalin. Ajo dënohet fizikisht, kur martohet dhe burri ka kryer marrëdhënie me të, kur ajo është nëntë vjeç. Në këtë moshë, ajo nuk konsiderohet më jetime, asaj i dorëzohet ajo që është e saj. Në këtë moshë lejohet puna e saj në shitje e në blerje. Në këtë moshë, mbi vajzën zbatohen dënimet fizike të ligjit të fesë dhe ajo ka të drejtë të kërkojë dënime fizike për të drejtën e saj.*

Për djalin nuk është e lejueshme puna e tij në shitje e në blerje dhe as nuk del prej gjendjes së të qenit jetim, derisa të mbushë pesëmbëdhjetë vjeç, ose derisa të arrijë moshën e pjekurisë seksuale, ose deri kur t'i dalin qimet në faqe."

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se veprimet e fëmijës që nuk dallon *(gajrul- mumej'jiz)*, në mënyrë absolute, veprimet e tij janë të pavlefshme. Por ata kanë kundërshtime mes tyre, në lidhje me veprimet e fëmijës që dallon sipas sqarimit që do të bëjmë në vijim.

Besimi islam i fëmijës

Kur fëmija që dallon është lindur prej dy prindërve jo myslimanë, ai hyn në dispozitën e dy prindërve të vet. Kur ky fëmijë përqafon Islamin, para se të arrijë moshën e pjekurisë, një grup fukahash, ndër të cilët shejkhu Et Tùsij, ashtu siç ka cituar prej tij Sej'jid El Jezdij dhe shejkhu En Nàijnij, kanë gjykuar se Islami i tij është i vlefshëm, sepse shkaku që e bën të detyrueshëm vlefshmërinë e veprimit, është të kuptuarit.

Kur adoleshenti arrin të kuptojë se Muhamedi *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* është i vërtetë në thirrjen që ka bërë, ai bëhet mysliman.

Shumica e fukahave, ndër të cilët edhe autori i librit "El Xheuavir" kanë thënë: "Islami i tij nuk është i vlefshëm, për shkak të ngritjes së lapsit prej tij."

Pa asnjë dyshim që Islami, në vetvete, është i mirë, edhe kur për analogji, e mira e tij nuk është as detyrë e as i detyrueshëm, në raport me fëmijën që dallon, madje, pa më të voglin anim mes lejimit e punës së preferuar dhe, kjo, bazuar sipas parimit: "Çdo detyrë në të drejtën e atij që ka arritur moshën e pjekurisë, është punë e pëlqyer në të drejtën e fëmijës."

Adhurimi i fëmijës

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se adhurimi për fëmijën, agjërimi, namazi e Haxhi, janë detyrime ligjore, por jo detyrime që ai duhet t'i ushtrojë. Këtë sentencë (fetva) e kanë mbështetur shejkhu El Ensarij, Sej'jid El Jezdij dhe shejkhu

Muham'med El Esfehànij. Madje ky i fundit, në margjinaturën e librit "El Mekasib" ka shkruar: "Argumentet e obligimit nuk janë detyruese e as pengesë që ata të mos e përfshijnë fëmijën."

Thënia më e përhapur nuk është larg prej bazave dhe rregullave, sepse adhurimi, në vetvete, është veprim i mirë dhe i dashur te Allahu i Lartësuar, për më tepër, fëmija, kur arin moshën që dallon e kupton këtë gjë.

Pra, adhurimi i mundëson atij afrimin pranë Krijuesit të vet për shkak të vetë karakteristikës afruese që ka adhurimi. Për sa i përket hadithit: "Lapsi është ngritur…", patjetër qëllimi është heqja e dënimit që nënkupton mospërmbajtja në kryerjen e obligimit, ashtu siç nënkupton heqja e detyrimit heqjen e dënimit.

Me fjalë të tjera, kuptimi i hadithit: *"Lapsi është ngritur për të çmendurin, për fëmijën e për atë që është në gjumë."*, tregon se në këtë gjendje ata nuk janë të obliguar të kryejnë adhurimet, lënia e të cilave sjell dënim. Është e kuptueshme se për adhurimet e pëlqyeshme *(mustehab)* nuk ka as dënim e as ndëshkim për atë që i le. Atëherë rezulton se hadithi nuk bën fjalë për adhurimet e vullnetshme, por as nuk i mohon e as nuk i vërteton si obligim. Bazuar mbi këtë sentencë, nuk është e vlefshme nxjerrja e argumenteve për të mohuar detyrimin për të kryer adhurime të vullnetshme, ose për t'i vërtetuar ato, prandaj argumentet e vërtetuara për dispozitat e adhurimeve të vullnetshme, në tërësinë e në gjithëpërfshirjen që ato kanë, qëndrojnë për çdo fëmijë që ka arritur moshën kur dallon, ose kur arrin moshën e pjekurisë seksuale, apo edhe para se të arrijë këtë moshë.

Testamenti dhe sadakaja e fëmijës

Thënia më e përhapur në mesin e fukahave është: Kur fëmija që dallon, mbush dhjetë vjeç, për punë të mira, janë të lejuara testamenti dhe sadakaja e tij. Në lidhje me këtë çështje ka shumë transmetime të shkallës "Sahijh", të ardhura prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!).

Ndër këto transmetime kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Kur djali mbush dhjetë vjeç, testamenti i tij lejohet…*", që do të thotë se për djalin është i vlefshëm lirimi i robit, është e vlefshme edhe sadakaja që ai jep, ose testamenti që ai le për punë të mira.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kjo është thënia më e përhapur te tradita e te arritjet e rezultateve studimore. Madje, disa këtë thënie e kanë atashuar në thënien e fukahave, duke pretenduar se kjo gëzon fjalën e përbashkët të fukahave."

Fukaha të tjerë kanë bashkuar lënien vakëf nga ana e fëmijës me lënien testament nga ana e tij për punë të mira. Për këtë ata janë bazuar në një transmetim që tregon se, kur është pyetur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për sadakanë e fëmijës, ka thënë: *"Po, kur ai e jep sadakanë aty ku duhet dhënë sadakaja."*

Thënia më e përhapur në mesin e fukahave është moslejimi i lënies vakëf nga ana e fëmijës, sepse dhënia sadaka është një gjë dhe lënia vakëf është një gjë tjetër. Madje në librat e fik'hut ka një kapitull të veçantë për sadakanë dhe një kapitull tjetër për lënien vakëf.

Divorci i fëmijës

Thënia për vlefshmërinë e divorcit nga ana e fëmijës që ka mbushur dhjetë vjeç, i atashohet Ibn El Xhunejdit, bazuar mbi një transmetim prej të cilit është hequr dorë, për shkak të kundërshtimit që ka me dispozitat e përgjithshme. Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Nuk lejohet divorci i fëmijës, derisa ai të arrijë pjekurinë seksuale."*

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Transmetimi tregon për vlefshmërinë e divorcit të fëmijës që ka arritur moshën dhjetë vjeç, mbështetur në mundësinë që "kanë disa karaktere në disa vende të nxehta, ku qimet e fytyrës mbijnë te djemtë që në moshën dhjetë vjeç, ose kur pjekuria seksuale arrihet shumë më herët."

Shejkhu Esedull'llàh Et Testerij, në librin "El Mekàjijs", ka thënë: "Nuk kam hasur ndonjë transmetim të ardhur prej Ehli Bejtit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!) përveç dhënies sadaka e lënies testament, që janë të pakundërshtueshme, në mbështetje e në argument."

Gjobitja e fëmijës

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se fëmija dhe i çmenduri gjobiten në pasurinë e tyre për dëmin që i shkaktojnë pasurisë së tjetrit, qoftë kur e shkatërrojnë, qoftë kur e dëmtojnë atë, sepse garantimi bazohet në të njëjtën ndodhi, pavarësisht nga qëllimi, vullneti e mendja. Pikërisht për këtë shkak, në shkollat e studentëve e të nxënësve, është mjaft e përhapur sentenca:

"Dispozitat ligjore nuk janë specifike vetëm për ata që kanë arritur moshën e për të mençurit."

Bazuar mbi këtë sentencë, bëhet e qartë mosndarja mes dispozitave pozitiviste dhe obliguese.[1]

Ndëshkimi i fëmijës

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se fëmija, kur arrin moshën që dallon, ndëshkohet për fajet e mëdha që kryen. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tregon: *"Te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!), sollën një burrë që kishte përdorur një djalë për marrëdhënie homoseksuale. Për këtë dëshmuan dëshmitarët. Prandaj ai urdhëroi që burri të ekzekutohej, ndërsa djali u ndëshkua me rrahje, më pak se sa parashikon ligji i fesë.* Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha djalit: *"Sikur të kishe arritur moshën që dallon, patjetër që do të të kisha vrarë edhe ty, sepse do të kishe mundësi të ruaje veten."*

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Nëse fëmija ose i çmenduri kryen marrëdhënie homoseksuale, të dy ndëshkohen në të njëjtën mënyrë."

---

[1] Dispozitat obliguese në veprime, si dërgimi me mision dhe nxitja për punë, është detyrë. Po kështu është detyrë edhe qortimi e sprapsja nga veprimi e nga gjëja e ndaluar *(haram)*. Padyshim që për obligimet, kërkesë bazë janë mendja, qëllimi e përzgjedhja. Herë tjetër kërkohet nijeti me qëllim afrimin te Allahu i Lartësuar, ashtu siç është për adhurimin.
Për sa u përket dispozitave pozitiviste, ato nuk përmbajnë asgjë nga këto që u thanë, por janë të orientuara vetëm në saktësinë e në mossaktësinë e punës, ose në garantimin e veprimeve të tjera të ngjashme.

Fëmija ka pasuri me kontroll

Fëmija që dallon, ka pasuri të lejuara me kontroll, si: ujëra, kullota, drufrutorë, etj. Gjithashtu, sipas një thënieje, fëmija merr në pronësi edhe sendin e hedhur, kur vlera e saj është më pak se një dirhem. Fëmija ka të drejtë të ketë në pronësi një pjesë toke të vdekur, të cilës ai i ka dhënë jetë, por përparësi kanë punët e mira që ai bën, kur ato janë vende publike, si: ndërtim xhamie, sheshe e parqe.

Kontrata e fëmijës

Thënia më e përhapur midis fukahave të Medh'hebit Xhaferij është se kontrata e fëmijës që dallon, por që nuk ka arritur moshën e pjekurisë, është e pavlerë, qoftë edhe kur ajo është lidhur me lejen e kujdestarit të tij. Kjo është e barabartë, qoftë kur fëmija e nënshkruan kontratën për interesat e veta, qoftë kur ai nënshkruan për dikë tjetër. Gjithashtu, është barabartë kur ajo është për sende të rëndomta, apo për sende të zakonshme, me përjashtim të veprimit të fëmijës për të dhënë sadaka dhe për të lënë testament për punë të mira.

Në lidhje me këtë çështje, kemi fjalën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Lapsi është ngritur (nuk shkruan) për fëmijën, derisa të arrijë pjekurinë seksuale."*, si dhe fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Veprimi me qëllim i fëmijës dhe gabimi i tij janë një."*

Këto thënie tregojnë se veprimi që fëmija bën me qëllim, është plotësisht si veprimi që i madhi e bën gabim, prandaj

kontrata e gabuar e të madhit nuk ka asnjë efekt, gjithashtu, edhe kontrata e fëmijës, e lidhur me qëllim, nuk ka asnjë efekt.

Shejkhu El Ensarij, në librin "El Mekàsib", thotë: "Kur ne bëjmë bashkimin e argumenteve, ato vërtetojnë se nuk merret në konsideratë veprimi i dalë prej fëmijës që dallon dhe veprimi i dalë prej fëmijëve të tjerë, për veprime në të cilat qëllimi merret në konsideratë, siç është ndërtimi i kontratave origjinale ose me prokurë, marrja në dorëzim dhe dhënia në dorëzim, si dhe çdo detyrim që fëmija merr mbi vete si garantimi, pohimi, e taksura *(nedhr)* ose lejimi."

Fukahatë më të dëgjuar kanë kundërshtuar një grup fukahash që janë shprehur për lejimin e veprimeve të fëmijës që dallon dhe për vlefshmërinë e veprimeve që kryen fëmija, kur ka lejen e kujdestarit.

Midis tyre janë: krenaria e hulumtuesve, djali i dijetarit poliedrik El Hil'lij, Sej'jid Kadhim El Jezdij, shejkhu El Erdebelij dhe Sej'jid El Hakijm, i cili në librin "Nehxhul Fukahah", në faqen 183, botim i vitit 1371H, ka thënë: "Nuk duhet të mendojmë shumë në vërtetimin e rrugës që kanë ndjekur njerëzit e mençur në të gjithë shekujt, por as nuk është vërtetuar heqja dorë prej kësaj.[1] Ajo që duket sheshit, është fakti se nuk duhet të mendojmë shumë as për rrugën që kanë ndjekur juristët e fesë islame, atëherë

[1] Dallimi mes rrugës që kanë ndjekur njerëzit e mençur dhe mes rrugës së ndjekur prej fukahave myslimanë, qëndron në faktin se, e para, shpreh vijueshmërinë e njerëzve të mençur për sende në të cilat ata janë racionalë, pavarësisht nga feja që ata besojnë, madje edhe ateistët hyjnë në këtë grup, ashtu siç merret në konsideratë sipas traditës. Për sa i përket së dytës, ajo është vijimësia e fukahave myslimanë në punë, ndër të cilët edhe fukahatë e angazhuar në studimin e dispozitave ligjore.

nuk është larg fjala për vlefshmërinë e kontratës së fëmijës, kur ai e lidh atë me lejen e kujdestarit, ashtu siç kanë preferuar të thonë një grup fukahash, ndër të cilët studiuesi El Erdebelij dhe para tij, krenaria e studiuesve, në librin "El Ijdàh"."

Të tjerë fukaha kanë thënë se është e lejuar marrëdhënia e ndërsjellë e fëmijës që dallon vetëm për punë të rëndomta, si për shembull, për të blerë zarzavate, vezë, bukë të gatshme e të tjera të ngjashme, por nuk është e vlefshme për gjëra të tjera.

E vërteta në të cilën ne besojmë, është se fëmija i zgjuar dhe i siguruar ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet që atij i sjellin dobi e përmirësim, sepse arritja e moshës së pjekurisë seksuale është mjet dhe jo qëllim. Ky është edhe shkaku që, kur djali arrin moshën e pjekurisë seksuale dhe zotëron mendje të plotë, ai mund të ekzekutohet për vepra të rënda penale. Atëherë mësimi i nxjerrë konsiston në zotërimin e mendjes së plotë dhe jo në pjekurinë seksuale. Atyre që besojnë vetëm në "është thënë dhe ka thënë", ne u themi: "Në këtë çështje nuk jemi vetëm ne, pasi në librin "El Mekàjijs", të autorit Et Testerij, në vëllimin 2, në faqen 4, botim i vitit 1322H, tekstualisht thuhet: "Në lidhje me shitjen e blerjen nga ana e atij që ka mbushur dhjetë vjeç, ka thënie që flasin për lejim. Madje disa fukaha këto thënie ia kanë atashuar Shejkhut, domethënë shejkhut Et Tùsij, shejkhut të grupit. Këtë fakt, dijetari poliedrik e ka përmendur në librin "Et Tedhkireh", drejtuar fukahave tanë.

Në librin "Et Tahrijr" ai ka thënë se një transmetim flet për vlefshmërinë e shitjes nga ana e fëmijës, kur ai është dhjetë vjeç dhe zotëron mendje të shëndoshë. Të njëjtën gjë ka përmendur edhe dijetari Es Sajmerij."

Në librin "Miftahul Kerameh", në kapitullin "Shitoret", në faqen 170, thuhet: "Thënia për lejimin e shitjes nga ana e fëmijës që ka mbushur dhjetë vjeç dhe është i mençur, herë i atashohet shejkhut dhe herë tjetër fukahave të tjerë…Gjithashtu, kjo thënie trajtohet edhe në librin "El Mebsùt", ku gjendet transmetimi që thotë se, kur fëmija mbush dhjetë vjeç dhe është i udhëzuar (zotëron mendje të plotë), veprimet e tij janë të vlefshme."

Ky transmetim specifikon transmetimet e tjera, kuptimi i përbashkët i të cilave është se puna e fëmijës në shitje e në blerje nuk lejohet, derisa ai të mbushë pesëmbëdhjetë vjeç[1], ose kur arrin pjekurinë seksuale, ose kur i dalin qimet në fytyrë, ose kur është dhjetë vjeç dhe është i mençur.

Këtë fakt e përforcon fjala e studiuesit El Erdebelij, në komentin e librit "El Irshàd": "Derisa është e lejuar lirimi i robit dhe lënia testament për punë të mira nga ana e fëmijës, ashtu siç del qartë prej shumë transmetimeve, nuk është larg që të jetë e lejuar edhe shitja e blerja e tij, si dhe të gjitha veprimet e tij të tjera, kur fëmija është i mençur dhe në moshën që dallon, kur njeh dobinë e dëmin në pasurinë e tij dhe di rrugët e ruajtjes e të veprimit, ashtu siç i gjejmë sot pjesën më të madhe të fëmijëve, madje në mesin e fëmijëve të sotshëm mund të gjenden të atillë që në punët e shitblerjes të jenë më të përsosur se prindërit e tyre, prandaj nuk ka asnjë pengesë që fëmija të lidhë kontratë, sidomos kur ka edhe leje prej kujdestarit dhe praninë e kujdestarit pas caktimit të çmimit."

[1] Në disa transmetime është thënë trembëdhjetë vjeç. Kjo, në fakt, përforcon fjalën tonë.

Fjala "në mënyrë të veçantë, kur ka edhe lejen e kujdestarit të tij", tregon qartë se veprimet e ndërsjella të fëmijës janë të lejuara edhe pa lejen e kujdestarit, por ato veprime përforcohen me praninë e kujdestarit. Të gjithë ne e dimë pozitën fetare dhe shkencore të shejkhut El Erdebelij, madje pozita e tij është aq e lartë, sa ka marrë famë si njeri i shenjtë dhe te të gjithë fukahatë cilësohet studiues (vdekur në vitin 993H).

Autorizimi i fëmijës dhe i të çmendurit

Kur formula e shitblerjes del prej një fëmije, veprimet e të cilit nuk janë të vlefshme, por, pasi arrin moshën e pjekurisë, ai e konsideron të lejuar, ose i çmenduri e lejon, pasi i kthehet vetëdija, ose ai që ishte në gjumë, pasi zgjohet, ose i dehuri, pasi i largohet efekti i dehjes, ose atij që i ka rënë të fikët, pas largimit të gjendjes së të rënit të fikët, të gjithë këta nuk kanë ndonjë efekt për lejimin e tyre, kur nuk e kanë zakon të lidhin kontrata. Si bazë, nuk kanë asnjë efekt në asgjë prej veprimeve të tyre, pasi, në të vërtetë, nuk ka kontratë dhe për qëndrimin e lejimit nuk ka mbetur asnjë subjekt që të ketë lidhje me kontratën ose që t'i përgjigjet kontratës.

Me një fjalë, mendja dhe pjekuria seksuale janë kushte bazë për ekzistencën e kontratës, jo se kontrata është praktikisht, por i çmenduri dhe fëmija janë pengesë për ekzekutimin e kontratës, derisa te ata të dy të hiqet pengesa që pengon efektin e vetë kontratës.

* * *

QËLLIMI DHE ZGJEDHJA

Çfarë detyrë merret në konsideratë me qëllimin?

Fukahatë kanë një mendim të përbashkët se të gjitha fjalët e veprimet, ashtu siç janë, nuk kanë asnjë ndikim në marrëdhëniet e ndërsjella, në penalitetet, në konfirmimet, në dëshmitë etj, pasi, në të vërtetë, ato janë vetëm argument mbi të cilin renditet ndikimi ligjor për mënyrën e shprehjes së qëllimit. Pikërisht kjo është origjinë dhe bazë, ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): *"Punët vlerësohen sipas qëllimit."*

Gjithashtu, edhe Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "*S'ka divorc, me përjashtim të atij që ka qëllim divorcin.*", pa përmendur këtu hadithe të tjera të të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe transmetimet e përcjella prej Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!),* prej gjyshit të tyre. Kur ne kemi mësuar me një rrugë ose me një rrugë tjetër mospasjen qëllim në kuptimin e fjalës, atëherë ekzistenca dhe mosekzistenca e fjalës është e barabartë.

Kjo është përmendur disa herë në librat e fik'hut, sidomos në kapitullin e marrëdhënieve të ndërsjella. Sej'jid El Jezdij, në margjinaturën e librit "El Mekàsib", ka shkruar: "Sikur të dihej prej folësit mospasja qëllim, ose përmbajtja e qëllimit, ose mospasja qëllim ndërtimin (e kontratës), ajo është e prishur."

Shejkhu Et Testerij, në librin "El Mekàjijs", ka thënë: "Kontrata pa qëllim, në të vërtetë, nuk është kontratë, sepse efekti i formulës nuk është thjesht përkushtim, ashtu siç është gjendja në lutjen e namazeve, pasi, në fakt, vetë formula quhet kontratë, duke pasur në brendësi të saj edhe qëllimin e ndërtimit të saj, me propozimin dhe me pranimin."

Shejkhu El Esfehànij, në margjinaturën e librit "El Mekàsib", ka shkruar: "S'ka formulë pa qëllim.", pa folur këtu për shprehjet e tjera të panumërta. Të gjitha këto shprehje tregojnë se kontrata e merr ekzistencën e saj prej qëllimit dhe jo prej formës, prandaj ekzistenca e kontratës është ashtu siç është arritur konsensusi për atë dhe, kur mungon qëllimi, ose kur ajo është e shkel e shko, nuk ka vend që ajo të atakohet, sepse nuk mungon qëllimi, ose ajo është e imponuar. Është shumë e përhapur thënia se kontratat ndjekin qëllimet.

Ti mund të pyesësh: Kur qëllimi qenka prej elementeve të kontratës, përse e kanë përmendur fukahatë qëllimin së bashku me kushtet e dy kontraktuesve dhe jo së bashku me kushtet e kontratës?

Përgjigjja është: Patjetër, qëllimi është prej veprimeve paraprake të kontratës, por fukahatë e kanë përmendur qëllimin së bashku me kushtet e dy kontraktuesve për shkak të lidhjes që

ka qëllimi me ata të dy dhe për mosndarjen e qëllimit prej atyre të dyve, plotësisht ashtu siç nuk mund të ndahet mendja me arritjen e moshës.

Qëllimi pa imponim

Kuptimi i qëllimit pa imponim, mbi të cilin renditet efekti ligjor, konsiston në faktin se dy kontraktuesit të dëshirojnë ndërtimin e kontratës, duke kërkuar efektet e kësaj kontrate dhe marrjen e atyre efekteve pa asnjë presion e imponim prej askujt. Për shembull, kur ai thotë pa asnjë imponim: "Ta shita shtëpinë time kundrejt kësaj shume.", padyshim që me këtë shprehje ai ka qëllim ndërtimin e kontratës, si dhe renditjen e veprimeve që vijnë prej saj, siç është kalimi i shtëpisë nga pronësia e tij në pronësi të pranuesit dhe oferta është e vlefshme.

Nëse e dimë se ai e nxori këtë fjalë pa qëllim, ose ka pasur qëllim ndërtimin e kontratës, por s'ka pasur qëllim efektet e saj, ose edhe i ka pasur qëllim efektet e kontratës, por ky qëllim për ndërtimin e kontratës është për shkak të imponimit, kontrata është e prishur.

Bazuar mbi këtë pikë, janë ndërtuar shumë akte e nënakte ligjore, një pjesë prej të cilave do t'i trajtojmë në vijim.

Njeriu në gjumë dhe të ngjashmit me të

S'ka efekt as oferta e as pranimi, kur ato dalin prej njeriut që harron, ose prej njeriut në gjumë, ose prej atij që i ka rënë të

fikët dhe ka humbur vetëdijen, ose prej të dehurit, ose prej njeriut të zemëruar aq shumë, sa zemërimi i ka zotëruar mendjen, sepse në këto raste, që në bazë kemi mungesën e qëllimit. E njëjta gjë është edhe kur ai ka pasur qëllim njoftimin ose pyetjen, por jo ndërtimin e kontratës.

Për sa i përket ndërtimit të kontratës prej atij që e ka zakon të flasë me shaka, kontrata nuk mund të ndërtohet me fjalët e tij, përderisa vazhdon që ato fjalë të mos jenë thënë me seriozitet për efektet e kontratës dhe për marrjen e efekteve të saj. I ngjashëm si shembull me këtë është kontrata e ndërtuar me marrëveshje të dyanshme, duke parë fotografinë.

Imponimi

Kur ai ka qëllim ndërtimin e kontratës, duke kërkuar edhe efektet e saj, që të punojë mbi ato efekte, por ky qëllim i tij është i lindur prej presionit e imponimit, me fjalën e përbashkët të fukahave, qëllimi për ndërtimin e kontratës, në këto kushte, nuk ka efekt. Për këtë çështje kemi fjalën e të Dërguarit më të madh (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): *"Për umetin tim lapsi është ngritur për gabimin, për harresën dhe për punë të imponuara."*, si dhe fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Nuk ndodh divorci as me imponim, as në gjendje dehje e as në gjendje zemërimi."*

Ti mund të pyesësh: Si mund të jenë bashkë imponimi me qëllimin, duke ditur se imponimi është mungesa e qëllimit, ose rezultat i këtij qëllimi?

Përgjigjja jonë është: Mizori i fuqishëm të kërcënon për shkak se ti nuk dëshiron të shesësh, në të njëjtën kohë frikësohesh prej dëmit që mund të vijë prej këtij kërcënimi. Pikërisht prej kësaj frike, te ti lind dëshira për të shitur shtëpinë, me qëllim që të sprapsësh prej vetes një dëm akoma më të madh, ose me më shumë rrezik. Në këtë gjendje bashkohet qëllimi i shitjes me shkakun që motivon shitjen dhe ky shkak është imponimi.

Sej'jid El Jezdij ka thënë: "I imponuari ka qëllim të veprojë nga ana e jashtme dhe është vetëm mendja e tij e urtë ajo që e shtyn të veprojë në përmbushjen e detyrimit që ka për të sprapsur të keqen me të cilën kërcënohet dhe të pranojë atë që ka më pak dëm."

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "I imponuari përzgjedh punën me pavarësinë e mendjes për detyrimin që ka për të sprapsur dëmin dhe vë në peshore dëmin më të vogël mes dy dëmeve."

Nuk është e detyrueshme që i imponuari të ketë qëllim shitjen dhe të bëjë nijet kalimin e mallit prej pronësisë së tij, por ai mund të thotë me fjalë ofertën për shitjen, pa pasur qëllim efektet e shitjes. Në këtë gjendje, kjo shitje është e pavlefshme, për shkak të mungesës së qëllimit, por jo për shkak të imponimit. Sikur të supozohet se ai ka qëllim shitjen dhe pronësinë, qëllimi i tij është pa vlerë e pa asnjë efekt, përderisa ajo kontratë është ndërtuar prej imponimit. Me një fjalë, imponimi është i varur prej vlerësuesit, kurse qëllimi nuk vlerësohet, prandaj, në vetvete, nuk mund të ketë imponim mbi qëllimin, pasi imponimi, në të vërtetë, bie mbi vetë punën. Megjithëkëtë, sikur puna e imponuar të ndodhë me qëllim, efekti i saj nuk ndodh, kur qëllimi përputhet me qëllimin e mizorit imponues.

Pranimi i Islamit prej të frikësuarit

Pyetje: Është vërtetuar se i Dërguari më i madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Jam urdhëruar të luftoj njerëzit, derisa ata të thonë* ***Là ilàhe il'lall'llàh*** *(S'ka zot tjetër përveç Allahut), të pranojnë Islamin dhe të shqiptojnë me fjalën e vet dy dëshmitë nga frika e shpatës. Atëherë unë i trajtoj ata siç trajtohen myslimanët."*

Bazuar mbi këtë hadith, duhet të jetë e vlefshme edhe marrëdhënia e ndërsjellë e imponuar, madje vlefshmëria e kësaj marrëdhënieje del në plan të parë, sepse baza është Islami, kurse veprimet e ndërsjella janë degë.

Përgjigje: Efektet e Islamit janë si injektimi i gjakut dhe i pasurive, domethënë martesa e trashëgimia, efekte që sistemohen vetëm nga ana e formës, kështu që përqafimi i Islamit është thjesht shqiptimi i dy dëshmive, por nuk është Islami real, pasi kërkesa është dorëzimi para çdo motivi qoftë. Ai që ndjek historinë e Islamit dhe të Profetit të nderuar të Islamit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të shikojë se ky kapitull është shumë më i gjerë se kapitulli i kontratave e i penalitetve, prandaj qëllimi më i lartë me këtë hadith, është jo vetëm dëshira për të përhapur fjalën **Là ilàhe il'lall'llàh, Muham'medun resùlull'llàh,** por edhe shpalljen e kësaj fjale në çdo vend e për çdo brez.

I detyruari nga nevoja

Le të marrim shembull një njeri që është i detyruar nga nevoja të shesë shtëpinë, megjithëse ai ka shumë nevojë ta ketë

shtëpinë e vet, pra, ai e bën këtë shitje nga domosdoshmëria për plotësuar një detyrim të ngutshëm e me rëndësi akoma më të madhe, si për shembull, shlyerja e borxhit në afatin e caktuar, shpenzimi për të ushqyer njerëzit e familjes, shpenzime për mjekim e të tjera shpenzime që diktohen në kushte specifike. Atëherë, kur puna qëndron kështu siç u shpjegua, shitja bëhet dhe është e vlefshme.

Ti mund të thuash: I detyruari nga nevoja është plotësisht si i imponuari, pasi që të dy e bëjnë shitjen për të sprapsur një dëm më të rëndë. Atëherë si është e mundur që shitja e të detyruarit nga nevoja është e vlefshme, kurse shitja e të imponuarit nuk është e vlefshme?

Përgjigje: Kësaj pyetje do t'i japim përgjigje sipas dy këndvështrimeve.

Këndvështrimi i parë: Patjetër që i detyruari nga nevoja dhe i imponuari e bëjnë shitjen të shtyrë nga nevoja për të sprapsur një dëm akoma më të rëndë, por dallimi qëndron në faktin se të detyruarin nga nevoja e kanë shtyrë kushtet e tij specifike që të bëjë shitjen dhe në këtë detyrim, nuk gjendet vullneti i mizorit, kurse i imponuari është në kushte të mira, mbase ai mund të mos ketë fare nevojë ta shesë shtëpinë, por atë e çoi në shitjen e shtëpisë vetëm presioni e imponimi nga ana e mizorit. Për këtë shkak, shitja është e vlefshme për të parin dhe nuk është e vlefshme për të dytin. Me fjalë të tjera, shitjen e prish imponimi dhe jo thjesht veprimi për shkak të imponimit.

Këndvështrimi i dytë: Dispozitat e legjislacionit islam kanë parasysh lehtësimin e gjendjes së njeriut dhe mos vënien e tij në vështirësi e në ngushticë. Sikur ne të shprehemi për prishjen e

shitjes nga ana e tij që është i detyruar nga nevoja, atij do t'i duhej të qëndronte në kushte akoma më të ngushta e shumë të vështira nga ato në të cilat u ndodh, por kjo është në kundërshtim me qëllimet humane të legjislacionit islam. Në këtë këndvështrim, ashtu siç ka thënë Sej'jid El Jezdij, që shitja nga ana e të detyruarit nga nevoja është e ngjashme me veprimin e një personi i cili, për të ruajtur jetën e tij, zgjedh të presë njërën prej gjymtyrëve të veta.

Siç shihet, shitja e detyruar nga nevoja është e kundërta e shitjes së imponuar prej mizorit. Në rastin e shitjes së imponuar, bëhet detyrë të shprehemi për pavlefshmërinë e shitjes nga ana e të imponuarit, pasi me këtë pohim shpjegohet padrejtësia e mizorit dhe pohimi i padrejtësisë nga ana e vetë mizorit. Shkurtimisht mund të thuhet se interesi i të detyruarit nga nevoja dhe interesi i të imponuarit, si dhe ruajtja e lirisë dhe e dinjitetit të këtyre të dyve, e bën të detyrueshme vlefshmërinë e veprimit të të detyruarit nga nevoja, por jo veprimin e të imponuarit.

Këndvështrimi i tretë: Tradicionalistët bëjnë dallim mes të detyruarit nga nevoja dhe mes të imponuarit dhe janë të mendimit për vlefshmërinë e shitjes nga ana e të parit dhe për pavlefshmërinë e shitjes nga ana e të dytit. Vlen të theksohet se i detyruari nga nevoja dhe i imponuari kanë të përbashkët heqjen e dispozitës obliguese për detyrim e për ndalim.

Le të marrim një shembull: Ai që detyrohet nga nevoja të hajë mish cofëtinash për të ruajtur jetën, nuk ndëshkohet në asnjë gjë dhe është plotësisht si i imponuari, sepse shkaku për heqjen e obligimit dhe të dënimit është sprapsja e dëmit të sigurt që i vjen atij prej imponimit dhe prej detyrimit nga nevoja.

I imponuari dhe i detyruari nga nevoja kanë dallim edhe në dispozitën e ligjeve civile, siç është vlefshmëria dhe prishja, kur ne gjykojmë për vlefshmërinë e veprimit nga ana e personit të detyruar nga nevoja, por jo për të imponuarin. Sekreti në këtë gjykim qëndron në faktin se imponimi heq obligimin së bashku me gjendjen në të cilën është i imponuari, që do të thotë se imponimi nuk heq vetëm obligimin. E njëjta gjendje është edhe për të detyruarin nga nevoja.

Kuptimi i imponimit

Ligjvënësi nuk ka përcaktuar kuptimin e imponimit, prandaj jemi të detyruar t'i referohemi traditës, në rastet kur shitja bëhet për shkak të frikës nga dëmtimi i vetvetes, i pasurisë dhe i nderit. Disa fukaha janë shprehur se frika ndryshon sipas personave dhe pozitës së tyre shoqërore, me përjashtim të frikës për jetën, pasi kërcënimi mund të jetë me sharje, e cila, për një person, mund të jetë dëmtim, kurse në raport me një person tjetër, kërcënimi me sharje, s'mund të ketë asnjë rëndësi. Prandaj, në radhë të parë, të përcaktohet lloji i imponimit mbi të cilin bazohet veprimi, në atë mënyrë që, sikur të mos ishte imponimi, shitja nuk do të kryhej. Kjo është e barabartë, qoftë kur frikësuesi është i madh, ose është njeri i urryer, qoftë kur kërcënimi është për sharje, qoftë kur është për rrahje.

Imponimi me të drejtë

Prej imponimit, fukahatë kanë veçuar imponimin e ardhur prej drejtësisë, siç është imponimi nga ana e sundimtarit mbi akaparuesin për shitjen e ushqimeve në kohë zije, shitjen e pasurisë për të qëndruar në besën e dhënë për shlyerjen e borxhit, ose për të ushqyer njerëzit e familjes, ose shitjen e kafshës, kur pronari i asaj kafshe s'ka mundësi të shpenzojë për ushqimin e kafshës, ose për divorcin e gruas për një shkak të justifikueshëm, përfshirë edhe imponime të tjera për të cilat ka urdhëruar Allahu i Lartësuar.

Lejimi nga ana e të imponuarit

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Thënia më në zë midis fukahave të sotëm është se, kur i imponuari, pas imponimit, është dakord me veprimin e kryer prej tij, kontrata është e vlefshme, madje kanë cituar se kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, që do të thotë se pas këtij miratimi tani ajo është kontratë e vërtetë me të gjitha efektet e saj."

Ndodh kështu për faktin se pengesë për mosvlefshmërinë e kontratës ishin imponimi dhe mosmiratimi, por, kur imponimi hiqet dhe miratimi për kontratën e lidhur është, atëherë kjo kontratë është si të gjitha kontratat e vlefshme për të cilat është detyrë të qëndrohet në besën e dhënë për plotësimin e saj. Për sa i përket lidhjes së kontratës pa imponimin, për këtë nuk ka argument kundër, prandaj është i mjaftueshëm vetëm miratimi paraprak ose edhe i vonuar.

Me fjalë të tjera, kontrata është ekzistuese, por ajo është e shoqëruar me ekzistencën e penguesit për zbatimin e saj dhe, kur penguesi u hoq, që në këtë rast ishte imponimi, atëherë kontrata ka efektet e saj.

Nuk merret në konsideratë miratimi i atij që tallet, të shkujdesurit, atij që është në gjumë dhe të ngjashëm me këta, për shkak të mosorientimit në efektet e kontratës, në kohën që ajo shqiptohet me fjalë. Në të vërtetë, ai që është në gjumë, i dehuri, atij që i ka rënë të fikët dhe ka humbur vetëdijen nga të rënit të fikët, këta s'kanë fare mundësi të shqiptojnë frazën e shitjes. Kur i imponuari jep miratimin e tij pas lidhjes së kontratës, a zbulon ky miratim, nga ana tij, sistemimin e efekteve të kontratës që prej kohës së ndërtimit të kontratës, ose e transferimit të pronësisë në kohën e miratimit? Mbi të parin rëndon rritja mesatare mes kontratës dhe miratimit për pranuesin dhe i dyti është për propozuesin e ofertës.

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Sipas argumenteve të cituara, më i fuqishëm është zbulimi dhe jo transferimi."

Këtë do ta trajtojmë, kur të sqarojmë çështjen e ekspozimit të një pasurie që nuk e ke.

Imponim për shuma parash

Kur mizori i kërkon një personi një shumë parash, po ai s'ka asgjë që t'i japë mizorit, detyrohet të shesë shtëpinë e vet që të paguajë padrejtësinë për të shpëtuar jetën e tij, shtrohet pyetja: Kjo shitje që bëhet, a është e vlefshme apo është e pavlefshme?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, patjetër duhet të jepen disa sqarime: Kur qëllimi i mizorit, që në fillim ishte i qartë se kërkesa e tij do të detyronte të dhunuarin që të shiste shtëpinë, pra, kërkesa për para erdhi si mjet për këtë qëllim, për faktin se mizori e dinte mirë se i dhunuari nuk kishte mundësi të paguante, pa bërë shitjen. Nëse puna qëndron kështu siç u përshkrua, shitja është e prishur, sepse imponimi, së pari, i është drejtuar pikërisht shitjes.

Nëse mizori s'ka pasur qëllim tjetër përveç marrjes së parave me çdo mjet që të ishte e mundur, fukahatë kanë thënë se shitja është e vlefshme, sepse imponimi është i varur me pagimin e parave dhe jo me vetë shitjen.

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Kush imponohet për të paguar një shumë parash dhe për këtë ai shet një pjesë të pasurisë së tij, në realitet, kjo shitje është e vlefshme, sepse ai e bën shitjen për të sprapsur dëmin që e kërcënon, megjithëkëtë ai nuk është i imponuar."

Në të vërtetë, shitja është e vlefshme, kur i dhunuari ka mundësi të paguajë shumën e kërkuar prej tij, pa shitur asgjë prej pasurisë së vet, madje qoftë edhe duke marrë borxh që të paguajë shumën që i kërkohet. Gjithsesi, i dhunuari ka preferuar shitjen, e cila është e pavlefshme, kur pagesa bëhet vetëm me shitjen, sidomos kur ai e shet për shkak të kërcënimit të mizorit, sepse vetë veprimi i shitjes në këtë gjendje, është imponim i mirëfilltë, pasi sikur të mos ishte mizori, shitja nuk do të ndodhte.

Përcaktimi i pronarit

Fukahatë e Medh'hebit Xhaferij, gjatë diskutimeve rreth qëllimit, janë ballafaquar me dy çështje të rëndësishme:

1- I vlerësuari (malli) dhe çmimi, herë janë të prekshëm dhe ekzistojnë nga jashtë, si: shtëpia, kopshti e të tjera si këto, për të cilat shitësi thotë: "Këtë shtëpi ta shita ty për këtë kopsht.", herë tjetër malli nuk ekziston nga jashtë dhe tërësisht është në mirëbesim, si për shembull, kur shitësi thotë: "Të shita ty një ton grurë për një mijë lira." Një shprehje e këtillë e shitjes është e vlefshme, edhe sikur shitësi të mos ketë as edhe një kokërr grurë të vetme dhe blerësi, në kohën e shitjes, s'ka asnjë lirë.

Nëse dy mallrat e kompensueshëm gjenden nga jashtë, nuk merret në konsideratë se kush i ka ato që të bëjë përcaktimin e tyre, por mjafton qëllimi me dy mallrat e kompensueshëm që, faktikisht, gjenden para syve dhe kështu ato janë vetë qëllimi. Ky është qëllimi i përgjithshëm për atë që ka pasuri. Thënë ndryshe, në të vërtetë, qëllimi i shitjes dhe i të gjitha kompensimeve monetare është shkëmbimi mall me mall, por ky shkëmbim i ndërsjellë kërkon njohjen e dy mallrave dhe jo njohjen e dy pronarëve të atyre mallrave.

Shejhu El Ensarij ka thënë: "Kërkesë e kompensimit të ndërsjellë dhe e shkëmbimit të ndërsjellë, është hyrja e çdo njërit prej të kompensueshmëve në pasurinë e tjetrit. Bazuar mbi këtë, qëllimi i mallit të kompensueshëm e përcaktimi i tij nuk ka nevojë për qëllimin e pronarit dhe për përcaktimin e tij."

Kur për mallrat e kompensueshëm plotësohet kushti për lidhjen e kontratës ofertë-pranim, shikohet: nëse kontraktuesi

është origjinal, ose është i lejuar, patjetër që marrëdhënia e ndërsjellë duhet të qëndrojë mbi një gjë, qoftë ajo gjë edhe ekspozim i një pasurie që nuk e ka, por patjetër kërkon lejim që ajo të ekzekutohet.

Në qoftë se mallrat e kompensueshëm janë në mirëbesim dhe nuk janë të ekspozuar nga jashtë, patjetër duhet të përcaktohet pronari, ndryshe nuk mund të lidhet kërkesa e një personi të papërcaktuar, sepse mirëbesimi, nga njëra anë, nuk mund të shërbejë si subjekt për të kompensuar pa qenë përcaktimi e përshkrimi i pronarit, sepse mirëbesimi merret në konsideratë, por nuk mund të ekzistojë pa ekzistuar pronari i mallit. Kur malli nuk ekziston si njësi e pavarur, atëherë si është e mundur që me këtë mall të jetë i lidhur sendi që ekziston?

Sej'jid El Hakijm, në librin "Nehxhul Fukàhah", ka thënë: "Kur dy mallrat e shkëmbyeshëm nuk janë jashtë, qëllimi konsiderohet për atë që ka kontratën, sepse mirëbesimet nuk vlejnë të jenë subjekt për kompensime të ndërsjella, pa u shtuar atyre një mirëbesim të përcaktuar."

Identiteti i kontraktuesit

2 – A ka efekt për identitetin e kontraktuesit në detyrimin për plotësimin e kontratës, për shembull, kur ndodh një veprim i ndërsjellë me një person, duke besuar se ai është Zejdi, por më pas bëhet e qartë se ai është Amri. A ka të drejtë i ngjashmi ta anulojë kontratën?

Fukahatë kanë thënë se dispozita për këtë çështje ndryshon sipas ndryshimit të dëshirave. Nëse qëllimi me kontratën është i njëjti send për të cilin është kontraktuar dhe ndodh shkëmbimi i dy mallrave të kompensueshëm, pavarësisht nga identiteti i kontraktuesit dhe pavarësisht nëse ai është origjinal ose i prokuruar, ose ekspozon mall që nuk e ka, bashkëpunimi i ndërsjellë bëhet i detyrueshëm dhe asnjëri prej dy kontraktuesve nuk ka të drejtë të kthejë e të prishë kontratën, veçse me kushtin e përcaktimit. Nëse qëllimi me kontratën është i njëjti kontraktues dhe jo ai për të cilin është lidhur kontrata, si për shembull, akti i martesës, akti i dhurimit, testamenti, akti i lënies vakëf dhe lëshimi i prokurës, mbetet detyrim që të dy kontraktuesit të njohin njëri-tjetrin, në atë mënyrë që, kur lind konflikt, për palën tjetër vërtetohet e drejta e prishjes së kontratës.

Sej'jid El Jezdij, në margjinaturën e librit "El Mekàsib", është shprehur: "Është detyrim përcaktimi i secilës palë dhe njohja me palën tjetër, kur ai është kolonë në këtë bashkëpunim të ndërsjellë, në atë mënyrë që dëshirat, në një farë mënyre, ndryshojnë me ndryshimin e tij, ashtu siç është për martesën, ku çifti është në pozitën e dy mallrave të kompensueshëm dhe ku qëllimet ndryshojnë me ndryshimin e atyre të dyve. E njëjta gjë është edhe për sendin e lënë vakëf, në të cilin qëllimi është i varur me sendin e lënë vakëf, por jo për atë që ndodh. E njëjta gjë është edhe për dhurimin, kur dhuruesi e ndryshon qëllimin e tij për dhurimin e pasurisë së tij, në raport me personat. E njëjta gjë është edhe për lëshimin e prokurës e për punë të ngjashme me prokurën, por nuk është kështu me shitjen, pasi në shitje është kërkesë elementare ekzistenca e dy mallrave të kompensueshëm, për të cilat, në shumicën e rasteve, qëllimi nuk ka lidhje me

pronarin, prandaj edhe përcaktimi i tij nuk është i detyrueshëm dhe pasohet me moskushtëzimin nga ana e tij, prandaj nuk është detyrë as prishja e kontratës e as shpalosja e ndonjë alternative tjetër për kontratën."

Në përgjithësi, kuptimi që kanë qëllim fjalët e fukahave, edhe pse mjaft të gjata, në lidhje me këtë çështje, reduktohet vetëm në shprehjen vijuese: Nëse personi bashkëbisedues, propozues e konsideron propozimin mjet dhe jo qëllim, atëherë propozuesi ka të drejtë të shtrojë alternativë e të prishë kontratën, nëse bëhet e qartë e kundërta e qëllimit, ashtu siç është gjendja në kontratat e shitblerjeve dhe në kontratat e tjera, në të cilat nuk ka qëllim tjetër përveç shkëmbimit të mallrave të kompensueshëm.

Në radhë të parë, qëndron kontrata me të cilën shprehet vetëm qëllimi i ndodhjes së veprimit prej cilitdo qoftë, siç është vënia e një çmimi të përcaktuar për atë që sjell sendin e humbur prej dikujt, ashtu siç ishte edhe stimulimi nga ana e Imamit, kur tha: *"Ai që vret filanin, ka kaq dhe ai që i jep jetë një toke të vdekur, ajo tokë është e tij."*

Si bazë, personi i angazhuar është i panjohur (i paindetifikuar), megjithëkëtë fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët në lidhje me vlefshmërinë e angazhimit.

Në qoftë se personi bashkëbisedues e ka konsideruar qëllim dhe jo mjet, për atë vërtetohet e drejta e prishjes së kontratës, kur për të bëhet e qartë se ai nuk është personi për të cilin kishte qëllim, siç është çështja për martesën, për lënien vakëf, për testamentin, për dhurimin e për lëshimin e prokurës.

Bisedimi me mbajtësin e prokurës

Kur propozuesi e di se pranuesi është i prokuruar, a është e vlefshme që ai t'i drejtohet atij dhe t'i thotë atij: "Të martova.", "Ta shita.", apo ai duhet t'i thotë atij: "Martova prokurlëshuesin tënd", ose "I shita prokurlëshuesit tënd."?

Shumica e fukahave kanë thënë se duhet të bëhet sqarim mes kontratës në të cilën kontraktuesi konsiderohet mjet dhe jo qëllim, siç është kontrata e shitjes, ose kontrata e qerasë dhe mes asaj kontrate në të cilën kontraktuesi konsiderohet kolonë e qëllim dhe mjet, siç është martesa.

Në të parën, është e vlefshme t'i thuhet drejtpërdrejt të prokuruarit me fjalë origjinale, por nuk është e vlefshme t'i flitet të dytit me të njëjtat fjalë. Për shembull, ai i thotë të prokuruarit: "Ta shita ty ose atij që të ka lëshuar ty prokurën." dhe nuk i thotë atij: "Të martova ty.", pasi është detyrë t'i thotë: "Martova atë që ka lëshuar prokurën për ty."

Në margjinaturën e librit "El Mekàsib", Sej'jid El Jezdij ka thënë: "Vërtetim i lejimit në gjithçka, krahas krahasimit, për shkak të mospasjes ndalues në të këtilla përdorime."

Kjo është e vërteta, sepse "këshilla merret, kur qëllimi bëhet i qartë", por qëllimi mësohet prej fjalëve dhe jo me fjalë të thëna si të dalin prej goje. Bazuar mbi këtë sentencë, është e vlefshme t'i thuhet të prokuruarit: "Të martova ty.", kur dihet qartë se qëllimi është lëshuesi i prokurës dhe jo i prokuruari.

Gjuhëtarët kanë pohuar se atashimi është i vlefshëm për veshjen më të ulët, ashtu siç është pozita jote dhe prej këtu edhe

rruga jote, për ata që duan vendin e merituar me bashkëbisedimin e drejtpërdrejtë, si dhe rrugën që çon në shtëpinë e tij ose në vendin e tij.

I prokuruari dhe dispozita e kontratës

Kontratën, dispozita me efekte të veçanta që sistemohen mbi kontratën me lejen e Allahut, do t'i përmendim, pasi të përfundojmë me kushtet e dy kontraktuesve dhe me kushtet e sendit për të cilin lidhet kontrata. Prej këtyre dispozitave është e drejta që ka shitësi të kërkojë prej blerësit çmimin, është e drejta që ka blerësi të kërkojë prej shitësit sendin për të cilin është dhënë çmimi. Prej dispozitave është edhe e drejta e secilit prej këtyre të dyve për t'i kthyer sendin tjetrit, kur konstatohet ndonjë defekt ose e metë në sendin e kompensueshëm që kaloi në pronësi të tij.

Në këtë paragraf, objekti i bisedës do të jetë rasti kur ai shet ose ble për një tjetër dhe jo për vete, sikur të ishte i prokuruar, atëherë a ka të drejtë pala tjetër që lidh kontratë, të kërkojë prej të prokuruarit që ai të veprojë sipas dispozitave të kontratës e të efekteve të saj, ose këtë ia kërkon lëshuesit të prokurës, apo ai ka të drejtën e kthimit për cilin të dëshirojë prej atyre të dyve, natyrisht nëse dëshiron të kthejë?

Le të marrim një shembull: Zejdi me Amrin ka kryer një marrëdhënie për shtëpinë e tij, por Amri e ka blerë shtëpinë për prokurëlëshuesin e tij, Halidin. Në këtë rast, kush është përgjegjës për çmimin, Amri, Halidi apo të dy? Sikur çështja të ishte e kundërta dhe ne të supozojmë se Zejdi e ka shitur shtëpinë me prokurë për një tjetër, kurse Amri e ka blerë atë për veten e tij, por

më pas në shtëpi konstatohet një e metë, në këtë rast Amri duhet t'ia kthejë të prokuruarit apo prokurëlëshuesit?

Përgjigje: Fukahatë, pa përjashtim, ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur i prokuruari nuk ka tagër të kryejë blerje e shitje, por ka prokurë thjesht të shqiptojë formulën e lidhjes së kontratës dhe vetëm për marrëdhënie formale, kur çështja qëndron kështu siç u përshkrua, i prokuruari s'ka të drejtë të kthejë për asnjë send. Në këtë rast, ai është i ngjashëm me të huajin, ose është i ngjashëm me një mjet me të cilin ndodh e del formula.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre për rastin kur ai është i prokuruar për vetë marrëdhënien dhe jo për formulën. Thënia më e saktë është ajo që ka thënë shejkhu En Nàijnij në librin "Et Takrijràtul Khauànsàrij" dhe që konsiston: Kur pala tjetër e di se pala që zhvilloi me atë marrëdhënien, është i prokuruar dhe nuk është origjinali, atëherë përgjegjës është vetëm prokurëlëshuesi dhe jo i prokuruari. Në qoftë se ai nuk e di se personi me të cilin kryen marrëdhënien e shitblerjes, është i prokuruar dhe nuk është origjinali, atëherë ai është në mëdyshje ndërmjet kthimit në dëm të prokurlëshuesit, sepse, në realitet, kontrata është për atë, si dhe mes kthimit në dëm të të prokuruarit, sepse padyshim ai e ka ndërtuar kontratën, duke filluar me propozimin së bashku me të prokuruarin.

Shejkhu En Nàijnij ka thënë: "Sikur ai të dijë se ai është i prokuruar, atëherë pa asnjë dyshim propozuesi është prokurlëshuesi, sepse biseda e drejtpërdrejtë, edhe pse i është drejtuar të prokuruarit, në të vërtetë, nuk i është drejtuar atij për shkak se ai është zëvendës për prokurlëshuesin e tij. Kjo do të

thotë se, kur mësohet që kemi të bëjmë me prokurim, detyrimet e kontratës janë mbi prokurlëshuesin, por, nëse nuk dihet që kontrata është me prokurë, atëherë propozuesi është i prokuruari, sepse, duke mos pasur dijeni për prokurimin, ai i bën angazhimet e qarta, si dhe ato që merren me mend së bashku me të prokuruarin, i cili mbase edhe mund të këtë njohuri për prokurën për të cilën ka ndodhur marrëdhënia e ndërsjellë së bashku me prokurlëshuesin, sepse njerëzit, në varësi nga gjendja: e lehtë, e vështirë, gjendje ekonomike e shtrënguar, ose gjendje ekonomike e gjerë, apo edhe ecin përkrah njëri-tjetrit, nga pikëpamja e durimit dhe nga e drejta e secilit, janë të ndryshëm.

* * *

RREGULLI I SHPREHJES SË QËLLIMIT

Rregull

Fukahatë e kanë bërë zakon të përmendin në fundin e kapitullit të shitjes një kapitull tjetër me titull: "Çfarë hyn në shitje?", ku kanë shpalosur argumentin për kuptimin e fjalës për sendin, i cili, në shumicën e rasteve, shitej e blihej në kohën e tyre më shumë se sendet e tjera të palëvizshme, si: shtëpia, toka, kopshti, etj. Gjithashtu, ata caktuan edhe rregullin me të cilin është detyrë të bëhet heqja dorë prej kontratës, në rast dyshimi te ndonjëri prej dy kontraktuesve, përfshirë çdo gjë që hyn në fjalën shitje, ose që del prej fjalës shitje. Ky është njëri prej studimeve të rëndësishme, sepse ka lidhje me shpjegimin e kontratës dhe me vullnetin e përbashkët të dy kontraktuesve. Ky është edhe shkaku që ne pëlqyem ta emërtojmë këtë kapitull "Rregulli i shprehjes së qëllimit" dhe jo atë çka hyn e çka del në shitje, ashtu siç kanë vepruar fukahatë.

Gjithashtu, ne pëlqyem që këtë kapitull ta përmendim këtu dhe jo në fundin e kapitullit të shitjes, ashtu siç kanë vepruar

fukahatë, sepse kështu çështja është më korrekte në renditjen e kapitujve. Përveç kësaj, vënia e këtij kapitulli në fundin e kapitullit të shitjes, do të linte vend për shumë përngjasime, pasi fukahatë kanë menduar se çështja konsiston vetëm në shpjegimin e fjalës "tokë" dhe "kopsht", madje edhe fjalët e kontratës janë të ndara nga njëra-tjetra, pa lidhje e pa integrim mes tyre.

Pavarësisht nga kjo që u tha, në shkencën e bazave të ligjit të fesë, fukahatë kanë thënë se çdo fjalë që ka ardhur në thëniet e ligjvënësit, mban atë që ka mësuar vullneti i tij prej asaj fjale. Kjo është e barabartë, qoftë kur kuptimi është ligjor, ose tradicional i mirëfilltë, qoftë kur është metaforë.

Nëse prej kuptimit të fjalës nuk mësohet se ç'qëllim ka pasur ligjvënësi për të vërtetën ligjore, nëse ajo ekziston, ndryshe do të qëndrojmë mbi atë çka ishte e njohur në kohën e tyre dhe, nëse nuk dihej, atëherë do të bazohemi mbi kuptimin zotërues që kishte shprehja e qëllimit në mendjet e njerëzve të asaj kohe. Por nëse edhe kjo nuk ekziston, atëherë mbështetemi mbi kuptimin gjuhësor të fjalës dhe, nëse janë disa kuptime, kuptimi do të anojë kah kuptimi më konciz i fjalës dhe, më tej, ndodhia do të hyjë në dispozitën e çështjeve për të cilat nuk ka tekst prej ligjvënësit.

Disa fukaha e kanë zbatuar këtë rregull në fjalët e dy kontraktuesve dhe kanë thënë se fjala e atyre të dyve mbartet mbi kuptimin ligjor, pastaj mbi atë tradicional dhe pastaj mbi atë gjuhësor. Ky përngjasim mes fjalëve të ligjvënësit e të fjalëve të njerëzve, është tepër larg asaj që ne themi. Këtu qëndron edhe arsyeja që autori i librit "El-Xhevahir", e ka komentuar këtë thënie me fjalën e tij: "Kjo është prej fjalëve të habitshme, sepse kontrata ndjek qëllimin. Nëse dihet qëllimi i dy kontraktuesve, punohet me

kontratën, ndryshe fjala mbartet sipas kuptimit që ka në traditën e zakonshme të njerëzve, madje edhe sikur të jetë në kundërshtim me të vërtetën ligjore. Po, mund të thuhet që kuptimi ligjor duhet të ketë përparësi ndaj atij të traditës, në rastin e hyrjes së frutave të hurmës në pronësi të blerësit para polenizimit."

Kjo çështje nuk është objekt i studimit tonë, sepse studimi ka të bëjë me gjërat që hyjnë në këtë studim, ashtu siç është përshkruar, pavarësisht nga ato që thuhen në ndonjë tekst në lidhje me një gjendje të veçantë, por ai tekst nuk mund të mbartet në çështje të tjera.

Gjëja më e mirë që kam lexuar, në lidhje me këtë çështje, është fjala që ka thënë autori i librit "Miftàhul Keràmeh", në kapitullin: "Shitoret", në faqen 669: "Më korrekte do të ishte që, për çështjen, të thuhej: Subjekti është i bazuar në atë për të cilën kanë dijeni shitësi e blerësi, sepse shitësi nuk shet gjë tjetër përveç asaj që ka qëllim të shesë. Gjithashtu, edhe blerësi nuk ble gjë tjetër përveç sendit që dëshiron të blejë, prandaj qëllimi nuk është që ata të dy të thonë fjalë të tjera përveç asaj që ata dinë. Kështu kontrata vazhdon të jetë e ndërtuar mbi shprehjet e atyre të dyve. Sikur kjo të ishte larg traditës së ligjvënësit, ose larg traditës së njerëzve të zakonshëm, ose larg kuptimit gjuhësor, për të vlerësuar se një send prej këtyre që u tha është në kundërshtim me traditën, që te ata të dy të lindte dyshimi, patjetër që kontrata do të ishte pa vlerë, për shkak të mosnjohjes së sendit të vënë për shitje në kohën e ndërtimit të kontratës. Po, kur ata të dy, për shembull, dinë terminologjinë e ligjvënësit dhe bazuar mbi këtë njohje e nënshkruajnë kontratën, atëherë kjo do të ishte pikë referimi, jo se ka përparësi terminologjia e përdorur prej të dy kontraktuesve, por sepse ajo shpreh qëllimin e atyre të dyve dhe

është plotësisht sikur ata të dy të kishin nënshkruar kontratën me terminologjinë e njerëzve të tjerë. E njëjta gjë është edhe kur ata të dy e nënshkruajnë kontratën, bazuar mbi terminologjinë e traditës së përgjithshme, kur ajo është në kundërshtim me traditën e vendit të tyre. Gjithashtu, çështja është e njëjtë kur qëllimi vlerësohet me anë të kuptimi gjuhësor të fjalës."

"Rregulli pa asnjë pluhur përsipër është referimi në traditën e shitësit e të blerësit, nëse rregulli njihet, ndryshe referimi do të jetë në traditën e përgjithshme. Por nëse as kjo e fundit nuk njihet, atëherë referim do të jetë kuptimi gjuhësor i fjalës."

Në vijim do të përmendim disa prej fjalëve të shitblerjes, të cilat i kanë trajtuar fukahatë si shembuj për të ilustruar këtë rregull.

Toka

Nëse mbi tokë gjendet një ndërtesë, ose pemë, ose të mbjella dhe pronari e shet këtë tokë, ku kontrata është lidhur me fjalën "tokë", ashtu siç është i njohur kuptimi i fjalës "tokë" prej të dyja palëve dhe nuk është përmendur asgjë nga sendet që janë mbi atë tokë, atëherë shtrohet pyetja: A hyn në këtë shitje ndërtesa, pema dhe të mbjellat mbi tokën e vënë për shitje? Nëse supozojmë se nuk hyjnë, atëherë, a ka të drejtë blerësi të zgjedhë mes prishjes së kontratës ose nënshkrimit falas?

Fukahatë kanë thënë se asgjë nga këto nuk hyn në fjalën "tokë", përveçse kur është e shoqëruar me një argument të qartë, si për shembull, kur shitësi thotë: "Ta kam shitur këtë tokë me të

gjitha sa ka në të." ose thotë: "Me të gjitha sa janë brenda murit të saj.", kur toka është e rrethuar me mur. Patjetër që te toka hyjnë shkëmbinjtë e gurët e krijuar nga natyra e tokës.

Blerësi nuk ka të drejtën e përzgjedhjes, kur ai ka dijeni, pasi e drejta e përzgjedhjes mes prishjes ose nënshkrimit falas, është vetëm atëherë kur blerësi nuk ka dijeni për ekzistencën e ndonjërës prej sendeve të lartpërmendura. Gjithashtu, blerësi nuk ka të drejtë as të kërkojë pagesë për këtë, sepse mbetja e objekteve në gjendjen e tyre, është prej kërkesave të kontratës.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pronari i pemës s'ka të drejtë të mbjellë një pemë tjetër në vendin e saj, kur ajo shkulet." Nëse ai e mbjell sërish, pema e rimbjellë i takon pronarit, sepse tani ajo është shtim i pasurisë së tij. Patjetër që blerësi i tokës nuk është i detyruar ta lërë pemën në pronën e tij dhe atij i lejohet ta shkulë atë pemë, sepse kontrata kishte si kërkesë vetëm qëndrimin e pemës mëmë.

Shtëpia

Në fjalën "shtëpi" hyn ndërtesa lart e poshtë, si dhe trualli mbi të cilin ajo është ngritur, përfshirë oborrin para shtëpisë, pusin, rrugën, shkallët, raftet, dyert, çelësat dhe çdo gjë tjetër të ngurosur në të.

Kopshti

Në fjalën "kopsht" hyjnë pemët, toka, muri rrethues i kopshtit, uji, rruga, si dhe çdo gjë tjetër që ka lidhje me kopshtin, pa të cilën nuk mund të përfitohet asgjë prej tij. Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me godinën e përgatitur për banesë, kur ajo gjendet brenda kopshtit. Ka fukaha që kanë thënë se ajo shtëpi hyn në kopsht. Të tjerë kanë thënë se ajo nuk hyn te kopshti. E vërteta është se, në lidhje me këtë çështje, duhet t'i referohemi zakonit, i cili ndryshon sipas vendeve. Nëse në atë kopsht s'ka shtëpi, është e kuptueshme që nuk ka asgjë për të hyrë në fjalën "kopsht", sepse kopshti nuk është as objekt për qëllime të ndryshme e as shtëpi banimi.

Nëse frutat janë në pemë në kohën e shitjes, ato i takojnë shitësit, përveçse kur ka kusht. Në qoftë se pema lidh kokrra pas ndërtimit të kontratës, në mënyrë absolute, futat në pemën e hurmës i takojnë blerësit, ashtu siç janë shprehur fukahatë: "Kush ble pemë hurme para polenizimit, frutat i takojnë shitësit, edhe nëse frutat nuk ishin në kohën e shitjes, me përjashtim të rastit kur është vënë kusht. Por nëse shitësi bën shitjen para polenizimit, atëherë frutat i takojnë blerësit."

Në lidhje me këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka gjykuar se frutat e hurmës i takojnë atij që ka bërë polenizimin, përveç rastit kur shitja është bërë me kusht."*

Sikur kalimi i pronësisë mbi pemën e hurmës të bëhet pa shitje, por si dhuratë, atëherë frutat janë për personin te i cili kaloi pronësia mbi vetë pemën, madje edhe pas polenizimit, duke u

shprehur shkurtimisht për gjithçka që bie në kundërshtim me objektin e tekstit.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në këtë çështje unë nuk gjej asnjë kundërshtim."

Në të vërtetë, për këtë çështje vetëm zakoni është gjykatës, madje edhe për çështjen, nëse hyn ose jo ndërtesa në kopsht, ose për polenizimin e frytit të hurmës, i shpjeguar me tekst, sepse këtu teksti shpreh zakonin që ka ekzistuar për këtë çështje edhe në kohën e të Dërguarit më të madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Në lidhje me këtë çështje, kundrejt tekstit, nuk ka vend për hulumtim nga ana jonë, por ka hulumtim vetëm për nxjerrjen e kuptimit prej tekstit, plotësisht ashtu siç është në lidhje me hulumtimi për qëllimin e fjalës "dora" e Allahut, që është fuqia e të Gjithëpushtetshmit dhe jo organi "dorë" lëndore.

* * *

AI QË SHET PASURINË E TJETRIT *(el fudùlij)*

Është kusht që shitësi të jetë i mençur, të ketë arritur moshën, kur atij i bëhen detyrim obligimet e fesë, të jetë i aftë të vlerësojë, të ketë qëllim shitjen pa imponim, të ketë sendin e venë në shitje, ose të jetë kujdestar, ose të jetë zbatues testamenti, ose të jetë i prokuruar. Më sipër është folur për kushtin e moshës, të mendjes dhe qëllimin e shitjes pa imponim, kurse për kushtin e aftësisë për të vlerësuar e të kujdestarisë do të flitet në kapitullin "Ndalimi për të vepruar me pasurinë e të ndaluarve që të veprojnë me pasurinë e tyre".

Për zbatuesin e testamentit, do të flitet në kapitullin "Testamenti"[1] dhe për të prokuruarin do të flitet në kapitullin "Prokurimi". Në këtë kapitull do të flitet për shitjen e bërë prej atij që shet pasurinë e tjetrit. Thënë ndryshe, prej atij që merret me punë që nuk i takojnë.

[1] Çështjen e testamentit, të kujdestarisë e të mungesës së inteligjencës, sipas pikëpamjes së fukahave të imamive, e kemi trajtuar në librin "El fusùlu Sher'ij'jeh", si dhe në librin "Gjendja civile sipas pesë medh'hebeve", por nuk i kemi trajtuar të shoqëruara me argumente, prandaj, me lejen e Allahut, tani do t'i trajtojmë së bashku me argumentet përkatëse.

Gjithashtu, do të flitet edhe për çështje që kanë lidhje me këtë lloj shitje. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë nxjerrë shumë degë, madje janë zgjatur shumë në degët që kanë nxjerrë e janë futur në hollësi të panumërta, aq sa sikur një jurist i fesë të ndërmerrte numërimin e çështjeve të grumbulluara, ashtu siç është shkruar në librin "El Mekasib" të shejkhut El Ensarij, si dhe në margjinaturat (hàshijet) e shkruara për këtë libër, si dhe në çdo gjë që ka lidhje me këtë libër, për të cilat fukahatë kanë nxjerrë nënçështje të shumta dhe janë zgjatur shumë në nxjerrjen e nëndegëve e të hollësive, me siguri që ato do të arrinin në dhjetëra, prandaj për shumicën e këtyre çështjeve, veçanërisht për ato më të rëndësishmet, do të flitet në mënyrë të përmbledhur në paragrafët e vijues.

Kuptimi i fjalës "el fudùlij"

Sipas rregullit që kanë adaptuar fukahatë islamë për trajtimin e kuptimit të termave edhe nga ana gjuhësore, rezulton se fjala *"el fudùlij"* është marrë prej fjalës "fudùl"-"shtesa", "teprica", etj, që është shumësi i fjalës *"fadl"*-"shtim", "tepricë", etj., por që përdoret në formën e njëjësit, sepse i atashohet personit konkret, i cili është njëjës dhe jo shumës.

Fjala *"el fudùlij"* do të thotë "person që merret me punët që nuk i takojnë". Ky është kuptimi bazë i kësaj fjalë në terminologjinë e fukahave, të cilët, me këtë fjalë, kanë qëllim "njeriun normal që vepron me një send, pa qenë pronë e tij".

Me fjalën "njeri normal", fukahatë kanë qëllim që *"efdùlij"* është i mençur dhe ka arritur moshën në të cilën njeriut normal i

bëhen detyrim obligimet e fesë, sepse të çmendurit dhe të miturit nuk i lejohet të veprojnë për llogari të vetes dhe, në mënyrë absolute, nuk i lejohet të veprojnë për llogari të një tjetri. Shejkhu El Ensarij ka thënë: "*El fudùlij* konsiderohet njeriu normal dhe si kontraktues ka aftësinë për të kontraktuar, pra, është në moshë madhore dhe i mençur. Gjithashtu, sendi i vënë në shitje të jetë prej sendeve që shiten. Në këto kushte, kontrata nuk humb asgjë nga vlera e saj, përveç rastit kur ajo nuk ka lejimin nga ana e pronarit të sendit."

Le të sjellim një shembull për të ilustruar këtë çështje: Një i mençur në moshë madhore shet pasurinë e një tjetri, pa lejen e pronarit, ose pa lejen e kujdestarit të personit që ka sendin në pronësi, ose pa lejen e të prokuruarit prej pronarit të asaj pasurie, ose pa lejen e zbatuesit të testamentit të lëshuar prej pronarit të atij sendi; ose rastin, kur personi shet pasurinë e vet, për të cilën nuk ka të drejtë të veprojë me atë pasuri, sepse ajo është lënë peng, ose ajo pasuri është e ngurosur për llogari të një të çmenduri, ose është pasuri e shpallur e falimentuar, ose kur penglënësi shet sendin që ka lënë peng, atëherë ekzekutimi i shitjes ndalohet prej pengpranuesit. Kështu qëndron çështja edhe për të çmendurin, veprimet pasurore të të cilit ekzekutohen vetëm me lejen e kujdestarit të tij ligjor.

E njëjtë me rastin e të çmendurit është edhe rasti për të falimentuarin, pasuria e të cilit është ngurtësuar për llogari të kreditorëve. Po kështu qëndron çështja edhe për të sëmurin që do të vdesë prej kësaj sëmundjeje, kur ky i sëmurë le për bamirësi më shumë se një të tretën e pasurisë së vet.

Nijeti në shitjen e mallit të tjetrit pa lejen e pronarit

Nuk është kusht që *el fuduliji* të veprojë me nijet për interesin e dikujt, sepse ai çdo punë e ndërmerr vetëm për interesin e tij personal. Edhe kur më pas bëhet e qartë se puna e tij është për interesin e një tjetri, përsëri ai është *el fudulij*. Është detyrë të vihet në konsideratë se *el fuduliji* nuk është pronar i sendit me të cilin vepron, pavarësisht nga motivi që e shtyn atë ta bëjë ketë veprim. Kjo çështje bëhet e qartë prej shembujve vijues. Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Në lidhje me *el fudulijin*, në asnjë mënyrë nuk merret në konsideratë qëllimi i parazitizmit, prandaj kush shet një send, me pretendimin se është pasuri e tij dhe më vonë bëhet e qartë se ai send është pasuri e një tjetri, shitësi është *el fudulij*, është njeri që shet pasurinë e tjetrit, është prej atyre që merrem me punët personale të të tjerëve."

Penglënësi real

Kur një njeri vepron me pasurinë e tjetrit pa lejen paraprake, por qëllon që veprimi i këtij njeriu përputhet me dëshirën e pronarit të asaj pasurie, në një gjendje të këtillë, a është detyrë që pronari i kësaj pasurie ta lejojë këtë bashkëpunim të ndërsjellë, të cilin ai shpirtërisht e gjen veprim të mirë, domethënë, ai mban përgjegjësi para Allahut të Gjithëfuqishëm të ndalojë lejimin, apo ai ka të drejtën e zgjedhjes, domethënë: nëse dëshiron, e lejon këtë veprim të ndërsjellë me pasurinë e tij, ose, nëse dëshiron e refuzon? Shkurtimisht: A është miratimi me zemër plotësisht si lejimi i shprehur me fjalë të qarta?

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Miratimin që forcohet në shpirt, por që nuk del jashtë, fukahatë nuk e konsiderojnë miratim, sepse ai miratim nuk i përmbahet lejimit të mëpasshëm, por mjafton miratimi i shprehur njëherësh me kontratën. Kjo është e barabartë, qoftë kur miratimi del në shesh pas ndërtimit të kontratës, qoftë kur miratimi del në shesh në origjinë, prandaj pronari i sendit, për besën e dhënë para Allahut, ka detyrë të nënshkruajë për atë që ai kishte miratuar, për pasojë mbi atë renditen edhe efektet e kontratës, sipas rregullit të përgjithshëm për të mbajtur besën në të gjitha kontratat e rregullta, ashtu siç urdhëron i Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij:

"يَا أَيُّهَا الَّذِيْنَ آمَنُوا أَوْفُوا بِالْعُقُودِ"

"O ju që kini besuar, mbani besën për kontratat (detyrimet)." *(Sure "El Maide", ajeti 1)* dhe:

"إِلاَّ أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً عَنْ تَرَاضٍ"

"...përveçse kur është tregti që jeni në marrëveshje me njëri-tjetrin." *(Sure "En Nisa", ajeti 29)*

Në lidhje me këtë çështje është edhe fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Nuk është hallall pasuria e një myslimani, pa miratimin e tij."*

E vërteta qëndron ashtu siç thonë fukahatë, të cilët nuk janë mjaftuar vetëm me miratimin shpirtërisht, pa e shprehur miratimin me fjalë.

Shejkhu En Nàijnij ka thënë: "Patjetër ndërtimi i kontratës duhet të bëhet me fjalë ose me punë, sepse as mospëlqimi

shpirtërisht nuk është kthim prej kontratës dhe as miratimi shpirtërisht nuk është lejim. Në të dy rastet është e detyrueshme që miratimi e mosmiratimi të shprehen sheshit."

Për sa i përket fjalëve të Allahut të Lartësuar: **"...mbani besën për kontratat.", "...përveçse kur është tregti që jeni në marrëveshje me njëri-tjetrin.",** si dhe fjalës së Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Pa miratimin e tij"*, të gjitha këto fjalë i drejtohen atij që ka të drejtë për të vepruar, prandaj këto fjalë s'kanë asnjë lidhje, as të afërt e as të largët me atë që merret me punët personale të të tjerëve.

Objekti i shitjes së mallit të tjetrit

Çdo veprim që kryhet me prokurë, është i vlefshëm, po ashtu ai është i vlefshëm edhe kur veprimi kryhet prej atij që merret me punët personale të të tjerëve *(el fudulij)*. Ky është shkaku që fukahatë kanë një mendim të përbashkët që kjo klauzolë është vepruese për të gjitha kontratat, madje edhe për kontratën e martesës e të lënies vakëf, gjithnjë bazuar mbi rregullin se nijeti për afrim te Allahu i Lartësuar, nuk është kusht për vlefshmërinë e kontratës dhe kjo është e vërteta.

Gjithashtu, kjo klauzolë e fik'hut është vepruese edhe për detyrimet, përveç lirimit të skllavit e divorcit, pasi shumë prej fukahave kanë pretenduar se është fjala e përbashkët e fukahave për moslejimin e lirimit të skllavit e divorcit nga ana e *el fudùlij*.

Fukahatë, ose më të mëdhenjtë prej tyre, kanë nxjerrë argumente për vlefshmërinë e lirimit të skllavit të vënë peng, duke nënshkruar lirinë për atë, ose lirimin e sendit të lënë peng.

Siç shihet, derisa lejohet marrja me punët personale të të tjerëve, në rastin e lirimit të skllavit nga robëria, është më e pranueshme të jetë i lejuar veprimi nga ana e *el fudulijit* edhe për punë të tjera.

Në të vërtetë, studimi në lidhje vlefshmërinë e mosvlefshmërinë e veprimeve të *el fudulijit*, është një degëzim i studimit të mëposhtëm dhe konsiston në atë që shitja e sendeve të një tjetri, është bërë sipas kërkesës së rregullit për shitjen, apo është bërë në kundërshtim me këtë rregull. Nëse shitja është e bazuar mbi rregullin, bëhet i domosdoshme pohimi se ajo është e vlefshme në të gjitha kontratat dhe detyrimet, përveç atyre që dalin jashtë rregullit me argument. Nëse shitja nuk është e bazuar mbi rregullin, përsëri bëhet e domosdoshme të pohohet mosvlefshmëria e saj, me përjashtim të shitjes që del jashtë rregullit me argument, për të cilën do të flitet me hollësi në vijim.

Sendi konkret dhe në mirëbesim

Ashtu siç bëhet shitja e mallit të tjetrit, kur malli është para syve, si për shembull, kur unë them: "Ta shita ty shtëpinë e Zejdit", ose "Bleva shtëpinë tënde për Zejdin", po ashtu shitja bëhet edhe kur malli i vlerësuar me çmim është në mirëbesim, si për shembull, kur unë them: "Të shita ty një ton grurë në mirëbesim të Zejdit, me shtëpinë tënde, për të cilën folëm.", ose

kur bëhet fjalë për çmim të caktuar, si për shembull, kur unë them: "E bleva shtëpinë tënde për Zejdin për një mijë lira në besë të tij."

Kur Zejdi, në shembullin e parë, e lejon shitjen në favorin e tij, atëherë shitja vërtetohet në mirëbesim edhe për shitjen e një ton gruri për blerësin. Gjithashtu, kur ai e miraton blerjen e shtëpisë për veten e tij, patjetër që vërtetohet blerja në mirëbesimin e tij për shitësin për një mijë lira. Por kur Zejdi kthen dhe refuzon, atëherë shitja e blerja janë të pavlefshme, që në themel dhe pala e dytë nuk ka asnjë të drejtë të kërkojë kompensim prej atij që shiti mallin e tjetrit, sepse kontrata e lidhur prej atij që shet mallin e tjetrit, në mënyrë absolute, s'ka asnjë efekt, kur mungon lejimi nga ana e pronarit të sendit të vënë në shitje.

Nuk dihet se është mall i tjetrit

Kur një kontratë lidhet mes dy vetëve dhe njëri prej atyre të dyve shet mallin e tjetrit (është *el fudulij*), ndërsa pala tjetër nuk e di se ai po shet mallin e tjetrit, pasi nuk ka ndonjë veprim të ngjashëm që të tregojë për këtë shitje, si për shembull, kur blerësi thotë: "E bleva këtë shtëpi për një mijë." dhe ka qëllim blerjen për Zejdin, por ai nuk e ka shprehur këtë, atëherë, nëse Zejdi e lejon veprimin e tij, padyshim që shitja është e plotësuar, por, nëse Zejdi e kundërshton, si bazë, a prishet kjo shitje në atë mënyrë që shitësi s'ka të drejtë të kërkojë prej kontraktuesit ndonjë kompensim, apo ai ka të drejtë ta detyrojë atë që t'i japë çmimin e të marrë mallin?

Në librin "Et Tedhkireh", prej dijetarit të madh, është cituar se fukahatë e medh'hebit xhaferij e kanë bërë detyrim të vendoset sipas asaj që është shkruar e është thënë në kontratë dhe se përgjegjësi është blerësi që ka bërë kontratën, patjetër së bashku me shitësin.

Gjithashtu, një grup juristësh, këtë thënie ia kanë atribuuar shejkhut El Ensarij. Kjo është e vërteta, sepse qëllimi i blerjes për tjetrin është pa efekt, kur ajo nuk shprehet me fjalë ose me ndonjë veprim, pra, qëllimi i blerjes për tjetrin anulohet dhe kontrata ndodh për vetë kontraktuesin, sepse efekti i kontratës kufizohet me të dy kontraktuesit dhe veprimi i saj nuk kalon te ndonjë tjetër, përveç atyre të dyve, kur ka një shembull përngjasimi.

Ti mund thuash se, duke u bazuar mbi këtë që u tha, a bëhet e detyrueshme ekzistenca e kontratës pa qëllim, sepse ai që ka qëllim të blejë për tjetrin, kur personi për të cilin u bë blerja, nuk e miraton qëllimin e tij, megjithëse, kur ai lidhi kontratën nuk kishte qëllim të blinte për veten e tij, por ama dihet se kontratat ndjekin qëllimet.

Në përgjigje, ne themi: Ajo që është saktësuar në kontratë, tregon se kontraktuesi kishte qëllim blerjen për veten e tij dhe gjykimi bëhet sipas asaj që shihet në kontratë, derisa të vërtetohet e kundërta. Për sa i përket fjalës së tij: "Kisha qëllim blerjen për Zejdin", nuk mund të tërheqë vëmendjen e askujt, derisa qëllimin nuk e di askush përveç tij.

Pra, në këtë rast, ai ngjason me atë që pohon të drejtën e vet për një tjetër dhe pastaj pretendon se s'ka pasur qëllim pohimin. Me një fjalë, të gjitha motivet e brendshme, për të cilat s'ka dijeni

askush tjetër, përveç vetë personit që synon realizimin e qëllimit të vet, në mënyrë absolute, këto kategori qëllimesh s'kanë asnjë vlerë në të gjitha bashkëpunimet e ndërsjella.

Kush merr mallin, paguan çmimin

Më sipër kemi thënë se efekti i kontratës nuk shtrihet mbi të tjerë përveçse mbi dy kontraktuesit, me përjashtim të rastit kur ka një shembull të ngjashëm. Këtu lind kjo pyetje: A gjykohet sipas shembullit të ngjashëm, kur ai shembull tregon se malli është për një person dhe çmimin ka detyrë ta paguajë një tjetër, si për shembull, kur ai thotë: "E bleva këtë për Zejdin, me një dirhem, me garancinë time.", ose kur thotë: "Këtë e bleva për vete, me një dirhem me garancinë e Zejdit."?

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Çështja ka nevojë për studim të thellë." Sej'jid El Jezdij këtë thënie e ka komentuar me këto fjalë: "Shikuar me maturi, në të dyja format, prishja është e padiskutueshme, sepse që të dyja format, janë rrjedhojë e bashkimit mes dy të kundërtave", që do të thotë se karakteri i vetë kontratës nënkupton që çmimin ka detyrë ta paguajë ai që merr mallin. Kur malli është për një person, çmimin e paguan një tjetër. Pikërisht këtu ndodh kontradikta e kolapsi, në të njëjtën fjalë, prandaj fjalët e thëna, në lidhje me këtë kontratë, janë fjalë boshe që s'kanë asnjë efekt.

Ndalimi i shitjes

Kur pronari i mallit ndalon që malli i tij të shitet, por elfudulijі nuk është njoftuar për këtë ndalim, shitja kryhet. A është e vlefshme kjo shitje, kur pronari e miraton shitjen dhe lejon ekzekutimin e kontratës, si edhe efektet e kontratës, apo kontrata është lidhur gabim, për pasojë edhe lejimi është fjalë boshe, sepse ajo kontratë është pa objekt?

Fukahatë më të dëgjuar janë mbështetur në thënien e shejkhut El Ensarij se ndalimi nuk ka efekt për vetë kontratën, por ajo është e vlefshme dhe ekzekutohet me lejimin, sepse argumenti që tregon vlefshmërinë e marrëdhënies së ndërsjellë nga ana e elfudulijit dhe nuk bën dallim mes ndalimit ose mosndalimit paraprak. Sido që të jetë, ndalimi është diçka e ardhur, efekti i të cilit largohet thjesht me arritjen e miratimit e të lejimit.

Shitja e rrëmbyesit

Kur supozohet se rrëmbyesi e shet mallin që ka grabitur, me qëllim që të jetë zëvendësues i pronarit të atij malli, në këtë gjendje rrëmbyesi është elfudulij, shitja e tij është e vlefshme dhe zbatohet me lejim. Tani shtrohet pyetja: A do të ishte elfudulij ky rrëmbyes, nëse ai, në mënyrë absolute, nuk e ka pasur qëllim pronarin, por e ka konsideruar veten sikur ishte ai pronari i vërtetë?

Shumica e fukahave janë shprehur se shitja e rrëmbyesit është shitje prej elfudulijit dhe, kur pronari e lejon shitjen, sendi i grabitur kalon në pronësi të blerësit, ndërsa çmimi i atij sendi i

kalon lejuesit. Disa prej fukahave kanë thënë: "Kurrsesi. Kontrata e rrëmbyesit, që në bazë është pa vlerë dhe lejimi nuk përmirëson asgjë, për shkak të mohimit të objektit të kontratës."

Kjo pjesë e fukahave, në lidhje me këtë çështje, ka nxjerrë argumentet e mëposhtme:

Fjalët e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Mos shit atë, që nuk e ke."*; *"Nuk ka shitje përveçse për sendin që ke në zotërim."*

Fukahatë më të dëgjuar, që kanë mbështetur vlefshmërinë, kanë thënë se kjo mohon ndodhjen e shitjes prej atij që nuk është pronar i sendit, por nuk e mohon ndodhjen e shitjes në favor të pronarit të sendit, kur ai e miraton dhe e lejon shitjen, ashtu siç ishte qëllimi.

Gjithashtu, prej argumenteve është fakti se rrëmbyesi e bën shitjen duke pasur qëllim vetveten dhe jo pronarin e sendit, por është e qartë se, kur pronari lejon, në të vërtetë, ai ka lejuar shitjen për veten e tij dhe jo për rrëmbyesin, që do të thotë se lejimi, nga ana e pronarit, tregon se shitja bëhet në favorin e tij, megjithëse në këtë rast shitja është pa qëllim, pasi qëllimin për shitjen e kishte rrëmbyesi, por lejimi s'ka asnjë lidhje me rrëmbyesin.

Ata që janë shprehur për vlefshmërinë, bazohen në faktin se shitja është shkëmbim i mallit me mall, cilido qoftë pronari i atij malli dhe, kur vërtetohet qëllimi i shkëmbimit të ndërsjellë, atëherë kontrata plotësohet.

Kjo është e barabartë, qoftë kur qëllimi është për pronarin e vërtetë, qoftë kur qëllimi është për dikë tjetër, ose dhe kur, në mënyrë absolute, qëllimi nuk është për asnjë njeri, pasi dihet se

qëllimi në asnjë, nuk është as prej të vërtetave e as prej kushteve të shitjes. Prandaj, bazuar mbi këtë që u tha, qëllimi i rrëmbyesit që ka në pronësi sendin e rrëmbyer, nuk ka efekt. Gjithashtu, nuk ka efekt as fakti që rrëmbyesi e vë veten në pozitën e pronarit të vërtetë, sepse efekti, në të vërtetë, është për qëllimin e shkëmbimit të ndërsjellë mes dy mallrave, prandaj lejimi ka lidhje me këtë qëllim dhe jo me atë që ka dashur, ose ka pasur qëllim rrëmbyesi, pasi efekti është ajo që synohet me shkëmbimin e ndërsjellë.

Pikërisht ky është edhe kuptimi i fjalë së Sej'jid El Jezdij: "E vërteta e shitjes nuk është gjë tjetër veçse shkëmbim i mallit me mall, pa marrë parasysh se ky shkëmbim kryhet për atë, ose për dikë tjetër. Ky është kuptimi që gjendet në shitjen e rrëmbyesit, i cili qëllimin e kishte për vete, prandaj qëllimi i tij është jashtë të vërtetës së shitjes."

Nuk ka dyshim që rrëmbyesi, kur i jep pushtet një tjetri me shitjen, ose me sendin që ai ka grabitur, pronari i sendit ka të drejtën e plotë ta lërë atë send në dorën e atij që do ta marrë sendin prej rrëmbyesit me çdo mënyrë që ai ka mundësi, megjithëse rrëmbyesi, në të vërtetë, nuk kishte qëllim shitjen as për veten e tij e as për ndonjë tjetër, pasi atij nuk i intereson gjë tjetër përveç asaj që të fusë në dorën e tij këtë mall me çdo rrugë, ashtu siç është puna me të gjithë kusarët.

Gjithnjë, në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë supozuar se, kur rrëmbyesi ka qëllim që shitjen ta bëjë për veten e tij. Më pas fukahatë kanë bërë komentime e kanë nxjerrë degëzime për një send që nuk ekziston. Sido që të jetë, është fakt se shumica e çështjeve të fik'hut janë ndërtuar mbi supozimet.

Kontrata e** el fudulijit **në përputhje me rregullin

Më sipër u njohëm me *el fudulijin* dhe treguam disa anë të fshejkhta dhe konfirmime të individëve *el fudulij*. Tani do të përmendim thëniet e fukahave më të dëgjuar në lidhje me vlefshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë që kryen *el fuduliji*, sepse prej thënieve të këtyre fukahave do të bëhet e qartë sa e dobët është fjala e atyre që janë shprehur për mosvlefshmërinë e marrëdhënies së bashkëpunimit të ndërsjellë që kryen *el fuduliji*.

Para se të ekspozojnë tekstet specifike në lidhje me *el fudulijin*, është detyrë të vërtetojmë: A e kërkon rregulli vlefshmërinë e veprimit me mallin e tjetrit, në atë mënyrë që veprimi i *el fudulijit* të jetë i vlefshëm në çdo send dhe mbi atë të renditen efektet, sapo të jetë lejimi, pasi është e barabartë, kur objekti i kontratës është shitje, dhurim, martesë, divorc e të tjera, me përjashtim të atyre veprimeve që dalin jashtë rregullit me argument, ose kur rregulli e kërkon pavlefshmërinë e shitjes së mallit të tjetrit, në atë mënyrë që edhe lejimi nuk sjell ndonjë dobi, me përjashtim të gjërave që dalin jashtë këtij rregulli me argument.

Me një përqasje të dytë, shtrohet pyetja: A mund të lidhet një kontratë e vlefshme prej atij që nuk ka të drejtën e veprimit me atë pasuri, domethënë që ajo kontratë ka nevojë vetëm për lejen, ose ajo kontratë mund të lidhet vetëm prej pronarit të mallit, ose prej një personi të autorizuar prej pronarit, ose prej kujdestarit ligjor, ose prej zbatuesit të testamentit, ose prej të prokuruarit?

Në lidhje më çështjen e parë, domethënë lidhja e kontratës prej atij që nuk ka të drejtën e veprimit mbi atë pasuri, është e

detyrueshme të gjykojmë për vlefshmërinë e veprimeve të ndërsjella që bën *el fuduliji*, me të gjitha llojet e këtyre veprimeve, me përjashtim të rastit kur me ajet të Kur'anit, ose me transmetim, ose me fjalën e përbashkët të fukahave, vërtetohet pavlefshmëria e veprimeve të *el fudulijit* për veprime me karakter specifik, siç është lirimi i skllavit dhe divorci, ndërsa, kur kontrata e lidhur është e posaçme për atë që ka vetëm të drejtën e veprimit, atëherë, në mënyrë absolute, bëhet e detyrueshme të gjykohet për pavlefshmërinë e bashkëpunimit të ndërsjellë të *el fudulijit*, me përjashtim të rastit, kur vërtetohet vlefshmëria e veprimit të tij me argument të veçantë, siç është shitja.

E vërteta në lidhje me kontratën e lidhur prej *el fudulijit* mbështetet nga fukaha të dëgjuar, të cilët kanë thënë se kontrata e lidhur prej *el fudulijit* në përputhje me rregullin, i cili kërkon që kontraktuesi të jetë i mençur, në moshë madhore dhe kontrata të këtë objekt dhënie në pronësi e marrje në pronësi, ndërsa për kontratën që s'ka lejen e pronarit të mallit, kjo nuk e bën të detyrueshme as mohimin e emrit kontratë dhe as shitjen e bërë me këtë kontratë, por patjetër që miratimi është kusht për ekzekutimin e kontratës, por jo për ndërtimin e saj.

Në vëllimin e pestë të librit "El Hadàik" thuhet: "Fukahatë kanë argumentuar vlefshmërinë e shitjes së elfudulijit dhe janë shprehur se shitja e bërë prej një personi të aftë për të kryer shitje të bërë ashtu siç kërkohet, është shitje e vlefshme, sepse është kryer prej një personi të aftë për të kryer shitjen, është bërë prej një personi të mençur, që është në moshë madhore dhe që ka aftësi të bëjë zgjedhjen. Personi që ka të gjitha këto cilësi, patjetër që është prej atyre që mbajnë edhe detyrimet. Në lidhje me faktin që shitja është bërë në vendin e duhur, do të thotë se është kryer me një

mall konkret, pronësia mbi të cilin është e vlefshme dhe është mall prej të cilit përfitohet e që pranon kalimin prej shitësit te një person tjetër.

Themi se shitja është e vlefshme, pasi për shitjen në fjalë vërtetohet kërkesa që ajo është e plotë, prandaj ajo nuk mund të kundërshtohet. Në lidhje me rastin kur sendi në shitje nuk është në pronësi të kontraktuesit, kjo nuk është pengesë për vlefshmërinë e kontratës, qoftë kur pronari lejon para shitjes, qoftë kur ai lejon pas shitjes, sepse nuk ka ndonjë dallim, nëse pronari i mallit e ka lejuar kontratën para apo pas shitjes."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Dijetarëve tanë i atashohet thënia se kontrata e lidhur prej elfudulijit është e vlefshme, sepse ajo është kryer, për shembull, pas miratimit për shitjen, pra, kontrata dhe tregtia është bërë me miratim të ndërsjellë, domethënë përfshin argumentet që tregojnë vlefshmërinë dhe detyrimin, të marra prej librit të Allahut, prej Sunetit dhe prej fjalës së përbashkët të fukahave, në lidhje me domosdoshmërinë në qëndrimin e vërtetësisë së emrave, domethënë, në vërtetësinë e emrave shitje, kontratë e tregti, të shqiptuara prej një personi që nuk është *el fudulij* dhe nuk ka asgjë prej argumenteve që të vërë në konsideratë përparësinë e miratimit, ose një fjalë të ngjashme me miratimin."

Kur kontrata e *el fudulijit* është në përputhje me rregullat e përgjithshme dhe sipas të gjitha argumenteve, atëherë shprehësi i fjalëve të kontratës s'ka nevojë për ndonjë argument të veçantë. Megjithëkëtë, fukahatë më të dëgjuar janë bazuar në disa argumente, prej të cilave ne do të përmendim transmetimin mjaft të përhapur të Urveh El Bàrikij, transmetim me të cilin fukahatë

kanë punuar që nga koha e shejkhut Et Tùsij (vdekur në vitin 460 H) e deri në ditët e sotme.

Transmetohet se Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i dha Urveh El Bàrikij një dinar që të blejë një dele, por ai, me ketë dinar, bleu dy dele. Pastaj rrugës shiti njërën prej dy deleve për një dinar dhe, kur erdhi te Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e njoftoi për sa kishte bërë.

Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha: *"Allahu i Lartësuar të bekoftë për shitjen që ke bërë me dorën tënde."*

Ana nga nxirret argumenti prej këtij transmetimi gjendet në faktin se Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e lejoi Urvehin të blejë një dele dhe nuk i dha leje të shesë atë çka bleu, pra, në fakt, leja ishte për të blerë një dele. Prandaj në këtë gjendje, Urvehi është elfudulij. Për sa i përket blerjes së dy deleve me një dinar, këtu s'ka asgjë prej mallit të tjetrit, sepse miratimi ishte për blerjen e një deleje me një dinar.

Ky fakt tregon plotësisht kuptimin që përmban fjala miratim, i cili, në këtë rast, vetvetiu ka më shumë përparësi për blerjen e dy deleve me një dinar. Kontrata, në këtë rast, është së bashku me miratimin.

Gjithashtu, transmetimi për blerjen e deles me një dinar, dëshmon qartë për specifikim e elfudulijit, si person që ble e shet për tjetrin, njëkohësisht edhe lutja për bekim nga ana e Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

për shitjen që bëri Urvehi, gjithashtu, flet qartë për lejimin. Njëkohësisht zbulon edhe miratimin për veprimin e kryer.

Kushtet e lejuesit

Në terminologjinë e fukahave, qëllimi i përdorimit të fjalës "lejues" është të tregojë atë që ka të drejtën e veprimit me pasurinë në vend të një tjetri. Kjo është e barabartë, qoftë kur vepruesi është pronar i vërtetë, kujdestar ligjor, mbajtës testamenti, i prokuruar, qeveritar i ngarkuar të përkujdeset për pasuritë e personave të paaftë për të vepruar me pasurinë e tyre, qoftë kur është i ngarkuar të mbajë llogari të barabartë për myslimanët. Padyshim e pa asnjë kundërshtim që lejuesi, kur lejon, duhet të plotësojë të gjitha kushtet që merren në konsideratë për lidhjen e kontratës, siç ishin mosha madhore, aftësia për të vlerësuar situatën, të gëzojë shëndet të plotë fizik e psikik.

Gjithashtu, është kusht që gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të mos lëngojë prej ndonjë sëmundjeje vdekjeprurëse. Këto të vërteta s'kanë nevojë për argument dhe as që mendohet që këto të vërteta të jenë objekt për kundërshtime, sepse së bashku me to është edhe analogjia përkatëse.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse është e detyrueshme që lejuesi të ketë aftësi për të lidhur kontratë në kohën e ndërtimit të kontratës dhe daljes së kontratës prej *el fudulijit*, plotësisht ashtu siç është e detyrueshme të jetë në kohën e lejimit, apo është e mjaftueshme që ai të ketë aftësi të plotë vetëm në kohën e lejimit, kurse për kohën e ndërtimit të kontratës, kjo kërkesë nuk është kusht.

Rezultati i kësaj çështjeje del qartë kur *el fudulij*i shet mallin e të çmendurit, ose mallin e të voglit, ose mallin e një naivi, ose pronari i mallit vdes para se të lejojë, ose të refuzojë shitjen. Bazuar mbi rastin e parë, kontrata e lidhur prej *el fudulijit* nuk është efektive dhe është e gabuar, kur lejuesi, në kohën e ndërtimit të kontratës, ka ndonjërën prej këtyre dukurive ndaluese të përshkruara.

Le të marrim një shembull: Lejimi i fëmijës nuk sjell asnjë dobi, pasi ai arrin moshën e pjekurisë, ose i çmenduri, pasi i kthehet vetëdija, ose pasi naivi fiton aftësinë e udhëzimit e të vlerësimit të gjendjes, ose trashëguesi, pas vdekjes së trashëgimlënësit të tij.

Bazuar mbi rastin e dytë, kontrata është e vlefshme pas rënies së pengesës, për pasojë, mbi kontratën renditen të gjitha efektet e saj ligjore.

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dy thënie. Më e fuqishme prej këtyre dy thënieve është thënia që flet për plotësimin e të gjitha kushteve në kohën e lejimit. Kjo është e barabartë, qoftë kur kushtet plotësohen, qoftë kur nuk plotësohen kushtet në kohën e ndërtimit të kontratës, sepse argumenti që tregon për vlefshmërinë absolute të kontratës së lidhur prej *el fudulijit* nuk është e kushtëzuar me faktin që lejuesi të ketë aftësi të plotë.

Prandaj, bazuar mbi këtë argument, është bërë edhe renditja e efekteve të lejimit. Më sipër u tha që lejuesi, patjetër duhet të ketë aftësi për të lidhur kontratë dhe të mbajë përgjegjësi në kohën e lejimit. Bazuar mbi këtë rregull, ndodh edhe kontrata e

lidhur prej *el fudulijit* me mallin e të çmendurit, ose me mallin e fëmijës.

Gjithashtu, është e vlefshme që ekzekutimi i kontratës të bëhet bazuar mbi lejimin e kujdestarit, ose nga ana e të çmendurit, pasi t'i kthehet ndërgjegjësimi, ose lejimit nga ana e fëmijës, kur arrin moshën madhore. Shejkhu El Isfahànij, në margjinaturën *(hàshijeh)* e librit "El Mekàsib", ka thënë: "Kontrata del prej të mençurit dhe prej atij që ka arritur moshën madhore. Por ndodh që kontrata lidhet në kohën kur pronari i mallit është i vogël, ose kur pronari i mallit është në gjendje çmendurie. Kjo rastësi nuk e pengon kontratën që ajo të jetë e vlefshme, derisa ajo del prej një të mençuri që ka arritur moshën madhore. Pastaj këtu fukahatë kanë përmendur disa çështje, ndër të cilat:

Shitja e penglënësit

1- Penglënësi shet sendin e lenë peng dhe pastaj atë send ai e liron prej pengpranuesit. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dhënë sentencën *(fetvà)* për vlefshmërinë e shitjes dhe ekzekutimin e saj pa lejim. Këtu supozohet se penglënësi ka shprehur miratimin e tij, duke e ndërtuar këtë kontratë, atëherë supozohet se penguesi reduktohet me sendin e lënë peng dhe ndërvarësinë që ka pengpranuesi me sendin e lënë peng te ai. Por kur penglënësi e liron sendin e lënë peng, vetvetiu penguesi bie.

Me fjalë të shkurtra, veprimet e penglënësit me sendin e lënë peng, janë të vlefshme dhe të zbatueshme vetëm kur pas shitjes, vjen lirimi i sendit të lënë peng, në atë mënyrë që

pegpranuesit nuk i ka mbetur më asnjë e drejtë mbi sendin e lënë peng.

Shitja e naivit

2- Naivi shet një mall të vetin pa lejen e kujdestarit të tij, por më pas atij i rikthehet vetëdija e plotë, kështu që ngurtësimi i pasurisë së tij hiqet. Për këtë rast, fukahatë kanë dhënë sentencën për vlefshmërinë e kësaj shitjeje, por patjetër së bashku me lejimin prej vetë pronarit që ka lidhur kontratën, pasi ai ka rifituar aftësinë e vlerësimit. Dallimi me shitjen e penglënësit qëndron në faktin se shitja e tij s'ka nevojë për lejimin e shitjes, kurse kontrata e shitjes, e lidhur prej naivit, ka nevojë për lejimin, sepse penguesi, në rastin e kontratës së naivit, është moslejimi i tij, sepse lejimi, nga ana e naivit, në mënyrë absolute, nuk mund të konsiderohet miratim. Megjithëkëtë kontrata ekzekutohet, madje edhe atëherë kur ai ka qenë i imponuar. Çka është në kundërshtim me kontratën e penglënësit, sepse penguesi, në këtë rast, ishte ekzistenca e sendit të lënë peng, ndërkaq patjetër kërkohet miratimi i tij dhe në favorin e tij janë të gjitha efektet në ekzekutimin e kontratës, ndërsa dispozitat e kontratës rëndojnë mbi vetë penglënësin.

Shet një send dhe më pas e bën pronë

3- Ai që shet mallin e tjetrit dhe më pas ai e vë atë mall në pronësinë e tij me trashëgimi ose me blerje, në këtë rast, shitja është e vlefshme. Por kjo shitje do të ekzekutohet vetëm pasi

shitësi të vërë në pronësi të tij mallin e shitur. Vlefshmërinë e kësaj shitjeje e tregon argumenti që flet se vlefshmëria e kontratës së elfudulijit nuk është e kushtëzuar, kur malli ka vetëm një pronar apo ai mall ka disa pronarë, ndërkaq lejimi është i nevojshëm, sepse shitësi, në çastin e shitjes, nuk e kishte aftësinë për të nënshkruar kontratën në kohën e ndërtimit të saj.

Besimi dhe realiteti

4- Ai e shet sendin, duke besuar se nuk e ka në pronësi sendin që të veprojë me të. Por më pas bëhet e qartë e kundërta, si për shembull, kujdestari shet mallin e fëmijës, ose mallin e të çendurit, ose mallin e naivit, në një kohë që ai nuk e di se është kujdestar, ose është i prokuruar për t'i shitur mallin prokurlëshuesit, pasi ka harruar se ka prokurë, ose në rastin kur djali shet mallin e babait së tij, duke menduar se ai është gjallë. Ndërkaq bëhet e qartë se babai ka vdekur. Në të gjitha këto raste, shitja është e vlefshme, por lejimi jo vetëm që është i nevojshëm, por është edhe i detyrueshëm, sepse vlefshmëria e kontratës dhe ekzistenca e saj patjetër duhet të ketë dy veprime: qëllimin për kontratën dhe miratimin nga ana e pronarit.

E para është kusht për vlefshmërinë, kurse e dyta është kusht për ekzistencën e kontratës. Të dyja këto veprime janë të realizueshme në të gjitha rastet e mësipërme. Veç kësaj, besimi se nuk e ka në zotërim, ose beson që nuk është kujdestar, ose beson se nuk ka prokurë, nuk e ndryshon realitetin e këtij personi dhe, në mënyrë absolute, ai nuk i nxjerr argumentet, sepse argumentet janë, sepse pronësia mbi pasurinë nga ana e pronarit, ose e drejta e

kujdestarit ligjor, ose e drejta e të prokuruarit, mbetet ashtu siç është dhe mbi këtë përputhen argumentet e zotërimit të këtyre të drejtave, edhe në rastin e një shkujdesje të plotë se këto të drejta u takojnë personave të sipërpërmendur. Gjithashtu, edhe në rastin kur ata besojnë se nuk i kanë këto të drejta. Më sipër u tha se qëllimi i atij që shet ose ble, është i huaj nga e vërteta e kontratës.

Vendlejimi

Më sipër u tha se lejuesi është personi që ka të drejtën e veprimit, për të cilin u tha se nuk është kusht që ai të ketë aftësi të plotë në kohën e ndërtimit të kontratës dhe daljes së kontratës prej një elfuduliji, por është kusht që ai të ketë aftësi ta nënshkruajë kontratën vetëm në kohën e lejimit. Tani le të flasim për vendlejimin, që është kontrata që ai lidh. Patjetër që lejimi nuk është as pjesë e kontratës e as kusht për ndërtimin e saj, por është kusht vetëm për efektet e kontratës.

Me fjalë të tjera, kushtet janë dy llojesh, kusht për vlefshmërinë e kontratës dhe kusht për ekzistencën e kontratës dhe veprimit sipas kërkesave të saj, kurse lejimi është kusht për detyrimin dhe jo për vlefshmërinë.

Kushtet që janë të plota në kontratën e elfudulijit, me të cilat lidhet lejimi në këtë kontratë, ne e emërtuam vendlejimi, janë të njëjtat kushte të plota që është detyrim të jenë edhe për vlefshmërinë e kontratës së origjinalit, siç janë përputhja e oferta dhe pranimi për një send të vetëm, qartësia e kushteve që shprehin vullnetin, aftësia e kontraktuesit për të lidhur kontratë, siç ishte mendja, mosha madhore dhe aftësia për të vlerësuar

situatën, si dhe mundësia e dy sendeve të shkëmbyeshëm për t'u marrë në pronësi në mënyrë të ndërsjellë, njohja që kanë dy kontraktuesit me këto dy sende të shkëmbyeshme, si dhe të tjera kushte, me përjashtim të miratimit nga ana e pronarit të sendit.

Natyrisht që ka edhe kushte që s'kanë lidhje me ndërtimin e kontratës si kontratë, por që vijnë prej kontratës në një shkallë të mëvonshme, si për shembull, mundësia praktike e dorëzimit të sendit të shitur, veprim që nuk është kusht as për ndërtimin e kontratës e as për vlefshmërinë e lejimit.

Le të marrim një shembull: Zejdi shet një ton grurë në garancinë e Zejdit, me kushtin që marrja e sasisë së lartpërmendur të merret në dorëzim pas tri muajve. Kjo shitje është e vlefshme dhe ekzekutohet, kur të dëshirojë Zejdi, madje duke vënë në konsideratë edhe mospasjen mundësi të dorëzimit në kohën e lejimit. Por është e mjaftueshme që kjo mundësi të jetë në kohën e marrjes në dorëzim, që do të thotë se kushti i mundësisë së marrjes në dorëzim ndodh pikërisht në këtë kohë.

* * *

LEJIMI DHE DISPOZITAT E LEJIMIT

Kuptimi i lejimit

Pasi folëm për lejuesin dhe vendlejimin, që ishte kontrata, tani do të flasim për lejimin, që është shprehja e miratimit për kontratën që lidh elfudulijin me nënshkrimin e tij, ose me shkresë të lëshuar prej tij, ose me punë, sepse miratimi faktik nuk mund të ndodhë, nëse ai nuk është shprehur.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Lejimi del prej atij që e ka të drejtën të lejojë dhe nuk mjafton të quhet miratim heshtja, krahas diturisë që është për atë veprim, pa folur për rastin kur nuk dihet asgjë rreth atij veprimi. Madje te dijetarët tanë të fesë dhe te dijetarët e fesë në përgjithësi, nuk është miratim as kur kontrata është e pranishme.

Për sa i përket faktit që heshtja është e mjaftueshme si miratim për virgjëreshën, në rastin kur ajo merr njoftim për fejesën e saj, kjo mjaftueshmëri është në kontekst të miratimit.", që do të thotë se heshtja nga ana e vajzës, tradicionalisht, konsiderohet lejim nga ana e saj për lidhjen e kontratës së martesës, sepse është turpi që e pengon vajzën të flasë.

Pa diskutim që fjala është mjeti më i qartë e më i mirë për të shprehur qëllimin, megjithëse shkresa, tradicionalisht, është prej metodave që ndiqen për lejimin. Gjithashtu, mënyrë lejimi është edhe veprimi, siç është fakti kur pronari merr shumën për shitjen e bërë, si dhe veprime të tjera të ngjashme.

Lejimi dhe pronësimi

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Lejimi është prej shenjave që pronari ka pasurinë e tij, kurse fjala jonë: "Ai ka të drejtën e lejimit.", është si fjala jonë: "Ai ka të drejtën e shitjes.". Është e qartë se të dyja këto fjalë i referohen faktit se ai ka të drejtë të veprojmë me atë pasuri, sepse, kur pronari vdes, lejimi nuk trashëgohet, por trashëgohet vetëm pasuria për të cilin elfuduliji ka lidhur kontratë, prandaj ai ka të drejtën e lejimit në vend të mungesës së lejuesit si pronar i asaj pasurie në kohën e lidhjes së kontratës.

Sej'jid El Jezdij, duke komentuar këtë fakt, ka thënë: "Kjo do të thotë se e drejta e lejimit nuk bën pjesë në të drejtat, derisa ai të trashëgojë, pasi lejimi është prej dispozitave ligjore dhe trashëgimia nuk ka lidhje me lejimin, sepse dispozita nuk trashëgohet."

Më pas ai thotë: "Kuptimi i të drejtës dhe i dispozitës është i njohur, por personifikimi dhe ndarja e këtyre dy koncepteve, si dhe dallimi i vendburimeve të këtyre dy termave, është ndër problemet e një rëndësie të veçantë për të gjykuar në lidhje me këto dy terma. Kjo është arsyeja që fukahatë kanë thënë që i

vëmendshmi ka detyrim të bëjë dallimin sipas preferencës së vet, pasi për këtë çështje nuk ka një kriter përgjithësues."

Kushtet e efektit të lejimit

Kur lejimi realizohet sipas kushteve të kërkuara për lejimin, kontrata merr efektet e saj, plotësisht sikur të kishte dalë prej origjinalit, prej pronarit të vërtetë. Prej këtyre kushteve ka që gëzojnë fjalën e përbashkët të fukahave, kurse për disa prej këtyre kushteve, fukahatë kanë mendime të ndryshme. Në vijim le t'i shikojmë këto kushte, në mënyrë të detajuar:

1- Fukahatë e Medh'hebit Imamij (Xhaferij) ndajnë një fjalë të përbashkët se lejimi është i vlefshëm, kur del vetëm prej atij që ka të drejtë ta nënshkruajë kontratën. Më sipër është folur për këtë çështje.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se në efektin e lejimit merret në konsideratë njohja e detajuar që ka lejuesi për dy shtyllat e kontratës, plotësisht ashtu siç është njohja që kanë dy kontraktuesit për këto dy shtylla. Me një fjalë: dispozita e lejimit në fillim, është dispozita e shitjes.

3- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se lejimi, detyrimisht, duhet të jetë në përputhje me kontratën që është vedlejimi në lidhje më mallin e me çmimin, sepse malli e çmimi janë dy shtyllat e kontratës. Kur elfuduliji shet shtëpinë e Zejdit, nuk ka kuptim lejimi për shitjen e kopshtit, ose, kur ai e shet për një mijë, nuk ka kuptim lejimi për shitjen me dy mijë. Por kur *el fuduliji* shet bashkë, shtëpinë dhe kopshtin e Zejdit, për dymijë,

kurse për rastin kur Zejdi ka lejuar vetëm shitjen e shtëpisë për një mijë, shejkhu El Ensarij ka thënë: "Thënia më e fortë është lejimi dhe blerësi ka të drejtën e përzgjedhjes për të bërë pjesëtimin e transaksionit."

Me lejen e Allahut të Lartësuar, për përzgjedhjen, do të flitet në kapitullin përkatës. E njëjtë me këtë çështje është rasti kur elfuduliji shet për Zejdin e për Amrin, por njëri prej këtyre të dyve e lejon shitjen, kurse tjetri nuk e lejon.

Sikur *el fuduliji* të shesë me kusht, kurse pronari e lejon shitjen pa kushtin, atëherë shikohet: Nëse kushti është kusht për sendin e shitur dhe prej cilësive të sendit, si për shembull, ai shet një rrobë me kusht që ajo të jetë prodhim vendi, por pronari e lejon shitjen pa këtë kusht, atëherë lejimi bie, sepse sendi që shitet është një gjë, kurse lejimi është i varur me një send tjetër. Në këtë rast, zgjedhja për të bërë ndarjen është e pamundur për shkak të unitetit të objektit, edhe atëherë kur kushti nuk është i kufizuar me sendin e vënë në shitje, pasi ai send është jashtë këtij kufizimi. Shembull: *El fuduliji* e shiti stofin, me kusht që qepjen ta bëjë pronari, i cili lejon shitjen pa qepjen. Nëse çështja e kushtit qëndron kështu siç u përshkrua, qoftë lejimi, qoftë shitja, janë të vlefshëm dhe çmimi pjesëtohet në mënyrë proporcionale. Gjithashtu, për blerësin është saktësuar e drejta e përzgjedhjes për shkak të shumëllojshmërisë së objektit. Për këtë lloj shitje, fukahatë janë shprehur se kemi të bëjmë me një lloj kushtëzimi brenda kushtëzimit. Gjithashtu, ata janë shprehur për këtë lloj me shumëllojshmërinë e sendit të kërkuar.

4- Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre: A është kusht në efektin e lejimit që më parë të jetë refuzimi nga ana e pronarit, në

atë mënyrë se, kur ai refuzon dhe pastaj e lejon, ky lejim a është i gabuar?

Shejkhu El Ensarij është shprehur se ky kusht është i detyrueshëm, sepse në këndvështrimin e tij, refuzim do të thotë prishje e kontratës dhe prishja nuk pranon lejim.

Autori i librit "Bulgatul Fakijh" pretendon se fjala e përbashkët e juristëve të fesë është kundër kësaj thënieje.

Një grup fukahash, ndër të cilët Sej'jid El Jezdij, shejkhu El Isfehànij, në margjinaturat *(hàshijeh)* që kanë shkruar për librin "El Mekàsib", si dhe Sej'jid El Hakijm, në librin "Nehxhul Fukàhah", kanë thënë: "Refuzimi nga ana e pronarit, nuk e prish kontratën e elfudulijit dhe nuk ndalon as lejimin e as efektin e lejimit, për shkak se kontratën e prish heqja dorë nga ana e propozuesit prej ofertës që ai propozon para pranimit të pranuesit, kurse pranuesi ka të drejtën e refuzimit, por pas refuzimit ai pranon, përderisa oferta qëndron. Kur kjo është e vlefshme për analogji me pranuesin, akoma më shumë është e vlefshme në raport me lejuesin.

Fukahatë e kanë nxjerrë këtë argumentim prej transmetimit që ka përcjellë Muham'med bin Kajsi prej Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili tregon se Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka gjykuar për një robëreshë, të cilën e shiti djali i pronarit të saj në mungesë të babait të tij. Ai që e bleu, kërkoi që ajo të lindte djalë për atë dhe ajo lindi prej tij. Kur u kthye pronari i saj i parë, e ngriti çështjen për gjykim te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe tha: "*Skllaven time e shiti djali im pa lejen time.*"

Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Sentenca është: I pari merr skllaven e tij dhe djalin e saj."* Por i dyti kërkoi të bëhej pjesëtimi. Atëherë Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha atij: *"Që të ekzekutohet shitja në favorin tënd, merr djalin e tij, atë që të shiti ty skllaven."* Kur babai i djalit që shiti skllaven u gjend para këtij gjykimi, i tha blerësit të skllaves: *"Lëshoje djalin tim."* Ai iu përgjigj: *"Pasha Allahun! Nuk e lëshoj djalin tënd, derisa ti të lëshosh djalin tim." Kur babai i djalit që shiti skllaven e pa që çështja arriti deri në këtë cak, atëherë e lejoi shitjen e bërë."*

Shejkhu El Ensarij, duke pohuar saktësinë e këtij transmetimi, ka konstatuar vlefshmërinë e lejimit pas shitjes. Ai është shprehur: "Kjo dukuri është e shtruar për studim, ose është e komentueshme."

Në lidhje me çështjen e lejimit pas shitjes, unë nuk shikoj ndonjë rrugë për të shtruar këtë çështje për studim, ose për komentim, përveçse të shtroj fjalën e përbashkët të fukahave që lejimi nuk ka efekt pas refuzimit.

Megjithatë, kjo thënie nuk mund të shtrohet për faktin e thjeshtë se ajo nuk ekziston. Edhe sikur të supozojmë se ajo ekziston, nuk është argument, sepse te imamitë, fjala e përbashkët e dijetarëve të fesë është argument me të cilin veprohet, vetëm kur bëhet e qartë plotësisht se ai argument është prej mendimeve të Imamit të ruajtur *(ma'sùm)*. Kjo do të thotë se, kur fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, në lidhje me një çështje të caktuar, patjetër që janë bazuar mbi ndonjë ajet të Kur'anit, ose mbi ndonjë transmetim, ose mbi ndonjë rregull. Ndryshe fjala e përbashkët e fukahave nuk merret në konsideratë.

Është e qartë se dituria e zbuluar prej mendimit të Imamit të ruajtur nuk mund të qëndrojë bashkë me një hamendësim të kundërt, për faktin se ne mendojmë, ose hamendësojmë, nëse nuk e dimë se ata fukaha që ndajnë një fjalë të përbashkët në sentencën e tyre, janë bazuar në mosvlefshmërinë e lejimit, kur mendohet se kontrata e elfudulijit është pa vlerë, kur ajo është lidhur krahas me refuzimin. Me fjalë të tjera, thjesht dyshimi që fjala e përbashkët e dijetarëve zbulon mendimin e Imamit të ruajtur prej mëkateve, në themel e rrëzon atë fjalë dhe ekzistencën ose mosekzistencën e kësaj fjale të përbashkët *(ixhmau)* e bën të barabartë.

Nisur nga ky përfundim, te shiiat Imamij për *ixhmaun* nuk ka vend, përveç rastit kur gjykimi, me fjalën e përbashkët bazuar mbi spontanitetin, arrin cakun e domosdoshmërisë fetare, si për shembull, obligimi për agjërimin e për faljen e namazit, për të cilat s'është e nevojshme të sillet ky lloj argumenti dhe as për ndonjë argument tjetër, sepse për argument kanë nevojë teoritë dhe jo çështjet taksative.

5- A është e detyrueshme për atë që ka të drejtën e lejimit të lejojë ose të refuzojë menjëherë, apo për atë nuk lejohet vonimi, kur ai mëson për kontratën e lidhur prej elfudulijit? Pastaj kur ai e shtyn lejimin e refuzimin, domethënë, as nuk e lejon e as nuk refuzon shitjen, derisa dëmtohet origjina për të cilën është lidhur kontrata me *el fudulijin*, cili është gjykimi?

Përgjigje: Nuk ka argument që e bën të detyrueshëm nismën për lejim ose për refuzim të menjëhershëm. Madje argumenti ekzistues tregon të kundërtën. Transmetimi i mësipërm i Muhamed bin Kajsit tregon se lejimi erdhi pas kundërshtimit dhe ngritjes së shitjes për gjykim, por si bazë s'ka argument që e

bën të detyrueshëm lejimin ose refuzimin, sepse kontrata e *el fudulijit* nuk e bën të detyrueshme të drejtën për pronarin fillestar dhe as nuk e detyron atë me ndonjë send. Me fjalën "fillestar" qëllimi është për palën që lidhi kontratë me *el fudulijin*, pasi ai ka të drejtë të heqë dorë prej kontratës para se ta lejojë pronari. Në lidhje me këtë çështje janë shprehur Sej'jid El Jezdij dhe shejkhu El Isfehanij, që janë bazuar mbi supozimin se origjinali është i detyruar të lidhë kontratën. Kjo del qartë prej shprehjes së shejkhut El Ensarij, i cili ka thënë se pronari fillestar ka të drejtë të bëjë zgjedhjen për të prishur kontratën, me qëllim që të sprapsë dëmtimin.

Marrja në dorë dhe lejimi i kontratës

Padyshim që lejimi për kontratën është një gjë dhe lejimi për të futur në dorë çmimin ose mallin është një gjë tjetër. Kur *el fuduliji* shet pasurinë e tjetrit dhe pronari e lejon shitjen, në të vërtetë, ky lejim nuk nënkupton se lejimi është në favor të *el fudulijit* që ai të fusë në dorë çmimin, pasi futja në dorë e çmimit ka nevojë për një leje të pavarur nga lejimi për shitjen. Sikur blerësi t'i paguajë çmimin *el fudulijit*, siguria mbetet mbi blerësin dhe ai është përgjegjës për çmimin para pronarit. E njëjta gjë është edhe kur *el fuduliji* ble për një tjetër, me kusht që lejimin e bën personi për të cilin u bë blerja, sepse nuk i lejohet shitësit t'i dorëzojë elfudulijit mallin pa lejen e lejuesit.

Në përgjithësi, lejimi i kontratës nuk tregon as nga afër e as nga larg lejimin e *el fudulijit* për të futur në dorë çmimin ose mallin.

Lejimi është zbulues apo është transferues?

Më sipër u tha se vendlejimi është kontrata dhe me fjalën e përbashkët të atyre fukahave që janë shprehur për vlefshmërinë e kontratës së *el fudulijit*, rezulton se kontrata, së bashku me lejimin, pasohet prej të gjitha ndikimeve e detyrimeve të kontratës. Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me kohën e këtyre ndikimeve, fillimin e daljes së tyre dhe sa të bazuara janë ato në kontratë: A renditen ndikimet mbi kontratën apo ato i atashohen kontratës, që në kohën e ndërtimit të saj e daljes së kontratës prej *el fudulijit*, në atë mënyrë që lejimi ndjek kontratën, plotësisht si prokurimi paraprak.

Në këtë gjendje, ky lejim quhet lejim zbulues, sepse ai zbulon një pasuri të vërtetuar paraprakisht, apo lejimi është transferues i pasurisë, që prej kohës që ka dalë lejimi dhe jo që prej kohës së ndërtimit të kontratës, plotësisht ashtu siç është, kur kontrata është brenda kushteve të saj?

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se lejimi është zbulues dhe nuk është transferues. Një grup fukahash, ndër të cilët edhe Sej'jid El Jezdij kanë thënë: "Po, lejimi është transferues dhe jo zbulues."

Nuk ka ndonjë problem të tregojmë kuptimet e termit zbulues, ashtu siç ka ardhur në librin "El Mekasib" dhe në margjinaturat *(hàshijeh)* e këtij libri…

Kuptimi i parë: Lejimi zbulon se kontrata e lejuar ishte shkaku i plotë për renditjen e efekteve mbi kontratën.

Kuptimi i dytë: Zbulimi është hipotetik, që do të thotë se lejimi zbulon se, kur pronari ka dijeni për kontratën e *el fudulijit*, patjetër që ka miratuar veprimin e tij, kurse lidhësja "sikur" është krahasim për kontratën që në kohën e ekzistencës së saj.

Kuptimi i tretë: Sipas shprehjes së fukahave, zbulimi është tjetërsues. E kanë komentuar këtë lloj zbulimi duke shpjeguar se lejimi zbulon që kontrata është tjetërsuar dhe është bërë efektive nga e para.

Kuptimi i katërt: Zbulimi është definitiv, ose zbulimi është zbritës, në kuptimin se lejimi zbulon ekzistencën e pasurisë në kohën e lidhjes përfundimtare të kontratës, ose është zbritës për atë pasuri për të cilën nuk ka të vërtetë dhe realitet. Pasuria e vërtetë ndodh në kohën e lejimit, kurse ndikimet e lejimit ndodhin mbi kontratën, duke gjykuar ekzistencën e saj në atë kohë si të vërtetë.

Kuptimi i pestë: Lejimi të jetë kusht i vonuar që ka ndikim edhe mbi atë që ishte para vonimit. Ky lloj ndikimi, në fakt, është obligimi me ndikimet e kontratës që prej daljes së saj.

Sej'jid El Jezdij ka thënë: "Kjo është edhe fjala e fukahave më të dëgjuar."

Këtë fjalë ai e ka përzgjedhur fare qartë në librin "El Xheuahir".

Për sa i përket argumentit të zbulimit, që është lejimi i kontratës, nuk do të thotë lejimi i fjalës së zhveshur prej ndikimeve të saj, ndryshe nuk bëhet e detyrueshme mbajtja e besës për kontratën, sepse ajo për të cilën s'ka ndikim, për atë

kontratë s'ka as besëmbajtje. Por dimë se kontrata e elfudulijit ka ndikime.

Gjithashtu, dimë se nuk është detyrueshme të qëndrohet në besën e kontratës së elfudulijit, për shkak se ajo kontratë nuk ka miratimin. Vetëm atëherë kur pronari shpreh miratimin e tij dhe e lejon shitjen e bërë me kontratën e lidhur, atëherë ajo kontratë bëhet e detyrueshme që prej kohës që është lidhur.

Pra, në këtë rast, miratimi është kusht i vonuar, që do të thotë se vonimi i miratimit, në mënyrë absolute, nuk sjell dëm mbi kontratën; sepse vonimi i kushtit prej kushteve të kërkuara dhe pengesa ndër pengesat ekzistuese, janë vetëm për sendet e natyrës e për mangësitë e vërteta që ato sende mund të kenë, kurse në konsideratat ligjore dhe në ato të traditës, nuk ka pengues. Thënë ndryshe: Lejim do të thotë miratim për përmbajtjen e kontratës, pasi përmbajtja e kontratës nuk është gjë tjetër veçse marrëveshje për transferimin e dy sendeve të kompensueshme në kohën e lidhjes së kontratës."

Dallimi mes zbulimit e transferimit

Fukahatë kanë përmendur ndikimet e dallimit mes transferimit e mes zbulimit, madje për këto dallime janë shprehur fukahatë më të dëgjuar. Prej dallimeve kemi:

1- Rritja e ndarë prej mallit dhe prej çmimit. Rezultati mes kontratës dhe lejimit do të jetë për atë ku transferohet sendi dhe jo për atë prej të cilit transferohet. Është kështu kur flasim për zbulimin. Por është e kundërta kur flasim për transferimin.

Patjetër që këtu ka efekte që renditen mbi një lloj të veçantë të pasurisë. Le ta ilustrojmë këtë çështje me një shembull: Supozojmë se blerësi kishte taksur sikur të kishte në pronësi X pasuri, ai do të bënte një bamirësi të caktuar, por e taksura largohet te një tjetër pasuri që ai e mori në pronësi me kontratën e *el fudulijit* para lejimit.

E njëjta gjë është edhe në rastin e shikimit të një gruaje për të cilën kontratën e martesës e ka bërë *el fuduliji*. Në këtë rast, ndikimi i kësaj kontrate nuk është për *el fudulijin*. Nëse dihet që lejimi është marrë, atëherë kjo kontratë martesë patjetër që është e lidhur.

2- Bazuar mbi çka u tha për zbulimin, për palën fillestare te i cili u krye transferimi i mallit, lejohet që ai të veprojë me atë mall, kur ai e di se është lejimi, atëherë kontrata ndodh patjetër. Por nëse ai ka dyshim për këtë mall, atëherë ai nuk vepron me atë send, sepse, në bazë, kemi mospasjen e lejimit. Ndërsa bazuar në ato që u thanë, në lidhje me transferimin, në mënyrë absolute, atij nuk i lejohet të veprojë me atë mall, madje edhe atëherë kur dihet se pronari do ta lejojë.

3- Bazuar mbi zbulimin, pronarit fillestar që lidh kontratë me *el fudulijin* nuk i lejohet ta prishë kontratën, por ai heq dorë prej saj para lejimit, kurse bazuar mbi transferimin, kjo për atë është e lejuar.

4- Sikur *el fuduliji* të lidhë kontratë martese për një grua me një burrë, i cili e ka haram të martohet me atë grua, sepse ajo rezulton të jetë motra e personit për të cilin lidhet kontrata e martesës, në këtë rast, bazuar mbi atë që u tha për zbulimin, kemi

të bëjmë me vërtetimin për krushqi të njëanshme. Por nuk është haram, bazuar mbi ato që u thanë në lidhje me transferimin, prandaj kontrata e burrit për martesë me motrën, rezulton se ai heq dorë prej kontratës që lidhi *el fuduliji*.

5- Bazuar mbi sa u tha për zbulimin, supozojmë: Sikur të vdesë pronari fillestar që lidhi kontratë me *el fudulijin* para lejimit, malli për të cilin u lidh kontrata i kalon trashëgimtarëve së bashku me lejimin e pronarit të atij malli, kurse bazuar mbi ato që u thanë, në lidhje me transferimin, kontrata prishet dhe për lejimin nuk mbetet vend të flitet.

6- Bazuar mbi atë çka u tha, në lidhje me zbulimin, sikur zekati të jetë i varur me një mall konkret, gjatë kohës ndërmjet kontratës e lejimit, atëherë zekatin e jep personi për te i cili u bë transferimi. Duke u bazuar mbi ato që u thanë, në lidhje me transferimin, zekatin e jep personi prej të cilit u krye transferimi.

7- Kur flasim bazuar mbi ato që u thanë, në lidhje me zbulimin, në rast se një mangësi e mallit ndodh gjatë kohës ndërmjet kontratës dhe lejimit, nuk vërtetohet e drejta e zgjedhjes për refuzimin e kësaj të mete te ai që kalon malli, sepse e meta tani ndodhi mbi pasurinë e tij. Por kur flasim, bazuar mbi ato që thamë, në lidhje me transferimin, për atë vërtetohet e drejta e përzgjedhjes, sepse kjo e metë ka ndodhur në pasurinë e personit prej të cilit ajo u transferua.

8- Bazuar mbi zbulimin, tri ditët e të drejtës për përzgjedhjen e kafshës, llogariten që prej kohës së lidhjes së kontratës, kurse bazuar mbi transferimin, këto tri ditë të përzgjedhjes llogariten që prej kohës së lejimit.

9- Bazuar mbi zbulimin, kur malli është në ortakëri mes Zejdit e Amrit dhe elfuduliji shet pjesën e Zejdit dhe më pas Amri i shet pjesën e vet një tjetri, ndërkaq Zejdi e lejon shitjen që bëri *el fuduliji*, atëherë kjo pronë me dy pronarë, i takon atij që e ka blerë prej *el fudulijit*, kurse bazuar mbi transferimin, prona i takon Zejdit.

10- Bazuar mbi zbulimin, kur pronari fillestar ble një mall konkret prej *el fudulijit* dhe para lejimit e shet atë mall te një tjetër, kjo shitje është e vlefshme, sepse në këtë gjendje, është shitje e pasurisë së tij, por shitja nuk është e vlefshme bazuar mbi transferimin, sepse në këtë rast është shitje jo në pronësi.

* * *

REFUZIMI DHE DISPOZITAT E REFUZIMIT

Kuptimi i fjalës "refuzim"

Refuzim është shprehja e mosmiratimit për kontratën e elfudulijit, pra, është plotësisht e kundërta e lejimit. Heshtja dhe ngurrimi këtu e atje nuk është asgjë. Është e dukshme që për refuzuesin, në kontratë merret në konsideratë ajo çka vihet në konsideratë edhe për lejuesin, sepse gjithkush ka të drejtë të lejojë e të refuzojë, ose e kundërta, gjithashtu, vihet në konsideratë që kontrata të pranojë efekte, ndryshe ajo është e ngjashme me fëmijën që lind i vdekur.

Refuzimi vërtetohet me çdo gjë që tregon refuzim, fjalë, shkresë, ose veprim. Shejkhu El Ensarij e ka zgjatur shumë fjalën, në lidhje me punën e veprimin e ardhur pas kontratës së elfudulijit, si dhe para lejimit. Ai e ka ndarë këtë në veprim mohues të efektit të kontratës, në atë mënyrë që krahas me kontratën nuk mbetet më vend as për lejimin e as për refuzimin, si dhe në veprim jo mohues të efektit, madje së bashku me kontratën është e mundur lejimi dhe refuzimi.

Në vijim bëjmë një përmbledhje në lidhje me veprimin.

Veprimi mohues

Kur *el fudulij*, për shembull, i shet një dele dikujt, ndërkaq pronari i deles e ther atë dele dhe e ha, ose delja ngordh për shkak të ndonjë faktori qiellor para lejimit të shitjes, kontrata ka mbaruar së bashku me mosekzistencën e objektit të kontratës, sepse lejimi dhe refuzimi, në të vërtetë, ndodhin mbi një send që ekziston, kurse për sendin që nuk ekziston, nuk është logjike të flitet as për refuzim e as për lejim.

Pra, është e barabartë, qoftë kur ne flasim për zbulim, qoftë kur flasim për transferim. Shembull plotësisht i ngjashëm nga ana e dispozitës te ajo çfarë thotë shejkhu El Ensarij, shejkhu En Nàijnij dhe Sej'jid El Hakijm, është edhe rasti kur pronari e transferon sendin prej pasurisë së tij me shitje ose me dhurim, sepse në këtë gjendje, pronari bëhet i huaj për sendin konkret të shitur, kurse lejimi nuk transferohet prej pronarit te ai që e bleu sendin prej *el fudulijit*, sepse ky veprim, në mënyrë absolute, e prish kontratën, për pasojë nuk ka më vend as për lejim e as për refuzim.

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Ja kështu arrihet refuzimi me çdo veprim që e nxjerr atë prej pasurisë së tij me transferim, ose me asgjësim të pasurisë, ose me veprime të ngjashme[1] me transferimin dhe asgjësimin, siç janë lirimi i robit, shitja, dhurimi, martesa e të tjera veprime të ngjashme. Ajo që duket qartë, është fakti se veprimi i tij, pasi është bërë e detyrueshme vlefshmëria

[1] I ngjashëm me transferimin dhe asgjësimin është martesa, kur *el fuduliji* lidh kontratë martese për një grua me një burrë, ndërkaq ajo ka martuar veten me një burrë tjetër.

dhe veprimit, është i humbur për shkak të lejimit të qëllimit për daljen e atij sendi prej pasurisë së tij."

Veprim jo asgjësues për pasurinë

Kur pronari, para lejimit, bën një veprim jo asgjësues për pasurinë, si për shembull, kur e le atë peng, ose e jep me qira, ose nxjerr në shitje mallin që ka shitur *el fuduliji*, ky veprim a është mohim dhe prishës për kontratën, në atë mënyrë, që krahas këtij veprimi, lejimi është i pavlefshëm dhe refuzimi nuk ka më kuptim, për shkak se vihet në konsideratë që ky veprim është prej kategorisë së refuzimit të veprimeve të refuzuara dhe prishje e veprimeve të prishura.

Përgjigje: Kriteri përgjithësues i vendlejimit dhe i refuzimit është çdo burim në të cilin shitja është e vlefshme, gjithashtu është edhe vendi për lejim e për refuzim. Po kështu, çdo burim në të cilin shitja nuk është e vlefshme, nuk është vend as për lejim e as për refuzim. Në lidhje me sendin (pasurinë) e lënë peng, shitja e tij është e pavlefshme, sepse sendi i vënë në shitje duhet të jetë pronë e lirë, ashtu siç do ta shikojmë në kushtet e sendit të vënë në shitje. Bazuar mbi këtë sentencë, sendi i lënë peng është prishës për kontratën që lidh *el fuduliji* dhe është plotësisht si shitja e tij me kontratë.

Në lidhje me rastin, kur pronari e jep me qira sendin, në këtë rast, lejimi nuk e prish kontratën që ka lidhur elfuduliji, madje ajo mbetet vend për lejim e për refuzim, sepse qiradhënia as nuk e nxjerr sendin prej pronësisë së pronarit të tij, siç ndodh

me shitjen, as nuk e bën pasurinë të kushtëzuar, ashtu siç ndodh me sendin e lënë peng.

Kur pronari e lëshon me qira objektin ose sendin e tij dhe pastaj lejon kontratën që ka lidhur *el fuduliji*, lejimi është i vlefshëm dhe shitja plotësohet, ndërkaq blerësi ka të drejtë të marrë qiranë për llogari të tij, ose të prishë kontratën e qiramarrjes, sepse lejimi i kontratës ka zbuluar një pasuri me të cilën kishte vepruar një tjetër në vend të tij.

Rasti kur pronari e nxjerr në shitje sendin para lejimit ose para refuzimit, me fjalën më të qartë të fukahave do të shikohet: Nëse pronari ka dijeni për kontratën e *el fudulijit* dhe kjo i është vënë atij në dukje në kohën e ekspozimit të sendit për shitje, fakti i vënies në dukje është refuzim i kontratës, ndryshe, në mënyrë absolute, s'ka ndikim për ekspozimin për shitje, sepse s'ka asnjë veprim tregues që të shprehë refuzimin.

Pronari dhe blerësi

El fuduliji njihet, është personi që ndërhyn në punët e tjetrit në mënyrë parazitare. Thënë ndryshe, qëllimi këtu me *efudulij* është personi që shet mallin e tjetrit pa leje, kurse blerësi është pala që ka blerë mallin konkret prej *el fudulijit*, ndërsa pronari është ai që ka mallin (send ose pronë). Kur pronari e refuzon kontratën, ajo kontratë bëhet e paqenë dhe prishen të gjitha veprimet dytësore që rrjedhin prej asaj kontrate. Në qoftë se blerësi e ka marrë në dorë mallin ose sendin me anë të kontratës së lidhur prej *el fudulijit*, është i detyruar ta kthejë blerjen që bëri, me të gjitha përfitimet e dobitë. Nëse blerësi nuk e bën këtë,

atëherë pronari ka të drejtë t'ia marrë atij sendin ose pronën e blerë dhe blerësi do të paguajë edhe gjobën për të gjitha përfitimet që pati prej blerjes, sepse në konsideratë vihet që prona të mbetet te pronari i saj i parë.

Është pyetur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për një burrë që ka blerë në treg një robëreshë dhe ajo lind me blerësin. Më pas vjen kërkesa e atij që ka të drejtë mbi robëreshën, domethënë pronari i saj. Imam Sadiku *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* është përgjigjur: *"Robëreshën e merr pronari i saj dhe i kthen blerësit shumën e blerjes, si dhe çmimin për fëmijën që lindi robëresha."*, pra blerësi do të marrë shumën që ka shpenzuar për blerjen e robëreshës, plus shumën për fëmijën që pronari mori prej blerësit.

Blerësi dhe elfuduliji

Kur pronari kthen në dëm të blerësit dhe kërkon prej tij kthimin e sendit të blerë, kur sendi ekziston, ose i kërkon kompensimin, kur sendi është asgjësuar, në këtë rast, a ka të drejtë blerësi të kërkojë prej *el fudulijit* shumën që ai ka paguar për blerjen e sendit? Nëse supozojmë se ai e ka këtë të drejtë, a ka të drejtë blerësi të kërkojë më tepër se shpenzimet e bëra?

Kërkohet vetëm çmimi

Pyetja e parë është: A ka të drejtë blerësi të kërkojë prej *el fudulijit* vetëm çmimin? Përgjigjja e kësaj pyetjeje patjetër kërkon sqarime, të cilat po i japim më poshtë:

1- Blerësi nuk e di që shitësi është *el fuduliji*, prandaj gjykimi në lidhje me blerësin, është: Kur sendi ekziston, ai ka të drejtë të kërkojë kthimin e shumës që i ka paguar shitësit. Nëse sendi është asgjësuar, blerësi do të marrë ose kompensim fizik (një send të ngjashëm), ose do të marrë vlerën e atij sendi, sepse pavlefshmëria e kontratës kërkon që çmimi dhe sendi të mbeten secili në pronësi të pronarit. Nëse *el fuduliji* ka vënë dorë mbi çmimin e paguar, atë e përfshin rregulli: "Dora paguan atë çka mori, derisa ta kthejë të plotë."

2- Blerësi ble prej *el fudulijit* dhe e di se ai është *el fudulij*. Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se, në këtë rast, blerësi nuk ka të drejtë të kërkojë prej *el fudulijit* asgjë. Kjo është e barabartë, qoftë kur çmimi është, qoftë kur nuk është, sepse, në këtë rast, është blerësi ai që ka humbur të drejtën e tij, për shkak se ai e ka hedhur poshtë respektin për pronën e vet, duke i paguar *el fudulijit* pa marrë mallin, si dhe për faktin se blerësi e dinte se malli që ai merrte prej *el fudulijit* ishte pronë e një tjetri. Në këtë gjendje, blerësi është si ai që i dorëzon pasurinë e tij një të çmenduri, megjithëse e dinte se ai është i çmendur. Prandaj këtu nuk ka vend të zbatohet rregulli: "Dora paguan atë çka mori, derisa ta plotësojë.", sepse *el fuduliji* e ka marrë çmimin me lejen e blerësit, prandaj dora e tij nuk është garantuese.

Megjithëkëtë, blerësi ka të drejtë të kërkojë kthimin e çmimit prej shitësit *el fudulij*, nëse malli që ai bleu, ekziston, ose të kërkojë kompensim për mallin, nëse malli është asgjësuar. Madje ai ka të drejtë të kërkojë kthimin e çmimit, edhe nëse kishte dijeni për të vërtetën e shitësit, sepse vihet në konsideratë prishja e kontratës me refuzimin e pronarit. Pavlefshmëria e kontratës, në këtë rast, do të thotë se çdo njëri prej dy të shkëmbyeshmëve që

ekzistojnë pas kontratës, do të mbetet në pronësi të pronarit, plotësisht ashtu siç ishin edhe para kontratës.

Bazuar mbi këtë rregull, pronarit i lejohet të kërkojë prej blerësit, gjithashtu edhe blerësit i lejohet të kërkojë prej *el fudulijit*. Me fjalë të tjera, pas prishjes së kontratës, për pronarin e për blerësin lejohet të kërkojë prej atij që i ka marrë në pronësi pasurinë. Në qoftë se ne do të thoshim: Çmimi që futi në dorë elfuduliji prej blerësit është bërë hallall të jetë pronë e tij dhe ai të veprojë më këtë pronë si të dëshirojë, unë nuk mendoj që të ketë qoftë edhe një jurist *(fakijh)* të vetëm që të pohojë thënien tonë, duke ditur që *el fuduliji* i dorëzon blerësit mallin pa lejen e pronarit dhe, me këtë veprim ai është bërë rrëmbyes.

Në lidhje me atë që u tha se blerësi guxon të rrezikojë pasurinë e vet pa kërkuar të marrë gjë prej tij, kjo është një thënie që s'ka bazë, sepse, në fakt, blerësi i paguan shitësit me qëllim që të marrë prej tij, plotësisht ashtu siç ndodh në një shitje të rregullt. Pra, është sikur blerësi i ka vënë shitësit një kusht garantimi që ai t'i kthejë çmimin, kur mallin e merr pronari.

Në lidhje me këtë çështje, Sej'jid El Jezdij ka thënë: "Vihet në konsideratë se blerësi, në të vërtetë, paguan për të marrë mallin dhe jo që të largojë dorën e shitësit prej shumës që ai pagoi, sepse shitësi nuk kishte qëllim të përfitonte, por kishte qëllim thjesht një bashkëpunim të ndërsjellë të vërtetë.

Gjithashtu, edhe shitësi, tradicionalisht, nuk e diskrediton paprekshmërinë e pasurisë së tij që ta marrë tjetri falas. Në librin "Nehxhul Fukàhah" Sej'jid El Hakijm ndan të njëjtin mendim me Sej'jid El Jezdij dhe kanë nxjerrë argumentin, duke u bazuar mbi

rregullin: "Kush vë në pronësi mallin e tjetrit me një kontratë të gabuar, është i detyruar të bëjë garantimin."

Shejkhu El Ensarij, pas ngurrimeve e hamendësimeve, sipas zakonit të tij, ka thënë: "Referuar fukahave më të dëgjuar, në lidhje me çështjen tonë, rezulton se ajo nuk është e zhveshur prej paqartësive, pasi disa fukaha janë shprehur për garantimin që jep i korruptuari, kur asgjësohet ryshfeti që ai mori nëpërmjet çmimit të shitjes për të cilën po flasim."

Kjo do të thotë se i korruptuari mban përgjegjësi për ryshfetin që mori, duke e ditur që korruptuesi i ka paguar ryshfetin atij që s'kishte të drejtë ta merrte, po kështu është përgjegjës edhe shitësi për çmimin kur ai ia paguan atë një personi që nuk ka të drejtë ta marrë atë çmim.

Esenca e fjalës është: Kriteri në lidhje me kërkimin e çmimit prej shitësit, qëndron në faktin, kur e ka futur këtë çmim në dorën e tij me anë të një kontrate të gabuar.

Kërkohet më shumë se çmimi

Pyetja e dytë është: A ka të drejtë blerësi të kërkojë prej shitësit më shumë se çmimi? Për ta shpjeguar më qartë këtë pyetje, duhet të vëmë në dukje sa më poshtë vijon:

Më sipër u tha se blerësi kërkon prej shitësit çmimin që i ka paguar atij. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai ka dijeni, qoftë kur nuk ka dijeni për të vërtetën e shitësit. Pra, është e kundërta e asaj që kanë thënë fukahatë më të dëgjuar, të cilët e kanë reduktuar të drejtën e kërkimit vetëm kur ai nuk ka dijeni. Kjo është e qartë për

rastin kur blerësi i ka paguar pronarit çmimin e mallit të caktuar me kontratën e shitjes së *el fudulijit*.

Kur blerësi i paguan pronarit më shumë nga sa i ka dhënë *el uduliji* për mallin e blerë, a ka të drejtë blerësi të kërkojë prej shitësit elfudulij që ai t'i kthejë atij çmimin dhe shtesën e shpenzimeve që ai ka bërë? Përgjigjen për këtë çështje shejkhu El Ensarij e ka dhënë të detajuar si më poshtë:

1- Shtesa të jetë e lindur prej shtimit të vlerës së mallit mbi çmimin e caktuar që ai i pagoi shitësit. Shembull: Zejdi ble kalin e Amrit prej *el fudulijit* për dhjetë dirhemë. Më pas kali ngordh në dorën e blerësit dhe pronari nuk e lejon këtë shitje. Atëherë pronari ka të drejtë të kërkojë prej blerësit çmimin e kalit, jo çmimin e caktuar. Nëse supozojmë se çmimi i kalit ishte njëzet dirhemë, blerësi është i detyruar që këtë shumë (shtesë) t'ia paguajë pronarit të plotë. Por a ka të drejtë blerësi të kërkojë njëzet dirhemët prej shitësit, i cili e kishte marrë më parë këtë shumë prej blerësit, apo ai ka të drejtë të kërkojë prej tij edhe shtesën mbi shumën e çmimit?

Përgjigje: Blerësi nuk ka të drejtë të kërkojë prej shitësit njëzet dirhemë të plotë, por ai ka të drejtë të kërkojë atë çka ai ka shtuar mbi çmimin e caktuar. Për sa i përket shumës që i korrespondon çmimit, pra, dhjetë dirhemë, ai s'ka të drejtë të kërkojë dhjetë dirhemët prej shitësit, sepse blerësi, që kur e pagoi atë shumë, kishte vënë në konsideratë edhe ngordhjen e kalit. Pra, kemi të bëjmë plotësisht me rastin sikur ai e ka blerë atë mall prej vetë pronarit, që do të thotë se, në këtë rast, mashtrimi nuk është realizuar në raport me dhjetë dirhemët që i korrespondojnë çmimit, ndërsa për shtesën blerësi nuk e kishte vënë në

konsideratë që të rrezikonte. Në këtë gjendje, shitësi është mashtruesi dhe dëmtuesi, prandaj ai është i detyruar të mbajë përgjegjësinë për dëmin e për mashtrimin.

Për të sqaruar më mirë çështjen e shtesës, theksojmë se fjala e shejkhut El Ensarij nuk ka të bëjë me dhjetë dirhemët që blerësi i pagoi shitësit për çmimin e kalit, ndryshe blerësit do t'i duhej të paguante çmimin dy herë, një herë shitësit dhe një herë për vetë blerësin. Në të vërtetë, çmimi i caktuar kthehet te blerësi pa asnjë studim.

Por ne kemi përmendur termin "çmim i caktuar" dhe këtë e kemi bërë për të shpjeguar se blerësi nuk ka të drejtë të kërkojë prej shitësit, por ka të drejtë të kërkojë prej tij vetëm aq sa është më shumë se çmimi.

Përfundimisht, rezultati është: Kur blerësi paguan njëzet dirhemë për kalin, ai humb vetëm dhjetë dirhemë. Kjo është shuma me të cilën atë nuk e mashtron shitësi, sepse edhe shitësi humb dhjetë, për shkak të mashtrimit që i bëri blerësit, duke e shtuar këtë shumë mbi çmimin.

2- Blerësi i paguan pronarit kompensim për dobitë që fitoi prej mallit që i bleu shitësit. Në lidhje me këtë çështje, shejkhu El Ensarij dhe një grup fukahash të mëdhenj kanë thënë se blerësi ka të drejtë të kërkojë prej shitësit shumën që i pagoi pronarit, sipas rregullit: "I mashtruari kërkon prej atij që e mashtroi."

3- Blerësi shpenzon për mallin që mori në dorëzim prej shitësit, si për shembull, barin që ushqen kalin. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë një fjalë të përbashkët se këtë shpenzim

blerësi ka të drejtë ta kërkojë prej shitësit, gjithnjë bazuar mbi rregullin e mashtrimit.

Qarkullimi nëpër disa duar

Kjo çështje lidhet ngushtësisht me studimin e çështjes së rrëmbyesit dhe *el fudulijit*. Këtë çështje fukahatë e kanë emërtuar "Qarkullimi nëpër shumë duar". Ky qarkullim del qartë, kur rrëmbyesi e transferon sendin e grabitur te një tjetër, ose *el fuduliji* ia dorëzon sendin e vënë në shitje blerësit pa lejen e pronarit, për pasojë me këtë veprim edhe ai bëhet rrëmbyes. Më pas blerësi ia shet këtë send një blerësi të dytë. Fukahatë kanë folur në lidhje me këtë çështje dhe janë shprehur se pronari ka të drejtë të kërkojë prej atyre që e kanë qarkulluar pasurinë e tij nëpër duart e tyre dhe, vetëm pasi sendi i kthehet pronarit, duart që e kishin marrë atë send, kanë të drejtë të kërkojnë prej njëri-tjetrit, të gjithë vlerën e sendit ose një pjesë të vlerës, në qoftë se në kohën kur pronari e kërkon, sendi ekziston, ose është asgjësuar.

Në radhë të parë, dëshirojmë të sjellim në kujtesë dy rregullat për të cilat fukahatë janë në pajtueshmëri mes tyre. Këto dy rregulla janë: "I mashtruari kërkon prej atij që e mashtroi" dhe rregulli tjetër: "Kushdo që fut në dorë pasurinë e tjetrit, është i detyruar t'ia kthejë atij, kur ajo pasuri vazhdon të ekzistojë. Kur ajo është asgjësuar, e kompenson me një të ngjashme, ose i paguan atij vlerën e pasurisë, me përjashtim të rastit kur pasuria është lënë në dorën e tij në mirëbesim dhe nuk është asgjësuar për shkak se mbi atë pasuri është vënë dorë, ose për shkak shkujdesje e keqpërdorimi."

Pronari dhe duart që e qarkulluan

Kur malli i rrëmbyer qarkullon nëpër disa duar dhe vazhdon të ekzistojë, pronari ka të drejtë të përzgjedhë: Nëse dëshiron e kërkon prej atij që e ka në dorë dhe, kur ai e merr në dorëzim mallin e vet, të gjitha duart shkarkohen prej përgjegjësisë. Nëse pronari dëshiron, e le në dorën e atij që e ka. Në qoftë se pronari e ndjek vetë kërkimin e mallit të tij te ai që mund ta ketë në dorë, pasi e gjen, menjëherë e merr mallin prej tij, qoftë edhe duke ngritur padi kundër tij, sepse në këtë rast, dora te e cila u gjend malli, është bërë person që ka lidhje, domethënë se përgjegjësia e rrëmbimit bie mbi këtë dorë për shkak se sendi i rrëmbyer u gjend në atë dorë. Pikërisht kjo përgjegjësi e detyron atë të ndjekë sendin kudo që ai të gjendet, me qëllim që t'ia kthejë pronarit.

Këtu lind pyetja: Në të vërtetë, e drejta e pronarit ka lidhje me sendin dhe jo me mirëbesimin, derisa sendi vazhdon të ekzistojë, por, kur sendi asgjësohet, e drejta e pronarit ka lidhje me garantimin për paprekshmërinë e pasurisë së tij dhe jo me sendin konkret. Nuk ka dyshim se dhënia e së drejtës për pronarin që ai të kërkojë mallin e tij prej atij që i gjendet në dorë, do të thotë se pronari ka të drejtë të pretendojë se e drejta e tij ka lidhje me sendin konkret dhe jo me garantimin. Dhënia e së drejtës për pronarin që ai të kërkojë prej një tjetri te i cili pasuria e pronarit ra në dorën e tij prej rrëmbyesve, nënkupton që sendi të jetë asgjësuar.

Pra, në këtë rast, e drejta e pronarit është e lidhur me garantimin për paprekshmërinë e pasurisë dhe jo me sendin,

pikërisht këtu qëndron kontradikta e mirëfilltë, plus bashkimin mes kompensimit dhe sendit të kompensueshëm.

Përgjigje: Dallimi mes garantimit në ruajtje dhe garantimit në mirëbesim qëndron në faktin se garantimi në ruajtje, në të shumtën e herëve, ka lidhje me sendin konkret, si për shembull, garantimi i kredisë së zakonshme, garantimi për sendin e shitur, kur rezulton se i takon një tjetri, në atë mënyrë që sendin e kompenson garantuesi, kur sendi i garantuar asgjësohet, ose kur marrja e atij sendi në pronësi ndalohet për ndonjë shkak prej shkaqeve.

Garantimi në mirëbesim ka lidhje me pasuritë e qëndrueshme në llogarinë e borxhlinjve. Garantimi në të cilin nuk bashkohet lidhja me të drejtën e pronarit mbi sendin konkret, është garantim në mirëbesim, kurse garantimi në ruajtje bazohet mbi pajtueshmërinë.

Kushdo që ka futur në dorën e tij pasurinë e tjetrit, në atë mënyrë që i mundëson atij të vendosë për atë pasuri, qoftë edhe gradualisht, në të vërtetë, ajo pasuri ka hyrë në ruajtjen e tij dhe ai është bërë përgjegjës për atë pasuri. Për pasojë ai është i detyruar ta kërkojë atë kudo që ajo të gjendet, derisa vazhdon të ekzistojë. Nëse ajo pasuri asgjësohet, ai është i detyruar ta kompensojë atë, madje edhe atëherë kur ajo pasuri ka dalë prej dorës së tij dhe ka kaluar në dorën e një tjetri. Është e kuptueshme se, kur kjo pasuri qarkullon nëpër shumë duar, të gjithë këta mbajnë përgjegjësi, por përgjegjësia e tyre është rrugë zëvendësimi e mjaftueshmërie, që do të thotë: Nëse përgjegjësinë e mbajnë disa, shkarkohen të gjithë prej përgjegjësisë.

2- Kur sendi asgjësohet në dorën e ndonjërit prej tyre, pronari bën zgjedhjen e tij: kërkon kompensim të plotë prej cilit të dëshirojë prej atyre që e kishin marrë sendin në pronësi, ose, nëse pronari dëshiron, e shpërndan kompensimin mbi të gjithë, në mënyrë të barabartë ose në mënyrë të diferencuar, sepse kërkimi i kompensimit të plotë vetëm prej njërit, nënkupton se kërkimi i kompensimit prej disave ka më shumë përparësi.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë veshje, madje është e mundur arritja e fjalës së përbashkët të fukahave, se çdo njëri prej tyre është rrëmbyes dhe person që mund t'i drejtohesh drejtpërdrejt për kthimin e sendit, ose për kthimin e një të ngjashmi me sendin.

Për këtë çështje kemi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "*Çdo gjë e rrëmbyer, kthehet.*", si dhe hadithin: "*Dora është e detyruar të përgjigjet për atë çka mori, derisa ta kryejë të plotë. Nuk ka dallim në lidhje me kalimin e sendit nëpër disa duar për garantimin me një kontratë të prishur, ose me një kontratë tjetër.*"

Duart që morën sendin janë së bashku njëra me tjetrën

Në paragrafin e mësipërm folëm për dispozitën që trajton çështjen e pronarit, në lidhje më ata që futën në dorë pasurinë e tij, kurse në këtë paragraf do të flasin për dispozitën që trajton çështjen e personave që futën në dorë atë send ndaj njëri-tjetrit. Le të supozojmë që sendi ka qarkulluar nëpër tri duar, si për shembull, ishte në dorën e Zejdit, pastaj prej tij kaloi në dorën e Amrit, më pas prej Amrit sendi kalon në dorën e Halidit. Në dorën e këtij të fundit, sendi asgjësohet. Bazuar mbi këtë supozim,

gjykohet se njëri prej këtyre të treve është i mashtruar prej tjetrit, ose në mesin e tyre s'ka asnjë të mashtruar, por që të gjithë janë rrëmbyes. Në qoftë se në mesin e tyre ka një të mashtruar dhe pronari e kërkon prej tij, me fjalën e përbashkët të fukahave, ky i mashtruar ka të drejtën e plotë të kërkojë nga ana e tij prej atij që e mashtroi.

Shembull: Sikur Amri ta ketë blerë sendin prej Zejdit, duke ditur se është pronë e Zejdit dhe pronari e kërkon sendin prej Amrit, në këtë rast, Amri ka të drejtë të kërkojë sendin prej Zejdit, duke u bazuar te fjala e përbashkët e fukahave: "I mashtruari kërkon prej atij që e mashtroi." Kështu qëndron çështja, edhe kur pronari e kërkon sendin prej Halidit dhe Halidi është mashtruar prej Amrit.

Në këtë gjendje, Halidi ka të drejtë të kërkojë sendin prej Amrit.

Në rastin kur ka mashtrim, i treti mund të kërkojë prej të dytit dhe i dyti mund të kërkojë prej të tretit, sepse mashtruesi është personi prej të cilit transferohet sendi, kështu që i mëparshëm është mashtruesi dhe i mashtruari është personi te i cili kaloi sendi, prandaj ky i fundit është pasues. Pikërisht ky fakt është edhe kuptimi fjalës së fukahave: "Pasuesi e kërkon prej të mëparshmit, kur i mëparshmi e ka mashtruar atë."

Kur në mesin e duarve që futën sendin në dorë nuk ka të mashtruar, por të gjithë janë rrëmbyes, çështja qëndron plotësisht në të kundërtën e kësaj që u tha, domethënë, që i mëparshmi e kërkon prej pasuesit dhe pasuesi nuk kërkon prej të mëparshmit. Atëherë, kur pronari e kërkon prej Zejdit, i cili është i mëparshëm

ndaj Amrit, për pasojë të mëparshmërisë, Zejdi i paguan pronarit një zëvendësues të sendit (kompensim fizik të ngjashëm).

Në këtë gjendje Zejdi ka të drejtë të kërkojë prej Amrit, i cili për Zejdin është pasuesi i dytë që i kërkon Amrit atë çka i pagoi pronarit, duke i thënë se unë me dorën time e dorëzova sendin, prandaj ma kthe atë, ose më kompenso. Kjo është një e drejtë që i takon Zejdit, sepse, kur ai i pagoi pronarit të drejtën që i takonte të merrte, në të vërtetë, ai e pagoi atë në vend të Amrit dhe mori cilësinë e tij. Kur pronari e kërkon prej të dytit, që në rastin tonë është Amri, Amri ka të drejtë të kërkojë prej Halidit, plotësisht ashtu siç ishte e lejuar për Zejdin, që të kërkojë prej Amrit. Amrit nuk i lejohet të kërkojë prej Zejdit, sepse Zejdi nuk e mori sendin prej Amrit. Pra, është e kundërta, domethënë se Amri e mori sendin prej Zejdit dhe vetë Zejdi e mori prej pronarit.

E njëjta gjë është edhe rasti kur pronari e kërkon prej të tretit, që në shembullin tonë është Halidi dhe Halidi nuk ka të drejtë të kërkojë prej Amrit, sepse Halidi e mori sendin në dorëzim prej Amrit dhe Amri nuk e mori atë në dorëzim prej Halidit. Duhet të tërheqim vëmendjen se në këtë rast nuk ka të mashtruar. Me një fjalë: Raporti i të parit ndaj të dytit dhe raporti i të dytit ndaj të tretit, është plotësisht si raporti i pronarit ndaj të parit, sepse i pari është ai që e rrëmbeu sendin prej pronarit, ndërsa i dyti e rrëmbeu prej të parit dhe i treti e rrëmbeu prej të dytit, por rrëmbyesi që i rrëmben rrëmbyesit është rrëmbyes. Rezultati përfundimtar për këtë shembull është: Siguria, në fund të fundit, qëndron mbi personin në dorën e të cilit është asgjësuar sendi.

Përmbledhje

Në përmbledhje do të themi: Kur midis personave, nëpër të cilët kalon sendi nga njëri te tjetri, ka të mashtruar, në çast sigurimi është te i mashtruari, që do të thotë: Nëse pronari e kërkon sendin prej këtij të mashtruari, nga ana e tij, i mashtruari e kërkon prej atij që e mashtroi, por kur në mesin e tyre s'ka të mashtruar, atëherë sigurimi mbetet mbi personin te i cili u asgjësua sendi, në atë mënyrë që, kur pronari të kërkojë sendin prej tij, prej sendit nuk ka mbetur asgjë dhe, kur ai e kërkon prej atij që e kishte sendin më përpara, të mëparshmit i lejohet të kërkojë prej atij që e kishte më vonë, derisa të përfundojë vargu i personave nëpër duart e të cilëve qarkulloi sendi te i fundit, në dorën e të cilit ndodhi asgjësimi i sendit.

S'ka dyshim se asgjësimi i sendit në dorën e atij që e ka në dorë, është shkak për sigurimin në favor të pronarit që të marrë një send tjetër të ngjashëm ose të marrë vlerën e sendit.[1]

Kur pronari e merr mjaftueshëm të drejtën prej atij në dorën e të cilit u asgjësua sendi, personat e tjerë që kishin në qarkullim këtë send, nuk i kërkojnë gjë njëri-tjetrit, për shkak se nuk ka obligues. Kur pronari e merr të drejtën e vet jo prej dorës në të cilën u asgjësua sendi, në këtë rast, ky tjetri merr pozitën e pronarit për të kërkuar zëvendësuesin e sendit, sepse është e detyrueshme që sigurimi është mbi personin në dorën e të cilit u asgjësua sendi, prandaj ky zëvendësues i sendit patjetër duhet të

[1] Shkaqet e sigurimit janë tri: menjëherë pas asgjësimit, si për shembull ai që thyen enën e tjetrit, shkak me pasojë, si për shembull, dikush hap një gropë në një rrugë publike në të cilën bie një kalimtar. Gjithashtu, prej shkaqeve është edhe mashtrimi, si ai që fut në dorë mallin e tjetrit dhe ai mall asgjësohet për shkak të ndonjë faktori atmosferik, ose për shkak të ndonjë faktori tjetër.

ketë një pronar, i cili, në këtë rast, nuk është logjike të jetë pronari i sendit që tashmë e mori të drejtën që i takonte, duke ditur se e drejta është një, kështu që për këtë send zëvendësues nuk ka mbetur pronar tjetër përveç asaj të drejte që pronari e mori të plotë prej tij.

Me një fjalë të shkurtër përgjithësuese profilaktike: Sigurimi rëndon mbi personin në dorën e të cilit u asgjësua sendi, me përjashtim të rastit kur ai është i mashtruar. Për këtë kuptim mbështetëse është shprehja e mjaft e përhapur në librat e fik'hut: Çdo i mëparshëm kërkon prej të mëpasshmit dhe i mëpasshmi, në mënyrë absolute, nuk kërkon prej të mëparshmit.

Vlera

Më sipër u tha se, kur sendi asgjësohet, pronari ka të drejtën e kompensimit me një të ngjashëm, ose të marrë vlerën. Nëse supozohet që sendi është vlerë, a ka të drejtë pronari të kërkoje vlerën e tregut në kohën e rrëmbimit, ose në kohën kur sendi u asgjësua, ose të kërkojë vlerat më të larta që prej kohës së rrëmbimit deri në kohën kur sendi u asgjësua?

Për këtë çështje ka disa thënie dhe më e sakta është thënia për vlerën në kohën e asgjësimit, sepse e drejta e pronarit është e lidhur me sendin derisa sendi ekziston dhe vetëm kur sendi asgjësohet, e drejta e pronarit ka lidhje me zëvendësuesin në kohën kur sendi u asgjësua, për pasojë, vlera caktohet që prej këtij çasti, domethënë prej çastit të asgjësimit.

Në lidhje me këtë çështje kemi folur në librin "Usùlul Ithbàt", në kapitullin "Dora dhe siguria".

Me lejen e Allahut, në kapitullin "Rrëmbimi", do të trajtojmë edhe hollësi të tjera, në lidhje këtë çështje, së bashku me dobitë e sendit të rrëmbyer dhe me mundësinë e kthimit të tij.

* * *

KUSHTET E DY TË SHKËMBYESHMËVE

Më sipër është thënë se shitja plotësohet me formulën që shpreh qëllimin, së bashku me miratimin e dy kontraktuesve, të cilët janë dy palët e obligimit, ndërsa dy të shkëmbyeshmit janë ata për të cilët lidhet kontrata, pasi te dy të shkëmbyeshmit del në shesh edhe ndikimi i kontratës. Më parë është folur për formulën e kontratës e për kushtet e formulës, është folur për dy kontraktuesit dhe ç'merret në konsideratë me dy kontraktuesit. Tani do të kalojmë te kushtet e dy të shkëmbyeshmëve, domethënë, te çmimi dhe të të vlerësuarit me çmim (mallit të vlerësuar).

Në librin "El Mekasib" jepen katër kushte:

1- Të jetë pasuri, krahas lejimit të përfitimit me çmimin ose me mallin e vlerësuar.

2- Pushtet për të pasuar sendin konkret, krahas lëshimit e mosmbajtjes së atij malli. Shumë fukaha e kanë emërtuar këtë kusht me termin "Pronësi absolute".

3- Fuqi për të marrë në dorëzim mallin konkret.

4- Dituria për llojin, sasinë e cilësinë mallit.

Pasuritë dhe dobia e lejuar

Kushti i parë ishte që çdo njëri prej dy të shkëmbyeshmëve të jetë mall që vlerësohet me çmim dhe, sipas traditës, është mall që shpenzohet ose jo, ndërsa në pikëpamjen e ligjit, lejohet që me atë mall të përfitohet.

Bazuar mbi këtë kusht, dalin degët vijuese:

1- Shitja ndodh mbi mallrat konkrete dhe jo mbi përfitimet, edhe pse lejohet që malli të jepet me qira, të dhurohet dhe të përmirësohet. Autori i librit "El Hadàik" ka thënë: "Fjala më e përhapur në mesin e fukahave thotë: "Është kusht që çdo njëri prej dy të shkëmbyeshmëve të jetë send konkret dhe nuk është e vlefshme shitja e përfitimeve."

Lejohet shitja e disa të drejtave, si për shembull, sigurimi për tokën dhe ngurtësimi kundër të falimentuarit.

Sendi konkret që as nuk shpenzohet e as nuk ndalohet, si kokrra e grurit, ose një grusht dheu, këto nuk numërohen pasuri, për rrjedhojë, nuk është e vlefshme që ato të kenë çmim e të jenë mall i vlerësuar, sepse shitje do të thotë shkëmbim malli me mall, prandaj kjo nuk lejon marrjen e një kokrre apo e dy kokrrave gruri, krahas marrjes së pasurisë së tjetrit, sepse mospasja pasuri është një gjë dhe pronësia mbi një send është një gjë tjetër, kurse raporti ndërmjet dy të shkëmbyeshmëve është përgjithësues.

Prandaj, nga njëra anë, janë të bashkuar, siç ishte në shembullin e shtëpisë, e cila është edhe mall edhe pronë, por edhe malli ndahet në metalet që janë nën tokë, të cilat janë mall, por nuk janë pronë.

Gjithashtu, prona ndahet në kokrrën e grurit, e cila është pronë, por nuk është mall.

Pyetje: Cili është kuptimi i fjalisë: Shitja ndodh për mallra të prekshme, duke ditur se qoftë çmimi, qoftë i vlerësuari me çmim (malli), me fjalën e përbashkët të fukahave, lejohet të jenë në ruajtje në mirëbesim?

1- Kësaj pyetjeje ne i përgjigjemi: Qëllimi ynë me "mallra të prekshme" këtu është shkëmbimi i përfitimeve dhe shitja është e detyrueshme për mallin dhe jo për përfitimin, prandaj është e barabartë, qoftë kur dy të shkëmbyeshmit janë jashtë, qoftë kur janë në ruajtje në mirëbesim.

2- Shejkhu El Ensarij ka përmendur në fillim të librit "El Mekàsib", në kapitullin "Fitimi i ndaluar" faqe të tëra, në të cilat ka numëruar mallrat me të cilat është e ndaluar (haram) të fitohet dhe e ka zgjeruar gjatë fjalën, duke përmendur thëniet dhe argumentet për ato, si dhe përgjigjet kundër.

Ne po përmendim disa prej tyre:

Pa asnjë kundërshtim, mes thënieve të fukahave, është haram shitblerja e urinës së kafshëve që nuk u hahet mishi, për shkak se ajo është haram dhe ndyrësirë, për pasojë, nuk mund të përfitohet hallall prej saj ashtu siç është qëllimi. Thënia më e fuqishme flet për lejimin e shitjes së bajgave të kafshëve të pastra, me të cilat përfitohet një dobi hallall.

Është haram shitja e një ngordhësire të futur ndër kafshët e therura sipas rregullit të ligjit të fesë (të pastruara me therje islame).

Gjithashtu, duke u bazuar mbi atë që njihet prej medh'hebit të fukahave imamaij, janë haram të shiten edhe pjesët e kafshëve që nuk u hahet mishi ose i kafshëve të ngordhura me gjak të rrjedhshëm; është haram shitja e qenit të rrugëve, por lejohet shitja e qenit për ruajtjen e bagëtisë, e zagarit për gjah, e qenit që ruan të mbjellat ose kopshtin.

Prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* transmetohet se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Çmimi i verës, shuma e kurorës për laviren dhe çmimi për qenin që nuk është zagar gjahu, është fitim i ulët, por s'ka problem për çmimin për macen."

Edhe çmimi për qenin që mbajnë zonjat e zonjushat, qeni që nuk është zagar, sipas kuptimit të njohur për qenin e gjuetisë, është i urryer.

Edhe shuma e marrë për kurorën e lavires, është gjithashtu e urryer. Sipas asaj që njihet prej medh'hebit të fukahave imamij, lejohet shitblerja e dhjamit të ngurosur të kafshëve të ngordhura, krahas detyrimit për të njoftuar blerësin, nëse ai është mysliman, sepse ngordhësira nuk është hallall, me qëllim që ai të mos e përdorë për ushqim, por e përdor në punë ku mund të përfitohet prej atij dhjami, siç është fabrikimi i sapunit, etj.

Me tekst të Kur'anit dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, është haram shitblerja e sendeve me të cilat nuk ka qëllim tjetër përveç haramit, siç janë idhujt. Për sa i përket shitjes së rrushit, kur dihet se blerësi e përdor për të bërë verë, atëherë shikohet: Në qoftë se ai e shet rrushin me nijet që blerësi të përgatisë verë, pa asnjë kundërshtim, mes fukahave, kjo shitje nuk

lejohet, por, nëse ai e shet pa këtë nijet, shumica e fukahave e kanë lejuar, kanë lejuar shitjen e rrushit të bazuar mbi transmetimet e shumta të ardhura prej Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!)*, ndër të cilat është edhe transmetimi që tregon se Imami Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë që ka vresht dhe u shet rrushin personave që e përpunojnë për verë, ose për pije të tjera dehëse. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: *"Shitja e rrushit ishte hallall në kohën kur ishte hallall pirja e verës, prandaj në atë kohë s'kishte problem."*

Me ajet të Kur'anit e me fjalën e përbashkët të fukahave, është haram shitja e armëve armiqve të fesë. Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kush furnizon me armë armikun tonë në kohë lufte, që ta ndihmojë atë kundër nesh, ai është idhujtar."*

Haram është shitblerja e verës, e derrit, e veglave muzikore dhe e mjeteve të bixhozit. Për sa i përket statujave që paraqesin figura sendesh pa shpirt, si diellin, hënën e pemët, lejohet që ato të punohen, të shiten e të fitohet prej tyre, por në qoftë se ato paraqesin figura sendesh me shpirt, si njerëz, kafshë, shpend, etj, është haram që ato të punohen.

Me fjalën e përbashkët të fukahave është hallall të fitohet prej këtyre lloj statujash, megjithatë fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me shitjen e statujave që paraqesin sende me shpirt.

Ka fukaha që kanë thënë se është e ndaluar, por ka edhe të tjerë që kanë thënë se lejohet shitja e këtij lloji statujash.

Për sa i përket fotografimit aq të përhapur në ditët tona, në mënyrë absolute, është i lejuar për figura sendesh me shpirt e për figura sendesh pa shpirt dhe lejohet shitja e fitimi me këto fotografi.

Ai që ndjek fjalët e Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!)*, si dhe thëniet e fukahave, së bashku me argumentet që ata kanë sjellë për të vërtetuar thëniet e tyre dhe i shikon ato me kujdes, me qëllim që të depërtojë në mendimet e tyre, do të arrijë të kuptojë në thellësi se shkaku obligues i bërjes haram të shitblerjes së sendeve të ndyra dhe të sendeve që ndyjnë, është pikërisht marrja e sendit të shkëmbyeshëm për një përfitim të ndaluar, sepse ngrënia e këtyre mallrave, është ngrënie malli në mënyrë të gabuar.

Për këtë çështje, i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Kur Allahu bën haram një send, bën haram edhe çmimin e fituar prej atij sendi."*

Nëse sendi përdoret në punë të lejuara, patjetër që nuk është haram dhe nuk është ngrënie e pasurisë me rrugë të ndaluara.

Për sa i përket qenit të zakonshëm, shitja e tij është haram, me tekst, sepse prej këtij lloj qeni s'ka asnjë dobi, por lejohet shitja e qenit të stanit dhe e qenit që ruan të mbjellat e kopshtin, sepse prej tij përfitohet. Lejohet shitja e lëkurës së ngordhësirës për të punuar me atë enë për të mbajtur lëngje, ujë, qumësht, etj, shala, ose shosha, madje lejohet edhe shitja e vetë ngordhësirës, nëse supozohet se ajo shërben të përdoret për gjëra të lejuara. Këtë e tregon qartë rasti, kur është pyetur Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* për shitjen e ngordhësirës, ai është përgjigjur: *"Prej saj nuk*

mund të përfitohet.", që do të thotë: Në qoftë se është e mundur që prej saj të përfitohet, atëherë lejohet shitja e saj.

Lejohet shitja e bajgave për plehërim. Për këtë çështje, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"S'ka problem për shitjen e bajgave, në atë mënyrë që ato përdoren për një veprim të lejuar."*

Fjala tjetër e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Çmimi i bajgave është i urryer."*, bazohet mbi përdorimin e tyre për punë haram.

Kur një njeri dëshiron të shesë gjakun e tij një të sëmuri që ka nevojë për gjak, pa dëmtuar veten, çmimin për këtë gjak të dhënë ai e ka hall, gjithashtu, ai edhe mund të dhurojë gjak pa kompensim.

Gjithashtu, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është pyetur për një burrë, që punonte varëse për shpatat me qimet e derrit. Çfarë duhet të bëjë ky burrë? Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: *"Menjëherë le të lajë duart."*

"Kur është pyetur për brumin e ndyrë dhe për kafshën e pastër, të përzier me ngordhësirën, ai është përgjigjur: *"Shitet për atë që e ka të lejuar."*

Atëherë, derisa çmimi për ngordhësirën e për brumin e ndyrë qenka hallall, rezulton të jetë hallall edhe çmimi për sende të tjera të ndyra e për sende që ndyjnë me ndyrësirë, pasi nuk ka veçanti për vendin nga del që të jetë përgjegjës për atë, me kusht që sendi të përdoret vetëm për punë të lejuara dhe jo për punë të ndaluara.

Në lidhje me këtë çështje, shejkhu El Ensarij ka thënë: "Kur gjendet argumenti që lejon përfitimin e një dobie prej ndonjë ndyrësire, nuk ka pengesë në lidhje me vlefshmërinë e shitjes së atij sendi, sepse argumenti që tregon ndalimin e shitjes së sendit ndyrësirë, pra, argumenti (ajet Kur'ani ose transmetim) me tekst e me fjalën e përbashkët e fukahave, ndalimi është për përfitimin haram."

Sej'jid El Jezdij, në margjinaturën *(hàshijeh)* e librit "El Mekàsib", ka thënë: "Krahasimi të jetë i tillë që përfitimi i lejuar të jetë i bazuar mbi pronësinë, në atë mënyrë që sikur të mos dallohet mirë dobia e lejuar, ai send të konsiderohet pasuri, edhe kur dobia që ai sjell të jetë shumë e rrallë, sepse ajo që mësohet qartë prej argumenteve të ndalimit, në të vërtetë, është shitja e atij sendi në mënyrë të ndaluar, madje edhe kur supozohet se për sendin ndyrësirë ka dobi të rralla, që nuk është e drejtë të quhet pasuri, por me shitjen e këtij sendi qëllimi është që të përfitohet prej atij sendi edhe kjo dobi e rrallë. Kjo është e mjaftueshme për vlefshmërinë e shitjes, pasi kemi si shembull të ngjashëm rastin kur ai shet një send hallall, me qëllim që të përfitohet një gjë e rrallë, në të cilën sendi nuk numërohet pasuri me fundin e atij sendi, sepse nuk është e lejuar të ketë veshje në lidhje me vlefshmërinë e tij."

Ky është edhe kuptimi i fjalës se të gjitha sendet e ndyra lejohen të shiten thjesht, për faktin se në to ka edhe një dobi të vetme hallall, madje edhe kur kjo dobi është e rrallë, pasi në shumicën e rasteve dobitë te sendet e ndyra janë haram. Por është e padiskutueshme se çdo send i ndaluar nuk mund të mos ketë ndonjë dobi të rrallë.

Pushtet i plotë mbi sendin

Kushti i dytë është që shitësi të ketë pushtet absolut mbi sendin e vlerësuar me çmim, njëkohësisht është kusht që edhe blerësi të ketë pushtet absolut mbi çmimin, sepse cili është ai i mençur që do të bënte detet e lumenjtë çmim e mall, ose peshqit, shpendët (jo shtëpiakë), egërsirat dhe të tjera të ngjashme si këto, para se të ishte mundësia e pronësisë së plotë mbi to?

Me lirimin e sendit nga bllokimi, ai send, vakëf ose peng qoftë, del nga gjendja e bllokimit, sepse bllokim i sendit, me lënien vakëf ose peng, do të thotë se ndalohet veprimi dhe transferimi i pronësisë mbi sendin e lënë vakëf ose peng.

Në lidhje me këtë çështje, shejkhu El Ensarij ka thënë: "Dy të virtytshmit, El Al'làmeh dhe Muhak'kiku, si dhe të gjithë ata që kanë ardhur më vonë pas këtyre të dyve, në kushtet e dy të shkëmbyeshmëve pas pronësisë mbi ato të dyja, kanë përmendur edhe qenien e sendit të lirë, domethënë që sendi nuk është i lënë as vakëf e as peng. Duke u bazuar mbi këtë, kanë arritur në përfundim për moslejimin e shitjes së vakëfit, me përjashtim të atij vakëfi të veçuar me kushte. Gjithashtu, kanë ndaluar shitjen e sendit të lenë peng pa lejen e pengpranuesit."

Blerja me mall të rrëmbyer

Në të vërtetë, këtë kusht e imponon ekstremiteti i rasteve, prandaj edhe shtrirja e studimit mbi këtë temë është thjesht për qartësim. Patjetër që edhe për këtë lloj blerje gjenden çështje që

kanë lidhje me disa kushte që meritojnë të theksohen, ndër të cilat rendisim rastet:

Kur një person rrëmben një mall prej tjetrit dhe me këtë mall të rrëmbyer ai ble një send, a bëhet ai pronar i sendit të blerë dhe a është hallall për atë sendi që ai bleu me mallin e grabitur? Padyshim që ky blerës rezulton të jetë mëkatar dhe garantues për mallin e rrëmbyer, ndryshe shitja është e vlefshme, ose ajo është e pavlefshme që në fillim, që do të thotë se blerësi e ka haram të veprojë me sendin e blerë, sepse shitja e mallit të rrëmbyer është bërë pa dijeninë e pronarit të atij malli, kur dihet se për shitjen, lejimi, nga ana e pronarit të vërtetë, është kusht i domosdoshëm.

Përgjigje: Në qoftë se blerja ndodh mbi vetë sendin e rrëmbyer, si për shembull, kur rrëmbyesi thotë: "E bleva këtë send me këtë mall.", nëse ai e lejon, shitja është e vlefshme për rrëmbyesin, ndryshe shitja, si bazë, është prishur.

Në lidhje me këtë kuptim, bën fjalë transmetimi i ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili është pyetur për një burrë që ka blerë një copë tokë, ose një shërbyes me një mall të marrë, duke u prerë rrugën udhëtarëve, ose me mall të vjedhur. Shtrohet pyetja: A është hallall për atë prodhimi që merr prej kësaj toke dhe a e ka hallall ai të përdorë shërbyesin? Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* është përgjigjur: *"Nuk ka të mirë në një send, origjina e të cilit është haram dhe ai nuk e ka hallall përdorimin e atij sendi."*

Në qoftë se blerja ndodh me kusht që i gjithë çmimi të jetë me garantim, por jo mbi sendin e rrëmbyer, ndërkaq blerësi, për të mbajtur besën, e shlyen pagesën me mallin e tjetrit, shitja është e

vlefshme dhe sendi i blerë është hallall, por mbi blerësin rëndon mëkati dhe garantimi.

Për këtë kuptim flet edhe fjala e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Sikur një burrë të vjedhë një mijë dirhemë dhe më këtë shumë ai ble një robëreshë, të cilës i jep edhe shumën e kurorës, kjo femër është hallall për këtë burrë, por ai është ndjekës i mallit, domethënë është garantues për mallin e rrëmbyer."*

Aftësia për të dhënë në dorëzim

Kushti i tretë është që shitësi të ketë aftësi për t'i dorëzuar blerësit mallin e vënë në shitje, gjithashtu edhe blerësi të jetë i aftë për t'i dorëzuar çmimin shitësit.

Në librin "El Mekasib" janë përmendur pesë argumente për këtë kusht. *Argumenti i parë:* Shitja, krahas mossigurisë për atë çka gjendet brenda sendit. Kjo është shitje me mashtrim. Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e ka ndalur shitjen me mashtrim. Mashtrim këtu, me fjalën e përbashkët të fukahave, do të thotë prishje e shitjes.

Argumenti i dytë: Hadithi mjaft i përhapur i ardhur prej të Dërguarit më të madh (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): *"Mos shit atë çka nuk është te ti."*

Kur ne shpjegojmë në lidhje me atë që nuk ka aftësi të japë në dorëzim, nga afër vjen fjala rreth këtij hadithi.

Argumenti i tretë: Vetë karakteri i kontratës nënkupton dorëzimin e dy të shkëmbyeshmëve për secilin prej personave

përkatës dhe është e detyrueshme që dhënia në dorëzim të jetë e mundur, ndryshe është obligim në pamundësi.

Argumenti i katërt: Qëllimi me shitjen është që shitësi të përfitojë prej çmimit që merr, gjithashtu, edhe blerësi të përfitojë prej mallit që merr. Por përfitimi plotësohet vetëm me marrjen në dorëzim, prandaj, kur marrja në dorëzim është e pamundur, është e pamundur edhe shitja.

Argumenti i pestë: Dhënia e çmimit për marrjen e një sendi të pamundur të merret, është budallallëk dhe është ngrënie e pasurisë në mënyrë të padrejtë.

Qoftë çdo argument prej këtyre argumenteve i veçantë në vlefshmëri, apo të gjithë sëbashku, këto ftojnë në qetësi e bindje. Pa dyshim që fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me këtë kusht, sepse edhe tradita e shikon bashkëpunimin krahas pamundësisë së dhënies e marrjes në dorëzim, ndryshe janë fjalë boshe që s'kanë asnjë efekt dhe është plotësisht si shitja e peshqve në ujë, ose shitja e shpendëve në fluturim në ajër.

Në lidhje me këtë kusht, dijetarët kanë nxjerrë disa çështje shumë të rëndësishme. Disa prej të cilave ne po i rendisim në vijim:

Fuqia për të merituar

Konsiderohet fuqi për të dhënë në dorëzim e për të marrë në dorëzim, mundësia në kohën e ekzekutimit të kontratës e për të merituar marrjen e dhënien, por fuqia nuk sjell ndonjë dobi në kohën e bërjes së kontratës, krahas pamundësisë për të dhënë në

dorëzim në kohën që duhet të jepet, ashtu siç nuk sjell dëm pamundësia në kohën e ndërtimit të kontratës krahas mundësisë për të merituar.

Bazuar mbi këtë rregull, lejohet shitja e miellit të grurin, e vajit të frytit të ullirit, e kashtës së të mbjellave para korrjes dhe e mishit të deles para therjes, sepse ai ekziston gjatë gjithë kohës, edhe nëse nuk ekziston në kohën e dhënë, prandaj riskimi për këtë lloj malli nuk është as mashtrim, as çmenduri dhe as obligim i pamundur.

Vetëm fuqia e blerësit

Kur shitësi e ka të pamundur të japë në dorëzim, ndërsa blerësi ka mundësi të marrë në dorëzim, shtrohet pyetja: A është e vlefshme kjo shitje? Për të ilustruar këtë çështje sjellim shembullin kur një më i fuqishëm të ka rrëmbyer shtëpinë, ndërkaq ti ia shet shtëpinë tënde një personi që është më i fuqishëm se rrëmbyesi, pasi blerësi ka fuqi të shpëtojë shtëpinë tënde prej rrëmbyesit.

Përgjigje: Padyshim që shitja është e vlefshme, sepse qëllimi me futjen e fuqisë ndër kushtet e shitjes, është arritja e sendit të vlerësuar te personi që transferohet dhe në rastin tonë, transferimi është realizuar.

Shejkhu El Ensarij, duke cituar librin "El Ijdàh", ka thënë: "Pikërisht në këtë veçohen imamitë, domethënë veçohen në destinimin."

Bazuar mbi këtë sentencë, ai ka argumentuar se në këtë shitje s'ka as mashtrim e as çmenduri.

Mos shit atë që nuk është te ty

Në kapitullin *"El fudùlij"* është shpjeguar se ai që shet mallin e tjetrit, shitja ndodh si shitje e bërë prej një tjetri dhe jo prej pronarit dhe, nëse pronari i mallit lejon shitjen, kjo shitje ekzekutohet, ndryshe shitja është e prishur që në bazë. Është vendi të theksojmë se fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët në lidhje me personin që shet mallin e tjetrit dhe më pas ai shkon te pronari prej të cilin e ble atë mall dhe përfundimisht i dorëzon mallin blerësit. Për këtë lloj shitje, të gjithë fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se kjo shitje nuk është e vlefshme, për faktin se njerëzit kanë pasuritë e veta dhe nuk kanë pasuritë e të tjerëve. Edhe hadithi: *"S'ka shitje përveç asaj që ke."*, tregon mohimin e shitjes para marrjes në pronësi të sendit.

Gjithashtu, edhe hadithi: *"Mos shit atë çka nuk është te ti."*, tregon qartë për ndalimin e shitjes së një sendi mbi të cilin shitësi nuk ka pushtet, pasi kjo është e barabartë me rastin kur sendi nuk është në pronësi të dikujt, si për shembull, peshqit në ujë, ose sendi është pronë e një tjetri, por jo e shitësit, ose sendi është pronë e vetë shitësit, por ai e ka të pamundur ta ketë në dorë atë send, si për shembull, deveja që nuk kapet më, ose robi që arratiset.

Është e qartë se për sekserin lejohet që ai të bjerë dakord, për shembull me Zejdin, që ai të blejë për veten e tij mallin e tjetrit dhe më pas ai ia shet këtë mall Zejdit me një çmim të caktuar, por kjo marrëveshje nuk e detyron Zejdin me shitjen, pasi shitja mbetet në vullnetin e tij, që do të thotë: Nëse dëshiron, e merr, nëse nuk dëshiron, heq dorë prej atij malli.

Abdurrahman bin El Haxhaxh tregon: "I thashë Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Burri vjen, kërkon mallin. Unë ia shes atij dhe pastaj e ble atë mall prej tij. A është veprim i drejtë ky?"* Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"A nuk është që, nëse ai dëshiron, e le dhe, nëse dëshiron, e merr atë?"* Thashë: *"Posi jo."* Atëherë Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"S'ka problem për atë mall."*

Gjithashtu, lejohet që sendi të shitet në mirëbesim, si për shembull, shet një ton grurë, në kohën kur te ai nuk gjendet grurë, por më pas ai e ble grurin dhe ia dorëzon blerësit, sepse mundësia në kohën e dorëzimit është e mjaftueshme për vlefshmërinë e shitjes.

Është e pavlefshme shitja e mallit të futur në një mall tjetër

Kur ai shet dy sende së bashku dhe në kontratë është vetëm një send, njëri prej këtyre dy sendeve ka mundësi të merret në dorëzim, kurse dorëzimi i sendit tjetër është i pamundur, si për shembull: Burri shet një deve të arratisur së bashku me një rrobë për dhjetë derhemë. A është e vlefshme kjo shitje?

Jo, sepse futja e një sendi të vlerësuar në një send tjetër të pavlerësuar, nuk e bën totalin të vlerësuar dhe as nuk del ajo që është e pamundur të shkojë te ajo që është e mundur.

Ti mund të thuash: Prej Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!)* është vërtetuar se robi i arratisur lejohet të shitet së bashku me një mall tjetër. Mirëpo kjo shitje është në kundërshtim me bazat e me rregullat dhe shitja, në këtë rast, kufizohet në një

transmetim të vetëm si burim për këtë çështje, që, në rastin e mësipërm, ishte shitja e robit të arratisur. Në ditët e sotme s'ka vend të flitet as për rob e as për robëresha.

Për rrjedhojë, çdo send që s'lejohet të shitet veç, nuk lejohet shitja e tij i futur në një send që lejohet të shitet.[1]

Kuptimi i mashtrimit

Më sipër pamë se shitja me pamundësi për të marrë në dorëzim, është shitje e pavlefshme, për shkak se ka vend për mashtrim.

Gjithashtu, kur të trajtojmë kushtin e katërt, do të shikojmë se është e pavlefshme edhe shitja kur nuk ka dijeni për dy të shkëmbyeshmit, pasi edhe kjo nënkupton kuptimin e mashtrimit. Është transmetuar se Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: *"Mashtrimi është një punë, kur së bashku me atë nuk sigurohet dëmi."*

Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Ky është një kuptim përgjithësues për gjithçka sa kanë thënë gjuhëtarët e juristët e ligjit të fesë. Duke u bazuar mbi këtë kuptim, çdo bashkëpunim i ndërsjellë, që përputhet me këtë kuptim, domethënë, kur krahas punës nuk sigurohet dëmi, është veprim i gabuar, për shkak se ka vend për mashtrim."

---

[1] Kjo fjali ose ky rregull, tekstualisht ka ardhur në librin "Miftahul Kerameh", vëll. 6, K. "Mallrat e tregtisë", f. 287.

Shejkhu El Ensarij e ka komentuar mashtrimin me grindjet e me zënkat që mund të ndodhin për shkak të bashkëpunimeve të ndërsjella. Ky komentim i referohet transmetimit që ne cituam prej Imam Sadikut Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, transmetim të cilin autori i librit "El Xhevahir" ka preferuar dhe e ka quajtur: "Vepër që nuk është e siguruar prej dëmtimit."

Veç kësaj, nuk është prej domosdoshmërive që mashtrimi të jetë përkrah mosnjohjes, megjithëse mosnjohja mund të gjendet edhe atëherë kur nuk ka mashtrim. Shumë njerëz të mençur blejnë sende, pa e ditur të vërtetën e atyre sendeve dhe patjetër që, në këtë riskim, llogarisin që mbi sendet e blera nuk do të kalojnë dëmtime e rreziqe, madje ndalimin për të mos vepruar me këto sende ata e konsiderojnë naivitet, ose veprim të ngjashëm me naivitetin.

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Njerëzit e mençur riskojnë pak për të përfituar shumë. Ata e blejnë sendin e panjohur me një çmim që nuk dëmtohen, siç është për shembull, pagesa mes çmimit të bakrit e të floririt, sepse te shejkhu i nderuar ky veprim dëshirohet te njerëzit e mençur, madje ata e qortojnë atë që heq dorë prej këtij veprimi dhe nuk e pranojnë shfajësimin prej atij që heq dorë nga kjo maturi, sepse veprimi i tij do të thotë "vënie në rrezik". Atëherë rezulton se mashtrimi, kurrë e asnjëherë, nuk është i ndarë nga mosnjohja, por është i atillë që mund të jetë e mund të ndodhë.

Njohja me dy të shkëmbyeshmit

Kushti i katërt është që çdo njëri prej dy të shkëmbyeshmëve të jetë i përcaktuar te dy kontraktuesit në atë mënyrë që të përjashtojë mashtrimin, gjithashtu, ky kusht nuk miraton riskimim deri në vënie në rrezik, prandaj nuk është e vlefshme shitja e mallit të panjohur, në të cilin mund të ketë mashtrim, si për shembull, kur thuhet: "Të shita ty një rrobë, pa e ditur fare.", ose "Këtë e bleva me një rrobë.", pasi në të gjitha shitjet patjetër kërkohet njohje paraprake me sasinë, llojin dhe cilësinë e sendit.

Gjithashtu, nuk është e vlefshme që çmimi të lihet në gjykimin e njërit prej dy kontraktuesve, ose edhe në gjykimin e një të treti. Rrugët e njohjes me çmimin e me mallin janë aq të ndryshme, sa ç'është edhe ndryshimi mes përbërjes e të vërtetës së sendeve.

Në librin "El Mekàsib", në kapitullin e parë, "Tregtia", thuhet: "Pasja dituri për çdo send, ashtu siç është sendi dhe ashtu siç është e zakonshme, ka të bëjë me një vlerësim specifik dhe dituria ndjek arritjen e vlerësimit, kurse shitja e sendit pa asnjë dituri rreth tij, është shpifje dhe hamendje që s'kanë asgjë të përbashkët me diturinë për një send."

Për disa gjëra, rruga për njohjen me atë send është shikimi me sy, për disa sende të tjera, rruga e njohjes është përshkrimi, rruga e njohjes për disa sende të tjera është pesha, ose matja, ose numërimi, ose sipërfaqja. Ka edhe sende të tjera për njohjen e të cilave s'ka rrugë tjetër përveç nuhatjes e shijimit, ose çarjes së sendit.

Tani do të flasim për këto rrugë që u thanë.

Shikimi me sy

Padyshim që shikimi i zakonshëm, domethënë shikimi me sy, nuk është rrugë për njohjen me të gjitha sendet, pasi disa sende, si për shembull, orenditë, veshjet, librat, materialet e kancelarisë e të tjera sende, për të cilat në këndvështrimin e njerëzve të mençur është e mjaftueshme vetëm shikimi i thjeshtë me sy, në një kohë kur mospasja dijeni për disa cilësi të sendit, nuk sjell dëmtim për ato gjëra që i toleron tradita. Prandaj, në këndvështrimin e njerëzve të mençur, kjo mosnjohje nuk numërohet as mashtrim e as dëmtim.

Shejkhu El Ensarij ka thënë: "Kriteri i mjaftueshmërisë me pamje me sy do të thotë heqja e mashtrimit personal."

Vlen të theksohet se fjala e fukahave, në të vërtetë, është argument me të cilin veprohet, kur vetë fukahatë kanë një fjalë të përbashkët në lidhje me një sentencë ligjore, si për shembull, fjala e përbashkët e fukahave që shitja me mashtrim është e prishur. Për sa u përket zbatimeve të jashtme, specifikimit të objekteve, ose në atë shitje ka mashtrim, ose në shitjen tjetër nuk ka mashtrim, të gjitha këto i referohen pikëpamjes së personit që ka lidhje me shitjen dhe jo me pikëpamjen e fukahave e të hulumtuesve. Këtë theksim e bëmë me qëllim që të bëjmë të qartë se është pa ndonjë peshë fjala e përbashkët e fukahave, që ka cituar autori i librit "Et Tedhkireh" dhe autorë të tjerë, të cilët pohojnë se shikimi me sy është i mjaftueshëm për shitjen e rrobës e të tokës, sepse kjo fjalë e përbashkët e fukahave është e bazuar mbi specifikimin e objektit dhe miratimin, por ajo nuk është bazuar mbi ndonjë sentencë ligjore përgjithësuese që të jetë argument. Sikur të supozohet se shikimi me sy i kësaj cope toke, nuk e përjashton mashtrimin,

shitja nuk është e vlefshme, prandaj, në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se shikimi me sy nuk është rregull përgjithësues për vlefshmërinë e shitjes, edhe pse kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, sepse sekreti i vlefshmërisë qëndron në mosekzistencën e mashtrimit dhe vetëm atëherë kur vërtetohet mungesa e mashtrimit, me njërën prej rrugëve të mundshme, shitja është e vlefshme, ndryshe shitja është e pavlefshme.

Cilësimi

Në të vërtetë, njohja e sendit vetëm me anë të llojit të tij, ose me anë të kategorisë së tij, nuk e largon mashtrimin, prandaj nuk është e vlefshme që burri të blejë një kalë, ose një rrobë në mirëbesim, pa i përmendur cilësinë, në bazë të së cilës ndryshon vlera e dëshirat.

Gjithashtu, nuk është e vlefshme që ai të blejë kalin e Zejdit pa qenë kali në vendin ku bëhet akti i shitjes dhe pa e parë fare kalin, por është e vlefshme që ai ta blejë kalin, edhe pse kali nuk është i pranishëm, por e ble, duke u bazuar sipas përshkrimit të cilësive me të cilat e përshkruan kalin pronari i tij, në atë mënyrë që, sipas cilësive me të cilat ai përshkruan kalin, ndryshojnë edhe dëshirat, si për shembull, mosha, është i dobët, ose i shëndoshë, është kalë origjinal arab, ose është kalë i racave të huaja, apo lloj tjetër njëthundrakësh, cilësi me të cilat përjashtohet mashtrimi. Prandaj kur ai e gjen mallin në kohën e marrjes në dorëzim, me cilësitë që malli është përshkruar, shitja bëhet e detyrueshme, ndryshe blerësi ka të drejtë të bëjë përzgjedhjen e vet për të prishur shitjen, për shkak të ndryshimit të cilësive, ose për shkak

të ndryshimit të kushtit të garantimit. Për këtë kusht do të flitet me hollësi në kapitullin "Përzgjedhjet".

Nëse ti si blerës e ke parë kalin para shitjes dhe më pas je larguar për një farë kohe, gjatë së cilës nuk mendon se kali ka pësuar ndonjë ndryshim, por, sipas zakonit kali do të ketë mbetur me ato cilësi që kishte në kohën kur ti e bleve kalin, bazuar mbi ato që ke parë te kali. Në qoftë se ti, në kohën e marrjes në dorëzim e gjen kalin me ato cilësi që kishte, shitja bëhet e detyrueshme, por, nëse ti e shejkh se cilësitë e kalit janë të tjera nga ato për të cilat ti ke lidhur marrëveshje, ose të thuhet se kali ka pësuar ndryshime, që sipas zakonit nuk janë të pranueshme, atëherë ti ke të drejtën të prishësh shitjen për të sprapsur dëmtimin.

Për analogji, e njëjta gjendje është edhe me shitësin, për të cilin vërtetohet e drejta e përzgjedhjes, në qoftë se ai e ka shitur pronën e vet që nuk e ka pranë, bazuar mbi ato cilësi që atij ia kishin përshkruar, ose bazuar në shikimin e atij malli kohë më parë, por më pas bëhet e qartë se sendi i vënë në shitje ka shtuar aq sa nga kjo shtesë lind e drejta për të kërkuar ngritjen e çmimit, në atë mënyrë që ai nuk e toleron.

Ndryshimi në tjetërsim

Kur shitja bëhet në bazë të një shikimi të mëparshëm dhe pas shitjes dy të shkëmbyeshmit ndryshojnë deri në cakun e tjetërsimit, aq sa blerësi thotë: "Malli qenka ndryshe nga ai që kam parë, prandaj unë kam të drejtë ta prish këtë shitje.", shitësi thotë: "Në asnjë mënyrë, është ashtu siç ishte në kohën kur e ke parë.",

atëherë cili prej dy pretenduesve ka detyrë të bëjë vërtetimin? Cili prej këtyre të dyve që mohojnë, ka detyrë vetëm të betohet për atë që thotë? Një shembull për ilustrim: Zejdi ka parë kalin e Amrit dhe pas një farë kohe e ble kalin prej tij me një çmim të caktuar, bazuar mbi ato cilësi që ai kishte vënë re te kali. Por në kohën e marrjes në dorëzim e të dhënies në dorëzim, blerësi thotë: "Unë e kam blerë të shëndoshë, kurse tani kali qenka i dobët.", ndërsa shitësi i thotë: "Jo, e ke blerë të dobët, ashtu siç është tani."

Pa dyshim që dallimi i pretenduesit prej mohuesit, është prej çështjeve më të hollësishme dhe më të rëndësishme, pavarësisht se rregulli dhe kriteri për secilin prej atyre të dyve, padyshim është i njohur dhe konsiston në miratimin e fjalës së mohuesit për origjinalin dhe në kundërshtimin e fjalës së pretenduesit për atë mall, ndërsa hollësitë e çështjes qëndrojnë në zbatimin dhe në specifikimin e burimeve dhe të individëve. Sido që të jetë, në lidhje me këtë çështje ka vetëm dy thënie:

Thënia me saktë prej këtyre dy thënieve është ajo që mbështesin fukahatë më të dëgjuar dhe që pohon: Shitësi është pretenduesi dhe blerësi është mohuesi dhe fjala e këtij të fundit pranohet me betimin e tij, për shkak se grindja qëndron për faktin që ky kontraktim i ndërsjellë është i lejuar, ose kontraktimi është i detyrueshëm dhe i referohet të vërtetës së mallit, përderisa kontraktimi për kalin është bërë me cilësinë e tij, i dobët, kështu që kontrata është e detyrueshme, ose kontraktimi që është për shitjen e kalit, është bërë me cilësimin e tij i shëndoshë dhe kështu prishja është e lejuar.

Kur ne e trajtojmë origjinën e mungesës së kontratës, bazuar mbi gjendjen e kalit "i dobët", kontrata është e lejuar në

mënyrë spontane, sepse lejueshmëria e kontratës që në fillim, pa asnjë kohë ndërmjetëse e deri në mosekzistencën e kontratës, është mbështetur mbi dobësinë e kalit. Bazuar mbi këtë fakt, fjala e blerësit rezulton në përputhje me origjinën, prandaj pranohet betimi i tij, atëherë kur shitësi nuk ka qëllim të vërtetojë me argumente pretendimin e vet.

Ti mund të thuash: Origjinë është edhe mosekzistenca e kontratës, bazuar mbi kalin e shëndoshë, megjithëkëtë pohohet se kontrata është e detyrueshme, pra, kontrata është e lejuar dhe fjala e shitësit është në përputhje me origjinalin, për rrjedhojë pranohet betimi i tij.

Ne përgjigjemi: Detyrimi i kontratës ka efekt, sepse ajo është lidhur duke u bazuar mbi dobësinë e kalit dhe nuk ka efekt, sepse nuk ka ndodhur bazuar mbi kalin e shëndoshë, derisa kjo origjinë të jetë e dobishme, në kundërshtim me lejimin e kontratës, e cila ka efekt ligjor për shkak se ka ndodhur duke u bazuar mbi dobësinë, domethënë, mbi kalin ekzistues faktik. Është intuitive që mohimi i shëndoshjes, në origjinë, vërteton ekzistencën e dobësisë, parë kjo nga ana e lidhjes logjike, por jo nga ana e lidhjes ligjore, që do të thotë mohim i të kundërtës me origjinën dhe jo me ndjenjë, as me argument, që e bën të detyrueshëm ekzistencën e një të kundërte tjetër, sipas gjykimit logjik, por sipas gjykimit të ligjit, i cili mbështet vërtetimin e objekteve të dispozitave e të ligjeve të tij, bazuar mbi shikimin me sy e me argumente dhe jo bazuar mbi gjykimin e mendjes me anë të pajtueshmërisë, ose të kontradiktës ndërmjet të natyrshmeve dhe të jashtmeve.

Thënë ndryshe, sikur të supozohet se kontrata, në fakt, ka ndodhur për një kalë të dobët, patjetër që do të ishte e

detyrueshme që kjo kontratë të zbatohej. Pikërisht ky është edhe kuptimi i thënies: "Sikur të mos kishte ndodhur, bazuar mbi kalin e dobët, kontrata vetvetiu do të ishte e lejuar.", pavarësisht se kontrata ka ndodhur për kalin e shëndoshë.

Mbështetur mbi këtë pohim, kur ne kemi qëllim të vërtetojmë lejimin e kontratës, në mënyrë absolute, nuk keni nevojë të vërtetojnë që kontrata ka ndodhur për kalin e shëndoshë, por mjafton të vërtetojmë mosndodhjen e kontratës për kalin e dobët, duke ditur se moskontraktimi, bazuar mbi kalin e dobët, logjikisht bën të detyrueshëm vërtetimin e kontraktimit, bazuar mbi kalin e shëndoshë. Por ne nuk kemi nevojë për këtë, derisa moskontraktimi, bazuar mbi kalin e dobët, në vetvete, është më se i mjaftueshëm për lejimin e kontratës pa asnjë ndërmjetës.

Sikur të supozohet se kontrata është bërë bazuar mbi kalin e shëndoshë, kontrata, në çështjen tonë, është e lejuar, por mosndodhja e kontratës, bazuar mbi kalin e shëndoshë, nuk vërteton përmbajtjen e kontratës, sepse përmbajtja e kontratës ka efekt për shkak të ndodhjes së kontratës, bazuar mbi kalin e dobët, por edhe ndodhja e kontratës, bazuar mbi kalin e dobët, nuk vërteton në origjinë mosndodhjen e kontratës, bazuar mbi kalin e shëndoshë, përveçse kur ne llogarisim që mosekzistenca e të kundërtës ka lidhje me ekzistencën e një të kundërte tjetër.

Kjo, në asnjë rast, nuk mundëson që të bëjmë këtë llogari, duke pasur parasysh se gëzojmë cilësinë e juristit të ligjit të fesë, sepse kjo lidhje është prej çështjeve të logjikës dhe nuk është prej çështjeve ligjore.

Kjo është më e shumta që unë kam në lidhje me sqarimin që ka pasur qëllim shejkhu El Ensarij me fjalën e tij: "Konflikti i referohet ndodhjes së kontratës, bazuar mbi ato që përputhen me sendin ekzistues, në mënyrë që të bëhet e detyrueshme mbajtja ose mosmbajtja e besës për këtë kontratë, pasi në origjinë qëndron mosndodhja e kontratës.

Kurse pretendimi për kundërshtimin e kontratës, për mosndodhjen e saj mbi sendin e pakushtëzuar me origjinën e mosndodhjes së kontratës, bazuar mbi sendin e kushtëzuar, kjo kontratë nuk është e lejuar, ashtu siç e ka vërtetuar ai në librin "Bazat".[1]

E matura, e peshuara dhe e numëruara

Më sipër është shpjeguar se çmimi dhe malli i vlerësuar me çmim, patjetër duhet të jenë të njohura prej dy kontraktuesve, gjithashtu, është shpjeguar se rruga e njohjes mund të jetë me anë të shikimit me sy, ose me anë të përshkrimit të cilësive, ose me anë të peshimit, ose me anë të matjes, ose me anë të numërimit, ose me matjen e sipërfaqes. Fukahatë janë zgjatur shumë në lidhje me

[1] Kur mbetet ndonjë paqartësi edhe pas sqarimit e pas shpjegimit, në të vërtetë, kërkesa, në vetvete, vazhdon të jetë e paqartë dhe tepër e hollësishme, sepse është prej vogëlsive të çështjes së njohur "me origjinën e vërtetuar" te dijetarët e universitetit të qytetit Nexhef (Irak). Kam kaluar muaj e muaj në studimin e këtyre çështjeve pranë profesorëve dhe kam besuar se ato janë prej çështjeve të njohura me "dyshimin e miratuar" dhe është çështje që i përket "rregullit të pozitivizmit" prej asaj tërësie çështjesh që unë veçova në universitetin e Nexhefi Eshrefit. Për këto tri çështje kam shkruar një artikull të gjatë me titull "Bazat e fik'hut ndërmjet të vjetrës e të resë". Artikullin në fjalë e kam botuar në revistën egjiptiane "Risàletul Islàm", shtëpia botuese "Dàru Takrijb", në muajin Ramazan, viti 1369H.

sendet që maten e me sendet që peshohen dhe për këtë kanë shkruar faqe të shumta, nëse qëllimi me të matshme e me të peshuara ka qenë vetëm për sendet që peshoheshin e mateshin në kohën e ligjvënësit, apo çdo vend me të matshmet e me të peshuarat kishte zakonin e vet. Kjo a është e barabartë, nëse përputhet ose jo me kohën e ligjvënësit?

Fukahatë kanë folur gjatë, nëse sendet që peshohen, lejohen të shiten me peshë, pasi sendi i peshuar ka peshë, kurse sendi i numërueshëm shitet ose me anë të numërimit ose me shikim. Fukahatë kanë folur edhe për sende që nuk mund të njihen me anë të përzgjedhjes, për shkak se ato as nuk shijohen e as nuk nuhaten, si dhe të tjera si këto.

Është e kuptueshme që pesha, matja, numërimi dhe të tjera mënyra e mjete që lejojnë njohjen e sasisë, nuk janë qëllim në vetvete, ashtu siç është shikimi me sy dhe përshkrimi i cilësive, ose përzgjedhja me anë të ngjyrës, shijes e aromës, janë rrugë për njohjen me cilësinë, kurse përvoja shërben për largimin e mashtrimit. U shpjegua, se çdo shitje në të cilën ka mashtrim, ajo shitje nuk është e vlefshme, që do të thotë se çdo shitje në të cilën ka mashtrim të atillë, që tradicionalisht nuk tolerohet, ajo shitje është e pavlefshme.

Këtë të vërtetë e mbështet komenti që kanë dhënë fukahatë për shitjen e pavlefshme, për shkak se në atë shitje ka mashtrim. Gjithashtu, fukahatë kanë bërë komente edhe për shitjen e vlefshme, domethënë për shitjen në të cilën nuk ka mashtrim.

Në lidhje me këto çështje shejkhu El Ensarij, në librin "El Mekàsib", tekstualisht thotë: "Sikur të supozohet largimi i

mashtrimit pa vlerësim, kjo është e mjaftueshme, ashtu siç është rasti kur shitësi e blerësi kanë një hamendje të fuqishme në lidhje me përcaktimin e sasisë, deri në atë shkallë sa rrallë herë mund të mos përputhet me realitetin, ose kur sendi i shitur është në sasi të pakët, aq sa nuk njihet të peshohet një send i ngjashëm me atë, ose kur ai paguan para dhe ka qëllim të marrë vaj, kur dihet që sende të tilla nuk peshohen, prandaj shitja e këtyre sendeve lejohet kur ata të dy miratojnë në mënyrë të ndërsjellë vlerësimin me hamendje."

Siç shihet, e rëndësishme është përjashtimi i mashtrimit, qoftë edhe me hamendje. Për sa u përket transmetimeve që kanë ardhur prej Ehli Bejtit *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi ta!)*, në lidhje me kapitullin tonë, në të vërtetë ato nuk kanë ardhur për të vënë themelet e ndonjë baze ligjore, nëse kjo gjë shitet me matje, ose një lloj tjetër shitet me të numëruar (me copë), ose këto sende shiten me shijim dhe disa të tjera nuk shiten me shijim.

Të gjitha transmetimet kanë ardhur për të shpjeguar asgjë më shumë se një bazë të vetme, e cila thotë se shitja me mashtrim është e ndaluar dhe nuk ka problem për shitjen në të cilën nuk ka mashtrim. Kjo është e barabartë, qoftë kur mashtrimi përjashtohet me anë të shikimit me sy, qoftë me anë të peshimit, qoftë me anë të matjes, qoftë sipas cilësive, madje edhe me hamendje, ose me vlerësim nga ana e blerësit.

Për këtë çështje, shejkhu El Ensarij ka thënë: "Unë po e argumentoj këtë bazuar mbi fjalën e Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: "Nuk është hallall për burrin të shesë me një "saë" (enë matëse) tjetër, përveç "saë" që përdorin banorët e Egjiptit." "Saë" e banorëve të Egjiptit është orientim për përjashtimin e

mashtrimit, sepse "saë" e banorëve të Egjiptit është e njohur, kurse "saë" që kanë në përdorim banorët e vendeve të tjera është e panjohur, por, nëse "saë" e vendeve të tjera njihet (për saktësi), patjetër që shitja me atë "saë" është e vlefshme, sepse cili do të ishte ai jurist i ligjit të fesë, që do të ndalonte shitjen me "saë" që përdorin banorët e vendeve të tjera dhe jo me "saë" të banorëve të Egjiptit, kur dihet se "saë" që ata përdorin si sasi është e barabartë me "saë" të banorëve të Egjiptit, patjetër, nëse dy kontraktuesit: shitës–blerës, kanë miratimin e njëri-tjetrit për përdorimin e këtij lloj "saë".

Në mënyrë të përmbledhur themi se ndalimi ka të bëjë vetëm me shitjen me mashtrim dhe, kur mashtrimi përjashtohet me njërën prej mënyrave ose rrugëve, atëherë nuk ka më ndalim.

Veza, bostani dhe arra

Kur njohja me të vërtetën e sendit mundësohet vetëm me anë të thyerjes, ose çarjes, si për shembull, veza, bostani dhe arra, shtrohet pyetja: A lejohet që për këto lloje sendesh të vihet çmim, pa e ditur se si janë në brendësi dhe që të jenë të përjashtuara prej rregullit: "Çdo shitje që ka mashtrim, nuk lejohet."?

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorëve të librave "El Xhevahir" dhe "El Mekasib" se mosnjohja për këto lloje sendesh është e falur dhe shitja e këtyre sendeve është e vlefshme.

Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Nuk ka problem për vërtetimin e asaj që nuk njihet në këtë shitje, por për shkak të

qarkullimit të vazhdueshëm të këtyre mallrave nëpër qytete e nëpër vende të ndryshme ku ato shiten, ne jemi shprehur për lejimin e shitjes dhe i kemi përjashtuar këto lloje mallrash prej argumentit të mosnjohjes dhe mashtrimit.", domethënë, nuk është e nevojshme të njihet brendia e këtyre sendeve që të thuhet se ka mashtrim.

Autori i librit "El Mekasib" ka thënë: "Me fjalën e përbashkët të fukahave, lejohet shitja e atij që e prish prova, por pa e provuar."

Përballë kësaj thënieje, shumica e fukahave bazohen mbi traditën, e cila pohon se sendet, në natyrën e tyre, në shumicën e rasteve, janë të shëndosha, kurse individi i prishur është i rrallë, mirëpo i rralli nuk mund të merret si parametër, në një kohë kur dy kontraktuesit e kryejnë shitblerjen bazuar mbi këtë koncept. Kjo është e barabartë, qoftë kur dy kontraktuesit mendojnë qenien e sendit të mirë e të shëndoshë, qoftë kur mendojnë diçka tjetër, sepse njerëzit, që në kohët më të hershme, për një diçka që nuk njihet e nuk dihet, kanë dhënë e kanë marrë me njëri-tjetrin, bazuar mbi tolerancën. Për më tepër, edhe te fukahatë nuk ka asnjë rrugë për të hequr këtë mjedis paditurie e mosnjohje për brendinë e sendit, si dhe për faktin që vetë interesi e përfitimi është ndërtuar mbi këtë mënyrë veprimi. Veç kësaj, Allahu i Lartësuar nuk i detyron njerëzit me gjëra që i rëndojnë ata.

Por vlefshmëria e kësaj shitjeje, krahas mosnjohjes me të vërtetën e sendit, nuk e mohon të drejtën përzgjedhjes për personin te i cili transferohet sendi, kur del qartë prishja e atij sendi, madje për atë vërtetohet e drejta e përzgjedhjes për kthimin e çmimit, por jo refuzimi. Kthimi i çmimit bëhet atëherë kur

arrihet të shikohet dëmi, kurse mosrefuzimi nuk lejohet, sepse veprimi me të thyer (provë) ia ndalon kthimin e sendit të shitur pronarit të atij sendi. Është e kuptueshme se, kur e meta e sendit njihet me ndonjërën prej rrugëve të njohjes, atëherë edhe refuzimi lejohet, sepse sendi i vënë në shitje, në gjendjen që është, i kthehet pronarit ashtu siç e mori blerësi në dorëzim prej tij. Qëllimi i kërkimit të kthimit të çmimit, është, pronari i sendit t'i paguajë personit për te i cili u transferua sendi diferencën mes vlerës së sendit të paprishur dhe vlerës së atij të prishur.

Kur blerësi i vë kusht shitësit kthimin e çmimit, në rast se vërtetohet prishja dhe shitësi e miraton këtë kusht, atëherë kjo shitje është e lejuar. Gjithashtu, shitja është e vlefshme, edhe kur shitësi s'mban përgjegjësi për të metën që ka sendi dhe blerësi e pranon këtë kusht, sepse shitja e sendit me të meta është e lejuar, prandaj riskimi për sendin që i njihet e meta, i heq blerësit të drejtën e përzgjedhjes.

Në lidhje me këtë çështje, një grup fukahash, ndër të cilët edhe autori i librit "El Mekasib", kanë thënë: "Në të vërtetë, mospërgjegjësia e shitësit për prishjen ose për të metën e sendit, ka vlerë kur sendi i thyer ka çmim, qoftë edhe fare të vogël.

Por sendi i thyer që në fillim, nuk ka çmim dhe përfundimisht do të hidhet në koshin e plehrave, si për shembull, veza e prishur, pasi të thyhet. Kjo nuk rezulton që përgjegjësia të sjellë ndonjë dobi, sepse vetë shitja është e pavlefshme, për rrjedhojë blerësi ka të drejtë të kërkojë prej shitësit t'i kthejë çmimin e plotë.

Autori i librit "El Mekasib" ka thënë: "Sipas fjalës së përbashkët të një grupi fukahash të mëdhenj, rezulton: Sikur sendi që thyhet (për provë), të mos ketë vlerë dhe ajo që del pas thyerjes të jetë mall që merret në dorëzim, kjo shitje është e gabuar, është shitje e pavlefshme."

Kështu është shprehur shejkhu i grupit Et Tùsij, juristi El Hil'lij, El Al'làmeh, etj. Autori i librit "El Xhevahir" ka thënë: "Mospërgjegjësia për të metën ka vlerë, kur për sendin e thyer ka çmim, ndryshe blerësi ka të drejtë të kërkojë kthimin e çmimit. Nëse shitësi shfajësohet për të metën e mallit, për shkak të pavlefshmërisë së shitjes që kërkon kthimin e çmimit te ai që e mori sendin në dorëzim, kjo shitje është ngrënie e pasurisë me të padrejtë dhe marrje e çmimit pa dhënë mallin."

Ti mund të thuash: Ngrënia e pasurisë me të padrejtë realizohet kur shitja është bërë pa miratimin e pronarit dhe supozohet që blerësi ka riskuar me zgjedhjen e me vullnetin e tij, bazuar mbi kushtin e mospërgjegjësisë për të metën e sendit dhe është i kënaqur të marrë një mall tjetër, bazuar mbi vlerësimin e sendit të prishur.

Ne përgjigjemi: Njeriu ka të drejtë t'i dhurojë pasurinë e tij cilit të dëshirojë, por kjo është një gjë dhe shitja e sendit që s'ka vlerë, është një gjë tjetër. Më sipër kemi folur për kushtet e dy të shkëmbyeshmëve dhe kemi thënë se çdo njëri prej dy të shkëmbyeshmëve duhet të ketë çmim, pasi për sendin që s'ka çmim, nuk lejohet shitja e tij, por në çështjen tonë kemi supozuar që sendi i vënë në shitje nuk mund të ketë çmim, pra, shitja e këtij sendi është e pavlefshme, qoftë edhe me miratim të dyanshëm e me vetëzgjedhje.

I vogli në barkun e nënës, leshi dhe i sendi i ambalazhuar

Fukahatë, pa përjashtim, ndajnë një mendim të përbashkët se vetëm të voglit në barkun e nënës së tij nuk është e vlefshme as t'i vihet çmim e as të konsiderohet mall, për shkak se ka vend për mashtrim, por lejohet shitja e tij së bashku me nënën. Thënë më qartë, lejohet shitja e nënës barrsë.

Për sa i përket shitjes së leshit e të fijeve mbi shpinat e bagëtive, fukahatë më në zë janë shprehur për mosvlefshëmirinë e shitjes.

Një grup prej juristëve të mëdhenj, ndër të cilët Mufijdi, El Al'làmeh, Dëshmori i dytë, Ibn Idrijsi dhe Muhak'kiku kanë thënë: "Është e vlefshme shitja e leshit dhe e fijeve para qethjes, sepse nuk dihet sa peshojnë, pra, është plotësisht si lejimi i shitjes së frutave në pemë."

Esh'shejkhijdi ka shtuar: "Patjetër qethja duhet të bëhet në çast, ose me kusht që të qëndrojë mbi shpinën e kafshës deri në një kohë të njohur."

Fukahatë më të mëdhenj, bazuar mbi dëshminë e autori të librit "El-Xhevahir" dhe të librit "El Mekasib" janë shprehur se lejohet shitja e vajit dhe e yndyrës së ambalazhuar për çdo "ritl", me një çmim të njohur, gjithnjë bazuar mbi faktin e njohur që ambalazhi të përmbajë një "ritl" ose edhe më shumë. Me miratim të dyanshëm, është e falur, kur ambalazhi përmban më shumë ose më pak.

Një burrë i tha Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Të lutem më thuaj, kur unë nxjerr në shitje yndyrë e vaj të ambalazhuar me një*

sasi të caktuar "ritll" për çdo ambalazh, por mbase ai ambalazhim mund të ketë më shumë, por mund të ketë edhe më pak. A është e drejtë shitja që unë bëj? Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* iu përgjigj: *"Kur është me miratimin tënd, s'ka problem."*

Kjo lloj shitje, te fukahatë, njihet me emrin shitje me zbritje dhe qëllimi këtu është për një sasi të caktuar e të njohur për çdo ambalazh.

Gjithashtu, fukahatë më të dëgjuar kanë lejuar shitjen e mallit e të ambalazhit së bashku për çdo *"ritl"*, me një çmim të caktuar, siç është e njohur në praktikën e zakonshme që ndiqet në ditët tona për blerjen e frutave e të zarzavateve së bashku me kutitë ku janë ambalazhuar, ose mallra të lëngshme, ose të thata të ambalazhuara.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kur dihet tërësia e sendeve (që peshohen) dhe që nuk janë të ambalazhuara, është e mjaftueshme njohja vetëm me disa pjesë."

Ajo që përfitojnë fukahatë nga këto thënie e nga shumë thënie të tjera të ngjashme, rezulton se të gjitha veprimet që kryhen sipas traditës, në lidhje me rrugët e njohjes me të dy të shkëmbyeshmit, si dhe me tolerancën e njerëzve për mosjohjen me sendin, ajo shitje është e lejuar dhe nuk është e ndaluar, edhe atëherë kur ai bën vetëm një shitje "në degë", pa e thyer e pa e prishur sendin, krahas mundësisë për njohjen me sasinë e atij sendi në mënyrë të hollësishme, siç është shitja e leshit të pahequr prej shpinës së dhenve. Nuk ka argument më të drejtë e më domethënës për vërtetimin e kësaj çështjeje se fjala e Imam

Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"Kur kjo është me miratimin tënd, s'ka asnjë problem."*

Kushtet e kontraktimit dhe kushtet e përmbajtjes

Nga sa kemi thënë më sipër, rezulton që formula e shitjes patjetër duhet të tregojë qartë qëllimin e shitjes dhe propozimi të përputhet me pranimin për një send të vetëm.

Gjithashtu, për të dy kontraktuesit merret në konsideratë mendja, mosha madhore, qëllimi, krahas vetëpërzgjedhjes, personi nuk është naiv, nuk vuan nga ndonjë sëmundje vdekjeprurëse, kur i sëmuri nuk vepron me më shumë se një të tretën e pasurisë së tij, është kusht që dy të shkëmbyeshmit të jenë mall dhe pronë absolute, domethënë që janë të pakushtëzuara.

Gjithashtu, është kusht që personi të ketë fuqi zotëruese mbi dy të shkëmbyeshmit dhe të këtë dijeni për dy të shkëmbyeshmit.

Tani do të vëmë në dukje se përzgjedhja, aftësia për të vlerësuar dhe shëndeti te kontraktuesit nuk janë kushte për lidhjen e kontratës, sepse origjina e ekzistencës së kontratës, në të vërtetë, është kushti i përmbajtjes së kontratës dhe ekzekutimi i saj.

Theksojmë se kontrata e të imponuarit plotësohet, por ajo nuk bëhet e detyrueshme, përveçse kur i imponuari e miraton shitjen pas imponimit. Kështu qëndron çështja edhe me vlefshmërinë e kontratës së naivit, e cila bëhet e detyrueshme vetëm kur arrihet të merret prej kujdestarit lejimi për shitjen e

bërë prej naivit. E ngjashme me këtë është edhe kontrata e të sëmurit që lëngon prej ndonjë sëmundjeje vdekjeprurëse, për shkak se ekzekutimi i kësaj kontrate varet prej lejimit të trashëgimtarëve, kur i sëmuri ka vepruar me më shumë se një të tretën e pasurisë së tij.

Gjithashtu, është kusht pronësia e plotë mbi çmimin dhe mbi sendin e vlerësuar, që janë kushte për përmbajtjen e kontratës dhe kushte për ndërtimin e kontratës, patjetër jo në të gjitha marrëdhëniet e ndërsjella. Kemi thënë se edhe kontrata e *el fudulijit* është e vlefshme dhe nuk është e domosdoshme lejimi i pronarit, gjithashtu, e vlefshme është edhe kontrata e penglënësit dhe ajo ekzekutohet me lejimin e pengpranuesit, kurse shitja e sendit vakëf, edhe kur ka lejim, është e pavlefshme që në bazë.

Përveç vullnetit, aftësisë për të vlerësuar, shëndetit dhe pronësisë absolute mbi dy të shkëmbyeshmit, duhet të shtohet edhe kushti për lidhjen e kontratës. Kjo është e barabartë, qoftë kur është prej kushteve të formulimit, qoftë kur është prej kushteve të dy kontraktuesve, qoftë kur është prej kushteve të dy të shkëmbyeshmëve.

Është kusht, nëse njëri prej këtyre kushteve mungon, kontrata, që në bazë, është e pavlefshme dhe për atë kontratë ndryshojnë të gjitha dispozitat, por kur kushtet janë të gjitha të plota, atëherë kontrata e shitjes bëhet e detyrueshme, përveçse kur ajo është e bashkuar me njërën prej përzgjedhjeve, për të cilat do të flasim në kapitullin vijues.

Marrëdhënie të ndërsjella, marrëdhënie të ndaluara

Është mjaft e lakueshme në gjuhë të ndryshme se ndalimi i adhurimeve ka të bëjë me prishjen e adhurimeve, por jo për ndalimin e marrëdhënieve të ndërsjella. Në të vërtetë, ndalimi tregon vetëm rastin kur bashkëpunimi i ndërsjellë, si veprim, është haram. Por ky ndalim, në vetvete, nuk tregon prishje, as në adhurime e as në marrëdhëniet e ndërsjella.

Ligjvënësi të thotë ty: "Mos laj papastërtinë me ujin e rrëmbyer! Mos ther delen e tjetrit! Mos e ndaj kokën e bagëtisë prej trupit të saj gjatë kohës së therjes!" Ti e kundërshton këtë urdhër dhe lan papastërtinë me ujë të rrëmbyer, ther delen e tjetrit dhe e ndan kokën e bagëtisë prej trupit të saj në kohën e therjes. Në të vërtetë, rroba e papastër pastrohet, mishi i deles së tjetrit nuk është haram, edhe pse ti je mëkatar për shkak të kundërshtimit të urdhrit, për rrjedhojë, ke ekspozuar veten ndaj zemërimit e dënimit të Allahut. Kur ndalimi nuk tregon për prishje, pa qenë i shoqëruar me një shembull të ngjashëm, marrë prej një burimi të vjetër, patjetër që nuk është argument kundër tij në të gjitha burimet, pa shembull krahasues, adhurim ose çdo veprim tjetër qoftë.

Që një send të jetë haram, çdo send qoftë, është kërkesë që ai send të jetë i urryer dhe i dëshiruar. Logjikisht, adhurimi për Allahun Fuqiplotë nuk vlen me atë çka Ai e urren, sepse bindja e nënshtrimi ndaj të Plotpushtetshmit nuk tregohet me mënyra e rrugë që përbëjnë kundërshtim flagrant të urdhrit të Allahut.

Bazuar mbi këtë që u tha, adhurimi me rrugë të ndaluara, nuk është i pranueshëm te Allahu i Lartësuar dhe nuk ka kuptim

të flitet për prishjen e adhurimit përveçse me këto që u thanë. Prej këtu bëhet e qartë se argumenti i ndalimit, bazuar mbi prishjen e adhurimit, ka ardhur me ndërmjetësinë e mendjes dhe dispozita për këtë është: Sendi i urryer nuk mundëson afrim te Allahu i Lartësuar; kurse ndalimi për bashkëpunim të ndërsjellë, nuk tregon as prishje të bashkëpunimit, në vetvete e as me ndërmjetësim. Mbase ky është edhe qëllimi i atij që ka thënë: "Ndalimi për adhurimet tregon prishje, por jo për bashkëpunimet e ndërsjella."

Megjithëkëtë, ligjvënësi shpesh ndalon edhe marrëdhënie të ndërsjella, duke dhënë udhëzimin e drejtë se, në themel, ato nuk janë marrëdhënie ligjore, si për shembull, shitja me guralecë[1], ose ato marrëdhënie kanë humbur njërin prej kushteve, si për shembull, shitja e të çmendurit, ose e fëmijës që nuk ka arritur moshën që të dallojë, ose kur sendi i vënë në shitje është i atillë që as merret e as jepet në pronësi, si për shembull, vera e derri, përfshirë këtu sende të tjera, për të cilat mund të renditen efektet e mosvlefshmërisë, për shkak të mosplotësimit të të gjitha kushteve.

Thënë ndryshe, ligjvënësi ka ndalur marrëdhënien e ndërsjellë të prishur, prishja e së cilës ka dalë prej një pune tjetër përveç ndalimit. Për këtë shkak, fukahatë ndajnë mes tyre një fjalë të vetme: Marrëdhëniet e ndërsjella që plotësojnë të gjitha kushtet, janë të efektshme dhe asnjë dispozitë prej dispozitave të këtyre marrëdhënieve, nuk ndryshon, edhe kur ligjvënësi i ka ndaluar ato për ndonjë shkak të jashtëm, si për shembull, ndalimi i

[1] Shitja me gur ishte zakon i njerëzve gjatë kohës së injorancës para Islamit, kur blerësi thoshte se rroba mbi të cilën do të bjerë guraleci, me të cilin do të qëlloj unë, është për mua.

shitblerjes në kohën që thirret Ezani për faljen e namazit të xhumasë.

Është e qartë që shitësi e blerësi është mëkatar dhe meritojnë qortim e dënim, për shkak të kundërshtimit të urdhrit për të mos bërë shitblerje në këtë kohë.

Shkurtimisht themi se formula e ndalimit tregon vetëm ndalim të prerë (haram), ndalon të keqen dhe ndalon kundërshtimin, kur për këtë kundërshtim nuk gjendet shembull i ngjashëm. Por kjo është një gjë dhe heqja e efektit prej punës ose prej fjalës, është një gjë tjetër. Por duke qenë se qenia haram e një sendi (veprimi), ndalon afrimin te Allahu i Lartësuar me atë send, për shkak të këtij sendi të ndaluar prishet adhurimi, pra, ndalimi është që adhurimi të mos kryhet me atë send, por jo se ndalimi tregon pavlefshmërinë e adhurimit.

Bashkëpunimi i ndërsjellë, nuk ka qëllim afrimin te Allahu i Lartësuar, prandaj ai vazhdon të mbetet shkak për efekt dhe përfitim, edhe në kohën e ndalimit, pra, mbetet ashtu siç ishte edhe para kohës së ndalimit.

Ngritja e çmimit, me qëllim që blerësi ta marrë mallin sa më shtrenjtë *(nexhesh)*

Nga ana gjuhësore, fjala "nexhesh" do të thotë "shtim". Qëllimi i përdorimit të kësaj fjale këtu që është të tregojë një veprim që bën pronari mbi mallit që shet diçka. Kur pronari i mallit nxjerr në shitje, bën marrëveshje me një person tjetër dhe ky i fundit, në prani të njerëzve, jep një çmim të lartë për sendin e

vënë në shitje, me qëllim që, kur e shikon ai që ka me të vërtetë qëllim të blejë atë send, mendon se, me të vërtetë, dëshiron ta blejë sendin me çmimin që ofron, kështu që shikuesit i shtohet dëshira ta blejë atë send me një çmim më të lartë nga sa ofroi personi i porositur për këtë veprim.

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët se kjo lloj shitje është haram. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në të vërtetë, është mashtrim, pabesi, është nxitje për mashtrim më anë të mosnjohjes me sendin, pra, është dëmtim i drejtpërdrejtë."

Në hadith thuhet: "Është i mallkuar mashtruesi që rrit çmimin pa pasur qëllim blerjen, por e jep atë çmim me qëllim për të rritur çmimin e sendit. I mallkuar është edhe ai që dëmton tjetrin me gënjeshtrën e tij."

Fukahatë kanë thënë se, sikur ai që e shikon këtë veprim dhe e ble sendin, shitja është e vlefshme, për shkak se ndalimi ka ardhur prej një shkaku që është jashtë të vërtetës së bashkëpunimit të ndërsjellë, por ky blerës ka të drejtën e përzgjedhjes, kur konstatohet se është mashtruar.

Ibn Xhunejdi ka thënë: "Kjo marrëdhënie e ndërsjellë, që në krye, është e pavlefshme."

* * *

MONOPOLI

Monopoli është haram, logjikisht e ligjërisht *(me sheriat)*

Të gjithë myslimanët, pa përjashtim, kanë një fjalë të përbashkët se monopoli është haram, si ide e bazuar në tekst. Autori i librit "El Xheuahir" e ka përshkruar atë: "Një të keqe logjike, prej së cilës dalin dëmet që vijnë mbi myslimanët, një e keqe që logjikisht kërkon kujdes të veçantë për të qenë i ruajtur dhe si një veprim që është në kundërshtim me shpirtin kavalaresk e me zemërbutësinë, dy cilësi për të cilat njeriu është urdhëruar."

Në lidhje me shpirtin kavalaresk e me zemërbutësinë, shejkhu i grupit, në kohën e tij, ka nxjerrë parime fetare e dispozita ligjore, si qenia haram e monopolit. Ky shejkh i madh ka vdekur në vitin 1266 të hixhrit, në atë kohë kur nuk kishte as bomba atomike, as bomba me hidrogjen e as armë të skëterrës…

Do të dëshiroja që shejkhu i madh të jetonte këtë kohë që të shikonte "shpirtin kavalaresk e zemërbutësinë" e Perëndimit kolonizator.

Pavarësisht nga shpirti kavalaresk e zemërbutësia, te ne gjendet më shumë se një normë ligjore, që e bën të detyruar

shpalljen haram të monopolit. Ndër këto norma ligjore përmendim: "S'ka dëmtim e as përgjigje të dëmtimit me dëmtim."; "Sprapsja e të prishurës ka më përparësi se sjellja e asaj që paraqet interes, sidomos kur e keqja është e përgjithshme, sepse ajo që paraqet gjithmonë interes është individuale."; "Më e rëndësishmja ka përparësi ndaj më pak të rëndësishmes, edhe nëse atje është e rëndësishme, përfshirë edhe paprekshmërinë e jetës."

Autori i librit "El Mesalik", i njohur me emrin Dëshmori i dytë (Shehidu Thanij), në kapitullin "Ushqimet e pijet", thotë: "Në qoftë se ai që ka nevojë të ngutshme për ushqime dhe ka fuqi të mposhtë monopolizuesin, e lufton këtë të fundit dhe, nëse, në këtë rast, vritet ai që është në nevojë të ngutshme, ai është person i dhunuar nga padrejtësia. Nëse vritet pronari i ushqimeve, gjaku i tij shkon i humbur."

Gjithashtu, prej këtyre normave ligjore ka që janë shkak i plotë për të bërë haramin haram. Përvojat dhe koha kanë vërtetuar se monopoli është shkaku i plotë i kolonializmit, i luftërave e i robërimit të popujve, është shkak për mundimin e miliona njerëzve e për përhapjen e tmerrit e të frikës në shpirtrat e njerëzve[1], është shkak për prishjen e sigurisë e të sistemit, për përhapjen e gënjeshtrës, të falsifikimit dhe të shpifjes në dëm të të pafajshmëve, është shkak për përhapjen e ngatërresave, të fanatizmit të grupit e dallimit racial, është shkak për sundimin e të

[1] Sot me datë 09.06.1965 kam lexuar në gazetën egjiptiane "Al Akhbàr" se sasitë e depozitave atomike mjaftojnë për të shkatërruar planetin tonë dhe çdo njeriu që gjendet mbi sipërfaqen e tokës, i takon prej kësaj sasie më shumë se 60 tonë lëndë shpërthyese, në një kohë kur një e treta e njerëzimit në ditët e sotme është viktimë e urisë, e sëmundjeve dhe e prapambetjes.

poshtërve e tradhtarëve dhe arbitraritetin e këtyre mbi vendet e mbi njerëzit.

Gjithashtu, monopoli është shkak për të devijuar ligjin islam, për të futur sajesat në fe dhe për të paraqitur Islamin e myslimanët në pamjen më të keqe nëpërmjet rrogëtarëve e oportunistëve, të cilët qëndrojnë fshejkhur në mesin e njerëzve të zakonshëm. Veç të këqijave të lartpërmendura, monopoli është shkak për shpenzimin e kapaciteteve e i bukës së përditshme për llogari të makinerive të shkatërrimit, është shkak për privimin e nevojtarëve prej sendeve më të nevojshme të jetesës, si dhe të tjera dukuri që ne i shikojmë sot.

Për sa i përket teksteve ligjore, ato janë në kufirin më të lartë të saktësisë, qoftë kur ato tekste janë të transmetuara me rrugët e Ehli Sunetit, qoftë kur tekstet janë të transmetuara me rrugët e shi'ave. Ndër këto tekste përmendim transmetimin e ardhur prej Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, i cili ka ndalur ushqimet të bëhen monopol dhe ka thënë: *"Ai që monopolizon, nuk do të vdesë, derisa Allahu ta godasë atë me sëmundjen e lebrozës, ose me falimentim. Në Xhehenem gjendet një luginë e veçantë për ata që praktikojnë monopolin, për alkoolistët e për imoralët."*

Gjithashtu, prej këtyre teksteve kemi edhe fjalën tjetër të të Dërguarit më të madh *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Sjellësi i ushqimeve është i furnizuar dhe monopolizuesi është i mallkuar."*

Në këtë hadith ka një argument mjaft të qartë, që tregon se ai që importon sende për të cilat njerëzit kanë nevojë, me qëllim që

të lehtësojë gjendjen e tyre, ky importues, te Allahu është i pasur, kurse monopolizuesi është njeri i ulët e i keq.

Prej teksteve kemi edhe fjalën e Imam Bakirit *(Paqja qoftë mbi të!)*, babait të Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)*, i cili tregon se i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Çdo burrë që ble një ushqim dhe e mban atë të mbyllur dyzet mëngjese, me qëllim që të shtrenjtohet, pastaj ai e shet atë ushqim, sikur ai të japë sadaka të gjitha paratë që fitoi nga kjo shitje, kjo nuk do të mjaftonte për shlyerjen e asaj që bëri."*

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se gjykimi i praktikuesve të monopolit, të cilët mbulojnë të këqijat e tyre, duke shpenzuar në punë publike, gjykimi i këtyre njerëzve te Allahu është si gjykimi i edukatores së jetimëve.

Në librin "Nehxhul Belàgah" tregohet se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* në kohën e tij i tha Eshterit: *"Kush monopolizon, pasi ti e ke ndaluar monopolin, atë person prangose, por pa e tepruar."*

Thënie të tjera në këtë kuptim ka aq shumë, sa nuk mund të numërohen.

Çdo gjë për të cilën njerëzit kanë nevojë

A është haram të monopolizohen të gjitha gjërat për të cilat njerëzit kanë nevojë, si: ushqime, veshje, pije e vegla, apo është haram vetëm monopolizimi i ushqimeve, ose, sikurse thuhet qenia haram e monopolit ka të bëjë me një lloj të veçantë ushqimesh, si: gruri, elbi, hurma e rrushi i thatë (stafidhe)?

Prej autorit të librit "El Xheuahir" në pjesën "Tregtia", del e qartë se fukahatë kanë një fjalë të përbashkët për qenien haram të monopolit mbi çdo send për të cilin njerëzit kanë nevojë të domosdoshme, i çdo lloji qoftë ai send, pa asnjë përjashtim. Por ata kanë mendime të ndryshme në lidhje me faktin, kur nevoja për atë send nuk ka arritur në kufirin e domosdoshmërisë. Tekstualisht për këtë çështje ai ka shkruar: "Monopoli është haram për çdo lloj sendi për të cilin kanë nevojë njerëzit, aq më tepër kur nevoja për atë send është domosdoshmëri, pa i dhënë përparësi, nëse sendi është prej atyre që hahet, ose pihet, ose është veshje, apo ndonjë send tjetër, pa e kushtëzuar me një kohë apo me një kohë tjetër, ose është i kushtëzuar që një mall është haram të monopolizohet, kurse monopoli mbi një mall tjetër nuk është haram. Gjithashtu, pa e kushtëzuar që malli të transferohet me kontratë, as me ndonjë kufizim, kur nevoja ka arritur cakun e domosdoshmërisë. Pikërisht në këtë kohë, patjetër duhet të caktohet një çmim tavan i përballueshëm prej konsumatorëve, kur monopolizuesi e tejkalon rritjen e çmimit, madje nuk është larg të flitet se është haram vetë shtrenjtimi i sendit dhe dëshira e monopolizuesit për të rritur çmimin, me qëllim dëmtimin e njerëzve, qoftë edhe kur njerëzit nuk kanë nevojë, ose edhe kur mallrat janë me shumicë, pasi këtu bëhet fjalë që qenien haram thjesht për qëllimin e shtrenjtimit të mallit dhe dëshirës që ka monopolizuesi për shtrenjtimin e çdo sendi që gjendet te ai, edhe nëse me shtrenjtimin e mallit, në të vërtetë, ai nuk ka qëllim dëmtimin. Përsëri autori i lartpërmendur tërheq vëmendjen me fjalën e tij dhe thotë: "Monopolizuesi, thjesht nga dëshira për rritjen e çmimit, ka kryer një veprim haram."

Në vijim, autori i librit "El Xheuahir" thotë: "Në të vërtetë, fjala për mendime të ndryshme në mesin e fukahave, në lidhje me monopolizimin, ka të bëjë me mbajtjen mbyllur të ushqimeve në pritje të shtrenjtimit të mallrave në treg, në një kohë kur njerëzit kanë nevojë për ato mallra, edhe pse nevoja e tyre nuk ka arritur deri në cakun e domosdoshmërisë."

Kjo do të thotë se, kur nevoja për një send arrin cakun e domosdoshmërisë, monopolizimi i atij sendi është haram, pavarësisht nga lloji i sendit, por, kur nevoja ka arritur në cakun e domosdoshmërisë, fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse është haram monopolizimi i çdo sendi, apo është haram vetëm monopolizimi i ushqimeve, ose ndonjë lloj i veçantë ushqimesh, si: gruri, elbi, hurma e rrushi i tharë (stafidhe), për të cilat thuhet se në mënyrë absolute është haram që këto ushqime të monopolizohen, madje edhe atëherë kur nevoja për këto ushqime nuk ka arritur shkallën e domosdoshmërisë, kurse për mallrat e tjerë, përveç mallrave të lartpërmendur, është haram që ato të monopolizohen, kur nevoja për ato ka arritur shkallën e domosdoshmërisë.

Në të vërtetë, është haram monopolizimi i çdo sendi, domethënë se është haram monopolizimi i sendeve për cilat njerëzit kanë nevojë, është haram, si parim i përgjithshëm dhe si rregull gjithëpërfshirës, është haram plotësisht ashtu siç është haram edhe kamata.

Pra, monopoli mbi një send është haram vetëm për shkak të nevojës që kanë njerëzit për sendin e monopolizuar. Kjo është e barabartë, qoftë kur nevoja ka arritur cakun e domosdoshmërisë, qoftë kur nevoja për atë send nuk e ka arritur këtë cak. Për sa i

përket përmendjes së grurit, elbit, hurmave, rrushit të thatë dhe vajit, në disa transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)* ka të bëjë me faktin se për shumicën e njerëzve të asaj kohe, këto ishin sendet më të nevojshme, megjithëkëtë kurrë e asnjëherë nuk lejohet që këto ushqime të përmenden për të kushtëzuar një rregull të përgjithshëm, të vërtetuar me argumente taksative. Një pjesë e të cilave u përmendën më sipër, pasi ka disa transmetime të qarta që e mbështesin këtë çështjen e fundit.

El Halebij ka përcjellë se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Në qoftë se në Egjipt ka ushqime të tjera, s'ka asnjë problem."*, domethënë, kur njerëzit janë në ngushticë, atëherë monopolizimi i ushqimeve është problem.

Në librin "El Mekasib" është përmendur se shejkhu Et Tùsij, i njohur me emrin Shejkhu Taifeh, El Kàdij, autori i librit "El Uesijleh" dhe autori i librit "Ed Durus" kanë thënë: "Është e qartë se ndalimi i monopolizimit ka të bëjë me nevojën e njerëzve, që do të thotë se shkaku i ndalimit të monopolizimit, qëndron në nevojën që kanë njerëzit për ato sende."

Më poshtë, autori i librit "El Mekasib", në komentin e kësaj sentence, thotë: "Kjo është e mirë."

Të gjithë atyre që e kanë reduktuar qenien haram të monopolizimit të sendeve të nevojshme vetëm me grurin, elbin, hurmat dhe rrushin e thatë (stafidhet), ne u themi: Bazuar mbi këtë që ju thoni, jeni të detyruar të pohoni se monopoli mbi naftën e mbi rrymën elektrike nuk është haram, kur dihet se jeta e sotme është e pamundur pa këto dy produkte.

Gjithashtu, jeni të detyruar të pohoni se monopoli mbi armët dhe ndalimi i armëve për atë që ka qëllim të mbrojë veten, është hallall dhe s'ka asnjë problem, kur dihet mirë dëmi që vjen në ditët e sotme prej monopolizimit mbi hurmat e stafidhet. Jam i bindur se kolonialisti, kur të mësojë për këtë sentencë *(fetvà)*, do të bënte ruku e sexhde, do ta shkruante këtë fetva me shkronja drite, do ta përhapte e do ta transmetonte atë në çdo cep të botës, pasi, sipas kësaj fetvaje, për atë qenka haram vetëm monopoli mbi hurmat e mbi stafidhet, ndërsa i lejohet të monopolizojë hekurin, çelikun, arin e zi e arin e verdhë… Duke vijuar përgjigjen tonë, themi se dogmatizmi i bazuar, në kuptimin e tekstit, germë për germë, për të tilla vendburime, është goditje mbi fenë dhe mbi ligjin e fesë me të cilën erdhi zotëria i të Dërguarve *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Detyrimi dhe vënia e çmimit

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se gjykatësi, zëvendësi i tij dhe drejtuesi i punëve të myslimanëve, kur është i justifikuar moskontaktimi me sundimtarin, kanë detyrë të detyrojnë monopolizuesin të nxjerrë mallin në treg. Si dëshmi për këtë çështje kemi transmetimin e ardhur prej Imam Sadikut *(Paqja qoftë mbi të!)* se një herë, në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* mbaruan ushqimet dhe për këtë njerëzit shkuan te ai dhe i thanë: *"O i Dërguar i Allahut, ushqimet u mbaruan dhe kanë mbetur fare pak, por ato i ka filani, prandaj urdhëroje atë që t'i shesë ato ushqime për njerëzit."*

Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ngjit në minberin e xhamisë, falënderoi Allahun e Lartësuar dhe pastaj tha: *"O filani, myslimanët më njoftuan se ushqimet mbaruan, përveç atyre pak ushqimeve që janë te ti, prandaj nxirri menjëherë ato në shitje."*

Për sa i përket çështjes së vënies së çmimit ashtu siç e mendon gjykatësi, shejkhu El Ensarij, në librin "El Mekasib", kapitulli "Pranimet", ka cituar se gjykatësi e sundimtari ka të drejtë të caktojë çmimin ashtu siç e mendon ai se është në interes të të gjithëve.

Gjithashtu, autori i librit "El Mekasib" ka cituar prej El Al'lameh, prej djalit të tij, Fahkrul-muhak'kikijn dhe prej Esh'shejkhijdit se sundimtari e gjykatësi kanë të drejtë të vënë çmim për monopolizuesin, edhe nëse në caktimin e çmimit bën padrejtësi, ai e bën vetëm për të mënjanuar dëmin.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit "El Xheuahir", tekstualisht është shprehur: "Po, nuk përjashtohet sprapsja e dëmit që mund të vijë prej monopolizuesit, krahas padrejtësisë në caktimin e çmimit."

Për mënjanimin e dëmtimit janë shprehur edhe Ibn Hamza, El Fadili, Dëshmori i dytë e të tjerë fukaha, pasi, nëse nuk do të ishte kështu, patjetër që nuk mund të përfitohej prej dobisë që sjell detyrimi, kur monopolizuesi kërkon një çmim të papërballueshëm prej njerëzve dhe kështu ai dëmton gjendjen e tyre, kurse qëllimi është largimi i dëmit.

Ne nuk dyshojmë se qeverisja e sundimtarit të drejtë, në mbrojtje të interesave të masave të gjera dhe kujdesi i kësaj

qeverisje përfshin vënien e një çmimi që është në interes të shitësit dhe të konsumatorëve, plotësisht siç përfshin edhe detyrimin e monopolizuesit për të nxjerrë në treg mallrat e mbyllura. Thënia se ky rregull përfshin detyrën që ka qeveria për të detyruar dhe nuk përfshin vënien e çmimit, është një thënie arbitrare, përderisa qëllimi është unik, domethënë se qëllimi është sprapsja e së keqes.

Në të vërtetë, njerëzit janë të kënaqur me thënien e hadithit: "Rrjedha e punëve dhe e dispozitave gjendet në duart e dijetarëve."

E mbyllim këtë kapitull me atë që është shkruar në librin "El Uesail": "Në njërin prej viteve, u ndërpre ardhja e ushqimeve në Medinen e ndritur dhe njerëzit e blinin ushqimin e tyre vetëm për një ditë. Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha njërit prej shërbyesve të tij: *"Sa ushqim gjendet te ne?"*

Shërbyesi iu përgjigj: *"Aq sa mjafton për një muaj."*

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha shërbyesit: *"Shite atë ushqim."*

Shërbyesi vazhdoi të thotë: *"Në Medine s'ka ushqime."*

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e urdhëroi përsëri: *"Shite!"*

Pasi shërbyesi e shiti ushqimin, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: *"Tani do të blesh ushqim ditë për ditë si të gjithë njerëzit."*

Gjithashtu, në librin "El Uesail" tregohet se banorët e Medines në një vit u prekën nga një thatësirë e madhe, aq sa edhe burri i pasur, për të gatuar bukën, përziente grurin me elbin, ndërkaq te Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte ushqim të mirë.

Prandaj ai i tha shërbyesit të vet: "*Shko e bli për ne elb dhe përzije me këtë ushqim, kurse grurin që kemi, shite, sepse ne e konsiderojmë veprim të urryer të hamë gjë të mirë, kur njerëzit hanë gjëra të rëndomta.*"

Vetëm Allahu e di më mirë ku e vë mesazhin e Tij.

Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin tonë dhe mbi pjesëtarët e pastër të familjes së tij!

* * *

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE…… 5
Libri i fitimeve- Libri "El Mekasib"……..……7
Shtëpia e shëndoshë "Bejtul "El Kasijd"……9
Hadithi dhe rivajeti……...…10
Ka mbetur edhe diçka……..11
SHITBLERJA (në kontratë)……...…13
Pjesët e fik'hut……...…13
Marrëveshja, premtimi dhe kontrata……..…14
Fjala dhe puna ……...…17
Kontrata e re……...…...20
Teoria e përgjithshme ……...…23
Kategoritë e kontratës……..……25
Kuptimi i shitblerje……...……29
Kategoritë e shitblerjes……..……30
DHËNIA E DYANSHME……32
Thëniet……32
Thënia më e saktë……...……37
Dhënia e njëanshme……...……41
Përgjigje……...……42
Kushtet……..……..44
Shkëmbimi……..……46
Dhënia e dyanshme jo në shitblerje……47
KUSHTET E KONTRATËS……..……51
Dy kolonat e kontratës……..……51
E vërteta dhe metafora……53

Gjuha arabe……54
Shprehja në kohën e shkuar……55
Më parë propozim-oferta……58
Përgjigje……59
Veprimet njëri pas tjetrit……60
Varësia……61
Harmonizimi mes propozimit e pranimit……64
Humbja e kompetencës para plotësimit të kontratës……65
Dobitë……66
Bërja me shenjë dhe e shkruara……67
Përmbledhje……68
MARRJA E SENDIT ME KONTRATË TË PRISHUR ……71
Kuptimi i rregullit……72
E kundërta e rregullit……75
Argumenti……76
Dobitë……77
Përgjigje ……78
I ngjashmi dhe i vlerësuari……78
Përgjigje:……79
KUSHTET E DY KONTRAKTUESVE ……81
Aftësia (kapaciteti)……81
MOSHA MADHORE (bulùg)……86
I çmenduri ……86
I vogli……87
Besimi islam i fëmijës……89
Adhurimi i fëmijës……89
Testamenti dhe sadakaja e fëmijës ……91
Divorci i fëmijës……92
Gjobitja e fëmijës……92
Ndëshkimi i fëmijës……93

Fëmija ka pasuri me kontroll……...…94
Kontrata e fëmijës……..…94
Autorizimi i fëmijës dhe i të çmendurit……..…98
QËLLIMI DHE ZGJEDHJA……..…99
Çfarë detyrë të merret në konsideratë me qëllimin?.....99
Qëllimi pa imponim……...……101
Njeriu në gjumë dhe të ngjashmit me të ……101
Imponimi……...……102
Pranimi i Islamit prej të frikësuarit……...…104
I detyruari nga nevoja……104
Kuptimi i imponimit……...……107
Imponimi me të drejtë……108
Lejimi nga ana e të imponuarit……..……108
Imponim për shuma parash……...……109
Përcaktimi i pronarit……...…111
Identiteti i kontraktuesit……112
Bisedimi me mbajtësin e procures……115
I prokuruari dhe dispozita e kontratës……116
RREGULLI I SHPREHJES SË QËLLIMIT……119
Rregull……...……119
Toka……...……122
Shtëpia……...……123
Kopshti……..……124
AI QË SHET PASURINË E TJETRIT (el fudùlij)……126
Kuptimi i fjalës "el fudulij"- (ai që shet pasurinë e tjetrit)……127
Nijeti në shitjen e mallit të tjetrit, pa lejen e pronarit……129
Penglënësi real……..……129
Objekti i shitjes së mallit të tjetrit……...……131
Sendi konkret dhe në mirëbesim……...…132
Nuk dihet se është mall i tjetrit……..…133

Kush merr mallin, paguan çmimin……..…135
Ndalimi i shitjes……..……136
Shitja e rrëmbyesit……..……136
Kontrata e elfudulijit në përputhje me rregullin……139
Kushtet e lejuesit……..……143
Shitja e penglënësit……..…145
Shitja e naivit……...…146
Shet një send dhe më pas e pronëson……..……146
Besimi dhe realiteti……..……147
Vendlejimi……148
LEJIMI DHE DISPOZITAT E LEJIMIT……150
Kuptimi i lejimit……..……150
Lejimi dhe pronësimi ……..……151
Kushtet e efektit të lejimit……..152
Marrja në dorë dhe lejimi i kontratës……...……157
Lejimi është zbulues apo është transferues?.....158
Dallimi mes zbulimit e transferimit……..……160
REFUZIMI DHE DISPOZITAT E REFUZIMIT……..…164
Kuptimi i fjalës "refuzim"……..…164
Veprimi mohues……...…165
Veprim jo asgjësues për pasurinë……..…166
Pronari dhe blerësi……..……167
Blerësi dhe elfuduliji ……..…168
Kërkohet vetëm çmimi……...…168
Kërkohet më shumë se çmimi……...…171
Qarkullimi nëpër disa duar……...……174
Pronari dhe duart që e qarkulluan……...…175
Duart që morën sendin janë së bashku njëra me tjetrën……...…177
Përmbledhje……..……180
Vlera……...……181

KUSHTET E DY TË SHKËMBYESHMËVE……183
Pasuritë dhe dobia e lejuar ……...…184
Pushtet i plotë mbi sendin……191
Blerja me mall të rrëmbyer……191
Aftësia për të dhënë në dorëzim……...…193
Fuqia për të merituar……...…194
Vetëm fuqia e blerësit……..……195
Mos shit atë që nuk është te ty……..196
Është e pavlefshme shitja e mallit të futur në një mall tjetër……197
Kuptimi i mashtrimit……...…198
Njohja me dy të shkëmbyeshmit……...……200
Shikimi me sy……...…201
Cilësimi…….....202
Ndryshimi në tjetërsim……...…203
E matura, e peshuara dhe e numëruara ……..…207
Veza, bostani dhe arra……210
I vogli në barkun e nënës, leshi dhe i sendi i ambalazhuar …….214
Kushtet e kontraktimit dhe kushtet e përmbajtjes…….....216
Marrëdhënie të ndërsjella, marrëdhënie të ndaluara……218
Ngritja e çmimit me qëllim që blerësi ta marrë mallin sa më shtrenjtë (nexhesh)……...…220
MONOPOLI……..……222
Monopoli është haram logjikisht e ligjërisht……...……222
Çdo gjë për të cilën njerëzit kanë nevojë……..……225
Detyrimi dhe vënia e çmimit……..……229

فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام

المؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء الخامس

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

اسم الكتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام – الجزء الخامس

المؤلف: محمد جواد مغنية

الترجمة الى اللغة الألبانية: المرحوم الشيخ الحاج سليم اصطفى

المشرف العام: شيخ وُلْنَتْ مِرْيَا

التصحيح اللغوي: يريدا كولا

الاخراج و الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعية "النسيم"

المطبعة: انتشارات "ليلو"

تيرانا: 2018